



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

NR.PROT. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_2018

## KONTRATË SHËRBIMI

**“SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS TIRANA I”**

TIRANË

2018

## KONTRATË SHËRBIMI

### “SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS TIRANA I”

Sot me datë \_\_/\_\_/2018, nënshkruhet kjo Kontratë,

*Ndërmjet palëve:*

**BASHKISË SË TIRANËS**, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) K11729002L e përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor me adresë në Sheshi „Skënderbej“, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, që më poshtë do të quhet “**Autoriteti Kontraktor**”;

dhe

Shoqërisë “**Ante-Group**” shpk. e regjistruar pranë Gjykatës Tiranë, me Vendimin nr. 16509, datë 18.12.1996, me seli të shoqërisë në adresën Lagjja “22 Tetori”, rruga Antipatrea, zona kadastrale 8502, numri i pasurisë 11/82, godinë 7-katëshe, kati 3, Berat, me administrator të shoqërisë **Z. Bardhjus Bushaj**, me NUIS J62904100D, i mëposhtëquajtur “**Kontraktor**”;

Shoqërisë “**Gjiguria**” sh.p.k e regjistruar me Nr. CN-036858-09-07, Nr Vendimi 9293 datë 28.02.1995, me licensë profesionale të shoqërisë **NZ. 0024/17**, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me seli të shoqërisë: Rr. “Ibrahim Rugova”, Pallati Kontakt, Njësia Bashkiake Nr. 5, **Tiranë**, me **NUIS J62903456H** e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë **Z. Florenc Gjiguria** i mëposhtëquajtur “**Kontraktor**”.

#### **Neni 1 Baza Ligjore**

Të dyja palët, në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, bazuar në Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 659 e vijues, të Ligjit Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, Vkm. Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të nxjerrë në zbatim të tij, Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit “**Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I**”, si dhe ofertës të paraqitur nga Kontraktuesi për këtë procedurë të zhvilluar në datë 22.01.2018, bien dakort përsa më poshtë:

#### **Neni 2 Përkufizimet**

2.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit të procedurës për Prokurim me Objekt “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I», duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“**Çmim kontrate**” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“**Objekt i kontratës**” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“**Palë (t)**” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“**Autoriteti Kontraktor**” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“**Kontraktues**” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

“**Shërbime**” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

“**Termat e References**” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

“**Llogaritja e Afateve**” Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

“**Mbetje**” është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

“**Mbeturina të vëllimshme dhe inerte**”: do të konsiderohen në kuptimin e kësaj kontrate mbetjet urbane voluminoze si: paisje elektroshtëpiake, karkasa makinash, mbetje bimore të drunjtave, pajisje mobiljesh, orëdi dhe të gjitha llojet e objekteve të tjera të cilat për shkak të volumit, formës dhe përbërjes së tyre nuk mund të hidhen në hidhen në kontenerët me volume prej 1.7 m<sup>3</sup>, të parashikuar për të kryer shërbimin. Në këtë grup do të përfshihen edhe mbeturinat solide inerte si: materiale mbetjesh ndërtimore, gërmimesh dhe prishjesh, dherëra, gurë, materiale qeramike, zhavore, etj, me prejardhje nga familjet.

“**Krijues i mbetjeve**” quhen të gjitha subjektet private komerciale, shërbimi, artizanale prodhuese, institucionale, tregjet e të gjitha llojeve, shërbimet ambulante, dhe të gjithë banorët rezidentë apo ata që bëhen rezidentë gjatë kohës së kontratës brenda zonës që do të kryhet aktiviteti i Kontraktuesit me kufij sipas hartës të vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Në kategorinë e Krijues i mbetjeve përfshihen dhe zjarrfikësat, stacionet policore, Bashkia dhe Njësitë Administrative, të gjitha godinat publike dhe shtetërore si dhe të gjithë institucionet arsimore publike dhe private të qytetit, të cilat ndodhen brenda kufizimeve të zonës në të cilën do të kryhet shërbimi objekt i kësaj kontrate.

“**Edukim Publik Ambiental**” nënkupton përpjekjet për ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të konsumatorëve apo banorëve të qytetit me qëllim përpunimin, transportin, largimin ose aspekte të tjera që lidhen me mbajtjen pastër të ambjentit.

**“Zonë e kontratës”** quhet hapësira e territorit brenda kufijve të përcaktuar në hartë. Kjo hartë është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, ku Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë shërbimet e pastrimit, administrimin e mbeturinave ndaj konsumatorëve ekzistues si dhe konsumatorëve që mund të shtohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

**“Proçes – Verbal”** quhet dokumenti i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë mbi kontrollin e ushtruar në terren që reflekton punën e pakryer, gjobat e penaltitetet e vendosura në përputhje me kushtet e kësaj kontrate, cilësinë e shërbimit të pastrimit dhe problemet e konstatuara gjatë kontrollit.

**“Preventivi”** quhen vëllimet e punës të plotësuara me çmime, pjesë përbërëse e kontratës.

**”Situacioni”** quhet dokumenti i evidentimit faktik të situatës së punës së kryer në përputhje me zërat e punimeve të përcaktuar në kontratë (volumeve), në përputhje me preçesverbalet ditore, i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës. Situacionet janë ditore, mujore dhe vjetore.

**“Vlera totale e kontratës”** quhet shumatorja e viteve kontraktuale në përputhje me preventivat e punimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate duke përfshirë dhe rishikimin e çmimit në përputhje me inflacionin e deklaruar.

**“ Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor”**, quhen personat kompetent të emëruar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë të cilët janë përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të shërbimit të pastrimit dhe administrimit të kontratës.

**“Drejtori Teknik i Shërbimeve të Pastrimit”** është personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës, përfaqësues i Kontraktuesit, përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të pastrimit.

**“Vend Grumbullimi i Mbeturinave (VGM)”** është hapësira në të cilën do të kryhet shërbimi i heqjes së mbeturinave nga kontenierët dhe zona përreth kontenierëve siç është përcaktuar në hartë dhe në specifikimet teknike bashkëngjitur këtyre dokumentave të tenderit.

### **Neni 3            Objekti i Kontratës**

3.1        Objekti i kësaj kontrate është **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I”**.

### **Neni 4            Afati i Kontratës**

4.1        Afati i kryerjes së shërbimit është **365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike x 3 (tre) vite nga data e lidhjes së kontratës**. Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe fillon efektet e saj në datë \_\_/\_\_/2018, ora 00.<sup>01</sup> kohë në të cilën kontraktuesi fillon punë menjëherë.

4.2        **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e rishikimit të volumeve të punimeve, objekt i kontratës në rast të ndryshimit të politikave të institucionit (Autoriteti Kontraktor) lidhur me ofrimin e shërbimit të pastrimit.**

## Neni 5 Vlera Totale dhe Vjetore e Kontratës

5.1 Vlera totale e kontratës në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës është **608,036,332 (gjashtëqind e tetë milion e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë me TVSH**

5.2 Vlera vjetore e kontratës në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës është 202,678,777 (dyqind e dy milion e gjashtëqind e shtatedhjetë e tete mijë e shtateqind e shtatedhjetë e shtatë) **lekë me TVSH në vit.**

## Neni 6 Preventivi i Punimeve.

6.1 Vlerësimi i zërave të punës do të kryhet në bazë të preventivit të ofertës të paraqitur në tender nga Kontraktuesi **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I”** për volumet e përcaktuara si më poshtë:

EMERTIMI I SHERBIMEVE	NJESIA	VOLUMET PUNIMEVE	VOLUMENE DITE	ÇMIMI NJESI	VLERA (DITE)	DITE PUNE /VIT	VLERA (VJETORE)
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 7/JAVE	KONTENIER /DITE	745	745	312.00	232,440.00	365	84,840,600
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 3 D/JAVE	KONTENIER /DITE	102	102	183.40	18,706.80	156	2,918,261
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 2 D/JAVE	KONTENIER /DITE	51	51	235.30	12,000.30	104	1,248,031
LARJA DHE DEZIFEKTIMI I KONTENIEREVE	COPE / 30 DITE	898	30	486.00	14,580.00	365	5,321,700
MIREMBAJTJA E VEND GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE GJATE DITES DHE GRUMBULLIMI I MBETJEVE NDERTIMORE DHE TE VELLIMSHME	PIKA /DITE	321	321	111.40	35,759.40	365	13,052,181
FSHIRJA E RRUGEVE DHE TROTUAREVE ME PUNETORE	M2/DITE	460,421	460,421	0.23	105,896.83	365	38,652,343

FSHIRJA E RRUGEVE ME MAKINERI	M/L/DITË	24,898	24,898	0.64	15,934.72	365	5,816,173
MIREMBAJTJE RRUGESH KRYESORE	M2/DITË	48,264	48,264	0.18	8,687.52	365	3,170,945
LARJA E PARE E RRUGEVE (PARASHIKUAR PER 10 MUAJ TE VITIT) (305 DITE) NATEN	M2/DITË	123,930	123,930	0.25	30,982.50	305	9,449,663
LARJA E DYTE E RRUGEVE (PARASHIKUAR PER 8 MUAJ TE VITIT OSE 240 DITE) DITEN	M2/DITË	108,556	108,556	0.17	18,454.52	240	4,429,085
SHUMA VITI 1							168,898,981
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							33,779,796
VLERA PERFUNDIMTARE							202,678,777
SHUMA VITI 2							168,898,981
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							33,779,796
VLERA PERFUNDIMTARE							202,678,777
SHUMA VITI 3							168,898,981
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							33,779,796
VLERA PERFUNDIMTARE							202,678,777
SHUMA VITI 1+2+3_PA TVSH							506,696,943
SHUMA VITI 1+2+3_ME TVSH							608,036,331

6.2 Preventivi i punimeve do të përdoret për llogaritjen e situacioneve që do të paraqiten për likuidim.

## **Neni 7 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli Procesverbaleve**

7.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

- 7.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 7.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 7.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 8 Informacioni Konfidencial**

- 8.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 8.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës.

## **Neni 9 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 9.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 9.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta
- 9.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështeti dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 9.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 10 Detyrimet e Vecanta të Kontraktuesit**

- 10.1 Kontraktuesi bie dakord të kryejë shërbimin e pastrimit të zonës së përcaktuar, objekt i kësaj kontrate, bazuar në zërat e punës të përcaktuar në Preventiv si dhe në përputhje me "Specifikime teknike", grafikun e miratuar si dhe metodologjinë e punës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.
- 10.2 Kontraktuesi është i detyruar që brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve të paraqesë të gjitha mjetet, makineritë dhe pajisjet e

paraqitura në ofertë sipas specifikimeve të përcaktuara në kapitullin “Specifikimet Teknike”.

- 10.3 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë stafin dhe punonjësit e paraqitur në ofertë në gatishmëri për punë në datën e përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve.
- 10.4 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë të gjithë punonjësit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.
- 10.5 Përfaqësuesit e Kontraktuesit të cilët marrin pjesë gjatë kontrollit të përditshëm, duhet të jenë të autorizuar zyrtarisht nga Drejtori teknik i shërbimeve të pastrimit ose administratori i shoqërisë.
- 10.6 Kontraktuesi do të ndërpresë zbatimin e punimeve të shërbimit të pastrimit, për një afat kohor të caktuar, në ato raste kur për shkaqe teknike (punime për rikonstruksionin e rrugëve) kryerja e shërbimit ose e një pjese të shërbimit është e pamundur. Ndërprerja e shërbimit ose modifikimi i tij, për këtë rast do të kryhet vetëm pas njoftimit zyrtar dhe miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës.
- 10.7 Drejtori Teknik i Shërbimeve të Pastrimit është personi përgjegjës i cili nënshkruan të gjitha procesverbalet ditore të mbajtura nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës.
- 10.8 Kontraktuesi është i detyruar që të ketë në cdo kohë në gatishmëri, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga kontrata në përputhje me specifikimet teknike dhe ofertën e paraqitur në tender. Në rast se përdorimi i një pjese të mjeteve dhe pajisjeve është i pamundur për shkaqe teknike për zona ose pika të caktuara, Kontraktuesi mund të ndryshojë një pjesë të mjeteve dhe pajisjeve vetëm pas verifikimit dhe miratimit nga Bashkia e Tiranës të pengesave teknike.
- 10.9 Kontraktuesi është i detyruar të realizojë shërbimin e marrë përsipër në përputhje të plotë me dokumentat e tenderit, metodologjise se punes si edhe specifikimeve teknike dhe grafikun e punimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

## **Neni 11 Lejet dhe Liçensat**

- 11.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

## **Neni 12 Raportet**

- 12.1 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore në të cilat duhet të parashikojë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për proceset e punës sipas preventivit në përputhje me Specifikimet teknike. Në raporte duhet të paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjitha rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë si dhe një përmbledhje të të gjitha situacioneve të cilat ja përcjell Kontraktuesit gjatë kësaj kohe.



- 12.2 Kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës 5 kopje të raportit vjetor brenda 10 ditëve nga përfundimi i cdo viti kontraktual të shoqëruar me situacionin e fundit të shërbimit.
- 12.3 Kontraktuesi duhet të dorëzojë duke filluar nga data 1 e çdo muaji situacionin mujor sëbashku me faturën, mbi volumin e punimeve të kryera për muajin paraardhës, bashkangjitur së cilës do të jenë fatura e ujit dhe volumin e mbeturinave të transportuara gjatë muajit paraardhës, në vend depozitimin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës me verifikimin e situacionit mujor kryen likuidimin e tij brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së situacionit për likuidim, mos dorezimi i ketyre dokumentave i jep te drejten Autoritetit Kontraktor për moskryrjen e likuidimit të situacionit deri në paraqitjen e tyre. Mos likuidimi i pajustificuar nga ana e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Tiranë për dy muaj rresht i jep të drejtën Kontraktuesit të pezullojë shërbimin dhe të kërkojë dëmshpërblim, për paisjet makineritë dhe treguesit e tjerë financiarë për periudhën e kontratës së mbetur pa u realizuar.

### **Neni 13          Personeli i Kontraktuesit**

- 13.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë trajtim për të gjithë të punësuarit e tij në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Shqipëri.
- 13.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.
- 13.3 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 13.4 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.
- 13.5 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.
- 13.6 Të gjithë drejtuesit e automjeteve, të punësuar nga Kontraktuesi duhet të jenë të kualifikuar për makinat e largimit të mbeturinave, duhet të kenë patentë të vlefshme lëshuar nga Republika e Shqipërisë me kategorinë përkatëse.
- 13.7 Kontraktuesi duhet të specializojë të gjithë të punësuarit e tij, të cilët kanë të bëjnë me mbledhjen e mbeturinave të ngurta në mënyrë që të jenë në gjendje të dallojnë mbeturinat e rrezikshme të infektuara dhe të papranueshme.
- 13.8 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjithë punonjësit me uniforma dhe me shenja dalluese të kompanisë.
- 13.9 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndaluar punonjësit e tij të marrin, të nxisin, ose të kërkojnë pagim shtesë nga klientët, ose persona të tjerë publik për largimin e mbeturinave të ngurta.
- 13.10 Kontraktuesi është i detyruar në punësimin e punonjësve të japë përparësi punonjësve aktualë që punojnë me pastrimin, mbledhjen dhe transportin e këtyre mbeturinave.

- 13.11 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjitha mjetet dhe paisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë së tij ashtu siç përcaktohet dhe nenin 35 “Specifikimet Teknike”.
- 13.12 Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtuesin Teknik. Drejtuesi Teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik i Punimeve të objektit është: **Piro Çobanaqi**.
- 13.13 Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:
- Zbatimin e shërbimit të pastrimit konform kontratës;
  - Dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet;
  - Ecurinë e shërbimit të pastrimit konform plan - organizimit dhe grafikut të shërbimit;
- 13.14 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor.
- 13.15 Drejtuesi teknik në këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin Teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlereson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues Teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Autoritetin Kontraktor.

#### **Neni 14 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

- 14.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 14.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.
- 14.3 Kontraktuesi duhet të sigurohet pranë një shoqërie sigurimi me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës deri në datën e përfundimit të plotë të shërbimit të pastrimit. Sigurimi do të kryhet për humbje ose dëmtim të pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të pronave dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 14.4 Rregulloret për çertifikatat e siguracionit do të dorëzohen Supervizorëve për aprovim brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës. I gjithë ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse Kontraktuesi dështon të sigurojë çertifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosi të zgjasë periudhën e paraqitjes të çertifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep Kontraktuesit.
- 14.5 Ndryshime në afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor.

#### **Neni 15 Mbeturina të rrezikshme**

- 15.1 Përfaqësuesit e Kontraktuesit (të punësuarit e tij), kur konstatojnë praninë e çdo mbeturine të papranueshme brenda dhe jashtë kontenierit duhet të lajmërojnë Autoritetin Kontraktor, Bashkinë e Tiranës për këto mbeturina toksike, infektive ose të rrezikshme në mënyrë që bashkërisht të marrin masa për largimin e tyre. Në këto raste të dyja palët kallëzojnë pranë organeve kompetente për ndjekjen ligjore të shkaktarit.

#### **Neni 16           Kontakti me publikun**

- 16.1 Kontraktuesi duhet të ketë një zyrë brenda juridiksionit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës me qëllim që të komunikojë me Bashkinë dhe publikun në përputhje me “Specifikimet Teknike” pjesë përbërëse e kësaj kontratë. Kontraktuesi është i detyruar të vendos një numer telefoni për publikun i cili duhet të komunikohet Autoritetit kontraktor brenda 1 muaji nga lidhja e kontrates.

#### **Neni 17           Edukimi Publik Ambiental**

- 17.1 Kontraktuesi duhet të zhvillojë një program të edukimit publik të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Tiranës për të rritur në maksimum pjesëmarrjen në programin e menaxhimit të mbeturinave duke vënë një theks të veçantë në grumbullimin e tyre në kontenierë, fshirjen e rrugëve, transporti i mbeturinave voluminoze, rrugët tregtare dhe respektimin e orareve përkatëse. Ky program edukimi do të kryhet nga Kontraktuesi në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Tiranës duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit masiv.
- 17.2 Kontraktuesi do të kryejë një herë në 6 muaj programin e Edukimit Ambientale sipas idesë dhe përcaktimeve që do të jepen nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës.
- 17.3 Autoriteti Kontraktor do t’i njoftojë kohën dhe afatin në të cilin do të prodhohet dhe transmetohet spoti ose materiali informativ i shkruar broshura ose fletëpalosje.
- 17.4 Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës do të njoftojë me shkrim mbi detajet e idesë për prodhimin dhe shpërndarjen e spoteve, broshurave ose fletëpalosjeve mbi edukimin ambientale.
- 17.5 Kostoja për prodhimin dhe promovimin e programit të edukimit publik do të mbulohet nga kontraktori.

#### **Neni 18           Taksat**

- 18.1 Kontraktuesi është i detyruar të paguaj të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

#### **Neni 19           Kontenierët, mjediset dhe paisjet**

- 19.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës i përcakton Kontraktuesit pikat e vendgrumbullimit të mbeturinave dhe numrin e kontenierëve për çdo pikë në zonën e kontraktuar në përputhje me zërat e punës së përcaktuar në preventiv, me

specifikimet teknike, listës së rrugëve dhe hartës të zonës, të miratuara, pjesë përbërëse të kësaj kontrate. Kontenieret janë pronë e Kontraktuesit.

- 19.2 Kontraktuesi do të vendosë kontenierët në vendgrumbullimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, shoqëruar me proces-verbaleve të mbajtur nga përfaqësuesit e secilës palë. Proces-verbale do të përmbajnë numrin e kontenierëve dhe pikat e vendgrumbullimit ku do të vendosen kontenierët.
- 19.3 Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve, kur këta të fundit dëmtohen për çdo rast dhe për çdo shkak. Kontraktuesi merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit.
- 19.4 Kontraktuesi ka përgjegjësi për larjen dhe dizinfektimin e kontenierëve në përputhje me Specifikimet Teknike pjesë përbërëse të kësaj kontrate.
- 19.5 Kontraktuesi do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti Kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rastin e humbjes ose vjedhjes së kontenierëve, Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zëvendësimin fizik të kontenierëve.
- 19.6 Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës i përcakton kontraktuesit vendin e depozitimit të mbeturinave të ngurta urbane dhe voluminoze.

#### **Neni 20 Detyrime të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës.**

- 20.1 Autoriteti Kontraktor sensibilizon në mënyrë të herë pas herëshme banorët nëpërmjet lajmërimeve zyrtare ose mediave të shkruara dhe elektronike për mbajtjen pastër të ambjentit.
- 20.2 Autoriteti Kontraktor përgjigjet për mirëmbajtjen e rrugës që çon në vendin e hedhjes së mbeturinave dhe sistemimin e tyre në fushën e depozitimit. Depozitimi i mbeturinave do të kryhet gjatë gjithë ditëve të javës. Autoriteti Kontraktor merr përsipër sistemimin e ambjeneteve ku do të vendosen kontenjerët për të mundësuar kryerjen e shërbimit.
- 20.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë është e detyruar të kryej pagesën për punën e kryer nga ana e Kontraktuesit në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

#### **Neni 21 Mbikqyrja gjatë kryerjes së shërbimit**

- 21.1 Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor në prani të përfaqësuesëve të autorizuar të Kontraktuesit, kryejnë kontroll ditor të shërbimit sipas grafikëve të miratuar, nga Bashkia e Tiranës.
- 21.2 Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor mbajnë proces – verbale dhe situacione ditore për masën e kryerjes së shërbimit, aplikojnë ndalesa, gjoba dhe llogarisin masën e ndalesave për punë të pakryer sipas dispozitave të kësaj kontrate.
- 21.3 Situacionet ditore vendosen në sasi sipas çdo zëri pune të shprehur në lekë në përputhje me procesverbalet ditore dhe preventivin e kësaj kontrate.
- 21.4 Kontrolli i punimeve do të kryhet në vendin dhe kohën e përcaktuar nga të dyja palët në grafik. Situacionet që nuk pranohen të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit marrin vlerë dhe pa nënshkrimin e tij në këto raste:

- a. Kur përfaqësuesi i Kontraktuesit nuk është prezent në kontrollin e punës sipas grafikut.
  - b. Në rastet e kontrollit të përbashkët, kur konstatimet e Perfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor nuk kontestohen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit me anë të provave konkrete si fotografi, video me datën dhe orën e kryerjes së fotografimit ose filmimit. Në rastin e paraqitjes së provave të mësipërme dhe të mospranimit të tyre nga ana e Supervizorit atëherë Kontraktuesi mund ti drejtohet me ankesë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë.
- 21.5 Situacionet mujore do të hartohen në bazë të proçes-verbaleve dhe situacioneve ditore të nëshkruara nga të dyja palët.

## **Neni 22 Likujdimet**

- 22.1 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për pagesën në afat të punimeve të kryera. Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit mujor të paraqitur nga Kontraktuesi me vlerë sipas volumeve të kryera, duke u zbritur masa e volumeve të shërbimit të pakryer si dhe penalitetet e mbajtura për punë të pakryer. Në situacion duhet të përfshihet vlera e T.V.SH.
- 22.2 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për diferencën e kostos së transportit të mbeturinave, në rast ndryshimi të vendit të depozitimit të mbeturinave të ngurta.
- 22.3 Pagesa do të kryhet pranë Bankës Kombetare Tregtare, në numrin e llogarisë së Kontraktuesit Nr. 413037969, IBAN 1620523132037969CLPRCLALLD. Në rast ndryshimi të llogarisë nga ana e Kontraktuesit ky i fundit është i detyruar të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë.

## **Neni 23 Afatet e Pagesës**

- 23.1 Kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit kontraktues me shkrim. Kërkesa duhet të shoqërohet me Situacionin mujor të shërbimit të kryer të miratuar, së bashku me faturën e TVSH-së.
- 23.2 Pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarikë nga dita që është marrë kërkesa për pagesë nga ana e Kontraktuesit.
- 23.3 Dita e pagesës do të jetë dita që fondet debitojnë nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 24 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

- 24.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë përtej afateve të parashikuara në nenin 23, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 24.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

## **Neni 25 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

- 25.1 Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 25.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të shperblim per dëmet e shkaktuara per shkak te vonesës në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 25.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 25.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 25.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

## **Neni 26 Ndryshimi i porosisë**

- 26.1 Autoriteti kontraktor rezervon te drejtën e porosisë shtesë deri në një sasi që nuk kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregulla dhe mënyra të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.
- 26.2 Nevoja për volume shtesë përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor (Bashkia Tiranë) e cila identifikon volumet shtesë të cilat nevojiten të kryhen në vazhdim të kontratës.

## **Neni 27 Ndalesat, Penalitete dhe Gjjobat**

- 27.1 Kontraktuesi do ta zhdëmtojë Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Tiranës për çdo dëmtrim të shkaktuar për shkak të tij.
- 27.2 Kontraktuesi i nënshtrohet ndalesave dhe penaliteteve për punë të pakryer si më poshtë:
  - a. Në rastet kur identifikohen zëra të punës së pakryer të parashikuar nga preventivi i kontratës nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, atëhere përveç ndalesës për punë të pakryer, Kontraktuesi do të penalizohet me 5 – fishin e vlerës së zërit përkatës.
  - b. Në rastet kur Kontraktuesi nuk kryen me cilësinë e kërkuar nga specifikimet teknike të kontratës shërbimin e proceseve të parashikuara për ndonjë zë pune, përveç ndalesës së pagesës për zërin e punës, Kontraktuesi do të penalizohet me 2-fishin e vlerës së zërit përkatës.

- c. Në rast të mos riparimit të plotë të kontenierëve apo zëvendësimin e tyre (në mënyrë që të plotësojë kushtet teknike, estetike dhe higjienosanitare), brenda afatit të përcaktuar më sipër nga Kontrantuesi, këtij të fundit do ti vendoset penalitet në masën 50.000 lekë për çdo kontenier , vlerë e cila do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likujdim.
- d. Kontraktuesi është i detyruar të pajisë punonjësit e tij me uniforma në të cilat të jenë vendosur qartë shenjat dalluese të shoqërisë Kontraktuese. Në rast të mos respektimit të detyrimit të mësipërm Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë i aplikojnë Kontraktuesit gjobë në masën nga 50.000 lekë, masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likujdim.
- e. Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 17 dhe kapitullit “Specifikimet teknike” për kryerjen e Edukimit Publik Ambjental, supervisorët e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë aplikojnë gjobë në masën 500.000 (pesëqindmijë) lekë. Kontraktuesit do ti njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambjental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e Njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambjental Autoriteti Kontraktor vendos penalitetin e rradhës në masën 1.000.000 (njëmilion) lekë. Gjobat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor në situacionin e rradhës të paraqitur për likujdim nga ana e Kontraktorit.
- f. Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 10.8 Detyrimete Vecanta të Kontraktuesit Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë, aplikojnë ndalesë në vlera prej 2,000,000 (dymilion) lekë. Masë e cila do të aplikohet cdo muaj,deri ne plotësimin e detyrimit. Masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likujdim.

27.3 Penalitetet e përcaktuara në nenin 27.2 ( a,b,c ) nuk aplikohen në rast se shërbimi nuk është kryer për arsyet e përmendura në nenin 10.6 si dhe 10.8 të kësaj kontrate.

27.4 Penalitetet dhe gjobat e aplikuara më lart nuk përjashtojnë dhe masat e tjera penalizuese që mund të aplikohen nga Institucione të tjera të parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

## **Neni 28 Siguracioni i Punonjësve**

28.1 Kontraktuesi përgjigjet për punësimin dhe sigurimin e nëpunësve dhe punëtorëve, sipas legjislacionit në fuqi. Kontraktuesi duhet të ketë të siguruar një numër punonjësish jo më të vogël se numri i punonjësve të deklaruar në ofertë. Kontraktuesi duhet ti paraqesë me kërkesën e Autoritetit Kontraktor listën e të gjithë punonjësve të siguruar si dhe çdo informacion tjetër në lidhje me punonjësit e shoqërisë.

## **Neni 29 Rrethana të paparashikuara**

- 29.1 Rrethanat e paparashikuara për arsye të të cilave shërbimi nuk mund të kryhet nga Kontraktuesi do të konsiderohen sa vijon:
- Luftë e deklaruar apo jo, luftë civile, kryengritje, revolucion ose nga ndonjë ngjarje tjetër krejtësisht jashtë kontrollit të Autoriteti Kontraktor, Bashkisë Tiranë ose Kontraktuesit.
  - Katastrofa natyrore.
  - Akte vandale të vërtetuara si të tilla nga Kontraktuesi.
- 29.2 Në qoftë se gjatë zbatimit të kontratës krijohen rrethana si ato të përmendura në pikat e mësipërme të cilat pengojnë kontraktuesin të përmbushin të gjitha detyrimet kontraktuale dhe që nuk janë në kompetencat e Kontraktuesit, ai autorizohet të mbyllë kontratën ose të kërkojë një plotësim të saj, në të cilat do të merren parasysh dhe rastet e sipërpërmendura.

### **Neni 30 Përfaqësimi i Autoritetit Kontraktor**

- 30.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë garanton se i ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm paraprake për nënshkrimin dhe lidhjen e kësaj kontrate duke iu përgjigjur detyrimeve Ligjore.

### **Neni 31 Komunikimi**

- 31.1 Mënyra e komunikimit midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë dhe Kontraktuesit do të jetë me shkrim. Të gjitha njoftimet të cilat palët do të drejtojnë njëri tjetrit duhet të hartohen me shkrim dhe të dorëzohen personalisht, me postë zyrtare ose postë elektronike duke iu adresuar palëve në mënyrën e mëposhtme:
- Për përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës adresa e plotë e Institucionit ose adresa e postës elektronike,
  - Për përfaqësuesin e kontraktuesit, adresa e plotë e kontraktuesit ose adresa e postës elektronike të cilat palët në çdo kohë ia komunikojnë njëri tjetrit me shkrim
- 31.2 Njoftimet do të kenë efekte me marrjen në dorezim nga palët.

### **Neni 32 Përfaqësimi i Palëve**

- 32.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 32.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.



32.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

### **Neni 33 Negociatat dhe Amendamentet**

33.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

33.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

33.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

### **Neni 34 Transferimi i të Drejtave**

34.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

### **Neni 35 Specifikimet teknike**

#### **35.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane dhe Tregjeve.**

##### **35.1.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e **898** kontenierëve të ndara në **449 PGM (pika të grumbullimit të mbetjeve)** me volum 1.7 m<sup>3</sup>, brenda zonës së kontraktuar.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji:

- **745** zbrazje kontenierësh/ditë, për zonën urbane.
- **102** zbrazje 3 here/javë(156 ditë në vit) për zonën rurale (Dajt, Zall-Herr).
- **51** zbrazje 2 here/javë(104 ditë në vit) për zonën rurale (Zall Bastar, ShenGjergj).

Në momentin që Autoriteti Kontraktor do të aktivizojë procesin e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në zonën "Tirana 1", 125 e kontenierë do të do të bëhen pjese e këtij procesi. Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën **Tirana 1** dhe sipas hartës së zonës.

Te gjithë kontenieret si dhe mirëmbajtja e tyre do të ofrohen nga Operatori i Shërbimit. Operatori i shërbimit duhet të disponojë 30 % te sasise se kerkuar te konteniereve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e shpalljes fitues dhe sasia e mbetur do të vendoset

në zonën e pastrimit sipas pikave të grumbullimit, brenda 2 (dy) muajve nga data e fillimit të shërbimit.

### **35.1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a. Zbrazen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.

b. Duhet të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri ose duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

### **35.1.2 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve**

a. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës (321 PGM pjesa Tirana urbane, 36 PGM Nja Dajt, dhe 14 PGM Nja Shëngjergj, 56 PGM Nja Zall Herr, 31 Zall Bastar, në total 458 PGM. (Vendosja e tyre në vendet e përcaktuara do të bëhet sipas sistemit kordinativ(x,y) WGS 1984).

b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoritetit kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë konsiderohet e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**d.** Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të pergatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës (për zonën urbane dhe gjysëm urbane) duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona urbane dhe gjysëm urbane të jetë krejtësisht e pastër, ndërsa për zonën rurale ky shërbim të kryhet gjatë ditës.

Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

**e.** Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërbushjen e tyre.

**f.** Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të konteinerëve dhe e pikave të grumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të shpeshtohet në funksion të sasise së depozituar të mbetjeve por gjithmonë duke mos kaluar parashikimin kontraktual dhe preventivin e punimeve.

### **35.1.3 Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të pa transportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth konteinerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete.

**b.** Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së konteinerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

**c.** Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontraktor në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontraktor.

**d.** Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**e.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

**f.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**g.** Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimive të pastrimit.

**h.** N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penaltetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoha të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**i.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoha për mosplotësim këtij detyrimi.

#### **35.1.4 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **6 (gjashtë) copë**;
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **3 (tre) copë**;
3. Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin “Specifikimet teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

#### **4. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

- c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezifektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori do të riparojë ose të zëvendësojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete.
- e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.
- f. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet dhe kontenierët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

## **35.2 Larja dhe dezifektimi i kontenierëve**

### **35.2.1 Volumet e punimeve**

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezifektojë 898 kontenierë të volumeve 1.7 m<sup>3</sup>/ në muaj ose mesatarisht 30 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

### **35.2.2 Metodologjia**

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezifektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezifektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezifektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

### **35.2.3 Grafikët e punimeve**

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezifektimin e kontenierëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

#### **35.2.4 Rregulla për t'u zbatuar**

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..

#### **35.2.5 Mjetet dhe pajisjet**

1. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një)copë**.
2. Lëndë dezifektuese dhe aromatizuese për dezifektimin e kontenierëve.
3. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezifektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezifektimin e kontenierëve.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

### **35.3 Mirëmbajtja e vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme.**

#### **35.3.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht pikat e grumbullimit të mbetjeve, **321** vendgrumbullime mbetjesh. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën "Tirana 1" si dhe në hartën per kete zone.

#### **35.3.2 Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

- a. Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonën perkatese, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (amballazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t'u depozituar nëpër

kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën perkatese sado larg kontenierit të jetë hedhur.

**b.** Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme, të hedhura jashtë kontenierëve, si dhe në gjithë hapësirat publike dhe territoriale të zonës do të përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.

**d.** Pas pastrimit kontenierët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.

**f.** Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e këtij shërbimi, përgatiten nga sipermarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën vendgrumbullim mbetjesh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

**g.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

**h.** Grafikët që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që punimet të fillojnë nga ora 10.00 deri në 18.00, me qëllim që gjithë kësaj periudhe kohore të gjithë kontenierët dhe vendet rreth tyre të jenë krejtësisht të pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

**i.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërbushjen e tyre.

**j.** Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër pikën e grumbullimit të mbeturinave në përputhje me Rregullores me VKB Nr.1 dt.05.02.2007 “Për Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit”.

**k.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kontenierë të tejmbushur me mbetje urbane, ndërtimore, të vëllimshme dhe sipërfaqe rreth tyre të papastruara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga njoftimi apo konstatimi i problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit dhe do të përballet me penalitetet e parashikuara në përputhje me me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**l.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe deklaruar të të makinerive dhe pajisjeve dhe punëtorë për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

**m.** Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë operatori i shërbimit për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rena gjatë transportit, ai do të përballë me penaltetet dhe gjoba në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**n.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

**p.** Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të pikave vendgrumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve voluminoze pagesa për këtë shërbim do të kryhet sipas numrit faktik të këtyre vendgrumbullimeve në terren. Cdo ndryshim do të reflektohet në situacionet mujore të pagesave.

### **35.3.3 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vëre në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane dhe mbetjeve ndërtimore, të vëllimshme si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

2. Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**;
3. Vegla pune si lopata, fshesa për të gjithë shoferët dhe punëtorët.
4. Çdo makineri për kryerjen e këtij shërbimi duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të intinerarit ditor.
5. Një listë e makinave për transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së mësipërme
6. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit dhe një numër kontenierësh me volum të madh duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
7. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.



## **35.4 Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.**

### **35.4.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **460,421m<sup>2</sup>** në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 1, sipas hartës bashkëngjitur.

### **35.4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

**a.** Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj (për rrugët e kategorisë së I), si dhe sipërfaqen e plotë rrugë + trotuar për kategorinë e III.

**b.** Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.

**c.** Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.

**d.** Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.

**e.** Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambjentit rreth tyre bëhet gjatë natës.

**f.** Procesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotuaret e qytetit).

### **35.4.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.

**b.** Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbyshjen e tyre.

#### **35.4.4 Rregulla për t'u zbatuar**

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

d. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

e. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrore apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

f. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

g. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoha për mosplotësim të tyre.

h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjenike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

#### **35.4.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
2. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

### **35.5 Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike.**

#### **35.5.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontrator ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet. në një gjatësi lineare prej **24,898** ml në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 1 (bashkëngjitur kësaj kontrate) dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate.

#### **35.5.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

a. Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë nga parkimi. Më pas çdo mbeturinë e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punëtorët e shërbimit të fshirjes me krahë..

b. Në të gjitha gjatësitë lineare dhe segmentet e lira nga parkimi, të rrugëve , të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri. Fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

#### **35.5.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora **21.00-04.00**.

**b.** Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 7.00 zona të jetë krejtësisht e pastër.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoha dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

#### **35.5.4 Rregulla për t'u zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit .

**b.** Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja e rrugës me makineri teknologjike për fshirjen e rrugëve, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.

**d.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

**e.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

### **35.5.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;
- b. Makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e rrugëve, mund të kontrollohen në çdo kohe nga Autoriteti kontrator për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të lahen dhe pastrohen në fillim ose në fund të itinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.
- c. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontrator sipas një formati të miratuar paraprakisht.
- d. Automjetet, pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kësaj kontrate.
- e. Një listë e makinave fshirëse do t'i paraqitet Autoritetit kontrator para fillimit të veprimtarisë së fshirjes.

## **35.6 Mirëmbajtja dhe pastrimi gjatë ditës i akseve kryesore rrugore.**

### **35.6.1 Volumi i punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht të gjitha trotuaret e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha trotuaret e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, për një pjesë të rrugëve në një sipërfaqe prej **48,264** m<sup>2</sup> në ditë nga ora 10.00 deri 18.00 .

Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve për zonën Tirana 1, sipas hartës bashkëngjitur.

### **35.6.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbim i mirëmbajtjes dhe pastrimit të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, konsiston në:

Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet për mbulim si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve, mbajtjen pastër gjatë ditës të koshave rrugorë dhe vendit rreth tyre, etj

### **35.6.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

- a.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të bëhet gjatë ditës nga ora 10.00 deri 18.00
- c.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që gjatë gjithë ditës trotuarët e përcaktuar për shërbim të jenë krejtësisht e pastër ose duke u pastruar.
- c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit, përgatiten nga sipërmarresi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
- d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo segment rrugorë.
- e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **35.6.4 Rregulla për t'u zbatuar**

- a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen trotuare të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit .
- b.** Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.
- c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.
- d.** Gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të

ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**e.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të pastrimit gjatë ditës, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

**f.** Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoha për mosplotësim të tyre.

**h.** Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

### **35.6.5 Mjetet dhe pajisjet**

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundur kryerjen me cilësi të shërbimit.

## **35.8 Larja e rrugëve me makinë teknologjike**

### **35.8.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës ashtu dhe për shërbimin e dytë të larjes gjatë ditës.

1. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim një herë në ditë gjatë natës, parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **123,930** m<sup>2</sup> në ditë përgjatë 305 ditëve të periudhës kontraktuale. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e larjes me makineri për zonën Tirana 1.

2. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makineri si shërbim i dytë ditor, si larje gjatë ditës në një sipërfaqe të përgjithshme prej **108,556** m<sup>2</sup>/ditë, sipas listës së rrugëve dhe volumeve të përcaktuara për larjen dy herë në ditë, për zonën Tirana 1 përgjatë muajve më të nxehtë të vitit. (gjithsej 240 ditë)

### **35.8.3 Specifikimet teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

1. Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara, në mënyrë që

makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

2. Larjen me presion, me makineri teknologjike larëse, si shërbim i dytë ditor, të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara për këtë shërbim, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

3. Gjatë shërbimit të parë të larjes (gjatë natës) shpejtësia e operimit të makinave larëse gjatë procesit të larjes (zbrazjes së ujit) duhet të variojë nga 8-10 km/orë kurse gjatë shërbimit të dytë të larjes nga 15-20 km/orë.

#### **35.8.4 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve**

1. Larja e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.

2. Larja e rrugëve si shërbim i dytë ditor, do bëhet çdo ditë, gjatë periudhës 15 Mars – 15 Nëntor , ( gjithsej 240 ditë) nga ora 12.00 –19.00.

3. Larja me presion, me makinë teknologjike do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 07.00 dhe në orën 19.00 për shërbimin e dytë të larjes, zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e larë.

4. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

5. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

6. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

7. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

#### **35.8.5 Rregulla për tu zbatuar**

1. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.



2. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e larjes me presion të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0,8 litër ujë për 1 m<sup>2</sup> rrugë për larjen e darkës dhe 0.6 litër ujë për m<sup>2</sup> për larjen e ditës.
3. Larja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë.
4. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes me makineri për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.
5. Përfaqësuesit e Autoritetit kontraktor do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes së dytë dhe mund ti kërkojë Operatorit të Shërbimit kryerjen e këtij shërbimi në ditët e tjera të vitit ose gjatë stinës së verës kur të jetë e nevojshme, në përputhje me çmimet njësi të preventivit të punimeve dhe sipërfaqeve të rrugëve sipas listës së rrugëve bashkëngjitur kontratës, një kërkesë zyrtare të Autoritetit kontraktor, si dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.
6. Do të konsiderohet e pavlefshme larja e rrugëve në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontraktor për shkaqe të ndryshme.
7. Autoriteti kontraktor do të nxisë Operatori i shërbimitn të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për larjen e rrugëve, si puse, etj.
8. Listat përkatëse të rrugëve që do lahen i bashkëngjiten kësaj kontrate.
9. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do mbarten nga operatori i shërbimit.
10. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për larjen e rrugëve.

### **35.8.6 Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

1. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**; Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.
2. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

3. Të gjitha makinat për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë,  
si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
5. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.
6. Një listë e makinave larëse do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së larjes.

### **35.9 “Edukimi Publik Mjedisor”**

Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatori i shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së operatori i shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Ky kontakt mund të realizohet si nëpërmjet mass-mediave ashtu edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese.

Operatori i shërbimit duhet të mundësoj shpërndarjen e materialeve informative të paktën një here në gjashtë muaj (duke filluar nga dita e firmosjes së kontratës). Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotjes, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë qytetarët e kryeqytetit të bëhen pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

Operatori i shërbimit duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik mjedisor që të parkohet në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.

Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontraktor.

Në rast të mos përmbushjes të edukimit mjedisor apo plotësimin të pjesshëm të tij aplikohen gjoba.

Në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor, Operatori i zones duhet të pregatisë dhe të promovojë spote publicitare që përcjellin mesazhin e Bashkisë Tirane në këto kontekste. Këto spote duhet të realizohen dhe të publikohen në disa nga TV e Kryeqytetit që do të saktësohen nga Autoriteti Kontraktor, fluksi i promovimit të tyre do të saktësohet nga Autoriteti Kontraktor ndërsa kostot e kësaj shërbimi do të jenë në ngarkim të Operatorit të shërbimit.

### 35.10. Specifikimet teknike të Kontenierëve

**Sasia e kërkuar e kontenierëve për zonën “Tirana I” është 898 copë.**

#### **TE DHENA TEKNIKE TE KONTENIERIT 1700 LITRA:**

Kontenierët do të përdoren për grumbullimin e mbetjeve urbane dhe duhet të kenë karakteristikat si më poshtë vijojnë:

##### *Trupi i kontenierit (vaska):*

Trupi i kontenierit nga brenda (vaska e zinguar). Ekstra përforcim i bazës së rrotës, i ngjitur tek kontenieri. Sistem kullimi fundor për derdhjen e lëngjeve të grumbulluar nga mbetjet apo gjatë larjes së kontenierit. Kapaciteti i plote 1700 litra. Doreza anesore për terheqjen e kontenierit.

Kontenierët duhet të jenë të lyer me bojë(vaska) Portokalli,(kapaku i kuq). Spesori i profilit të vaskës 1.5-4 mm.

##### **Kapaku**

Metalik. Me përforcues të tërthortë për ekstra rezistencë.Profil i harkuar ose i drejtë për rrjedhje të ujrave të shiut. Sistemi i hapjes së kapakut me pedale qëndrore. Ndër të tjera kapaku duhet jetë i pajisur edhe me një dorezë, në pjesën e përparme ose anesore, për raste të hapjes së kapakut në mënyrë manuale.Ngjyra e kapakut, e kuqe.

##### **Pedalja**

Pedalja duhet të jetë me profil metalik me spesor 4 mm për ekstra rezistencë.

##### **Rrotat**

Rrota rezistente me çelik të galvanizuar në qendër dhe unazë gome rezistente në pjesën e kontaktit me tokën. Diametri i rrotës 200mm dhe me rrotullim 360°. 4 rrota të kthyeshme (me kokë rrotulluese), me gomë plastike solide, me kuzhineta, kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 250kg;

##### **Modeli i kapjes së kazanit**

Attacco Bologna/ Din.

##### **Sinjalistika**

Operatori duhet të sigurojë dhe ngjisë adezivë tek kazanët, me informacion mbi mënyrën e dorëzimit të mbetjeve, ndalimet, eiketa, adëzivë për ndalim parkimi para kazanëve, shirita me ngjyre fosfoeshente, logo e Bashkisë së Tiranës. (Pas miratimit të formatit nga Bashkia Tirane). Ofertuesi mund të ofrojë edhe modele të tjera por duke marrë paraprakisht miratimin e autoritetit kontraktor si dhe duke respektuar gjithnjë kohën e parashikuar për dorëzimin e kontenierëve.

##### **Targë e fiksuar (gozhduar) ose e stampuar**

Mbi çdo kazanë, nga prodhuesi, do të fiksohet një targë me dimension 10cm x 4cm ku do të stampohet një kod identifikimi për kazanin me 6 shifra (duke u nisur nga 000000 e deri në 002500), viti i fabrikimit të kazanit dhe kapaciteti.

### **Përputhja**

Sipas normativës UNI EN 840 (UNI 10571).

### **Të tjera.**

Kazani duhet të jetë në gjendje të durojë gjatë kohës, për të gjithë përbërsit, temperatura nga -20°C deri +50°C;

Kazani duhet të strukturuar në mënyrë që të garantojë një mbajtje peshe deri në 450kg, pa pësuar asnjë deformim permanent

Hapja minimale, me gjysëm pedale duhet të jetë 450mm, ndërsa në fazën e zbrazjes ose të larjes duhet të jetë minimalisht 1000mm.

## **Neni 36 Forca Madhore**

36.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

36.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

36.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

## **Neni 37 Garancia e kontratës**

37.1 Garancia e kontratës do të jetë në masën 10 % të vlerës totale të kontratës të llogaritur në bazë të preventivit total të ofruar nga shoqëria fituese dhe konkretisht në vlerën **60,803,633** (gjashtedhjetë milion e teteqind e tre mijë e gjashteqind e tridhjetë e tre) **lekë**.

37.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t’i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

37.3 Sigurimi i kontrates do t’i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

37.4 Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontrates.

### **Neni 38 Klauzolë shtesë**

38.1 Kushtet dhe termat e kësaj kontrate nuk mund të ndryshohen ose modifikohen përveçse me vullnetin e palëve.

### **Neni 39 Legjislacioni**

39.1 Kontrata do të qeveriset nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

### **Neni 40 Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

40.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

### **Neni 41 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

### **Neni 42 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

42.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

42.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

42.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

### **Neni 43 Ndërprerja për Mosplotësim**

43.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

43.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

#### **Neni 44      Zgjidhja e kontratës**

- 44.1 Në rast të shkeljeve të dispozitave të kësaj kontrate nga pala shkelëse, ajo është e detyruar ti rregullojë ato. Palës shkelëse i ngarkohen shpenzimet e rregullimit të këtyre shkeljeve.
- 44.2 Me konstatimin e shkeljeve të kontratës, Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës i bën njoftim me shkrim Kontraktuesit për konstatimin dhe detyrimin e Kontraktuesit për rregullimin e tyre brenda afateve të parashikuara në kontratë.
- 44.3 Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë po nuk kufizohen në sa vijon:
- a. Nëse Kontraktuesi nuk kryen shërbimin e pastrimit në një pjesë të zonës apo në të gjithë zonën e parashikuar në këtë kontratë, për një periudhë të pandërprerë prej 7 ditësh me përjashtim të rastit të përcaktuar në neni 10.7 të kësaj kontrate.
  - b. Nëse masa e punës së pakryer dhe e penalteteve të aplikuara tejkalon 15 % të vlerës vjetore të kontratës.
  - c. Nëse Kontraktuesi falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit.
  - d. Nëse Kontraktuesi nuk ka në dispozicion dhe gjëndje pune, apo ndryshon gjatë kohëzgjatjes së kontratës automjetet e kërkuara sipas Specifikimeve Teknike dhe të paraqitura nga Kontraktuesi në ofertë pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë.
- 44.4 Nëse kontrata për shkak të shkeljeve prishet atëherë Autoritetit Kontraktor Bashkisë i lindin këto të drejta:
- a. E drejta për të deklaruar kontratën të prishur duke i dhënë Kontraktuesit një njoftim me shkrim brenda një afati prej 30 ditësh, me argumentat përkatëse. Në qoftë se kontrata prishet, Kontraktuesi duhet të sigurojë shërbimin e pastrimit për një periudhë prej 90 ditësh nga dita e njoftimit të prishjes së kontratës. Për këtë kohë Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë është e detyruar të kryejë pagesën e shërbimit.
  - b. Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, ka të drejtën të sekuestrojë garancinë e kontratës të ngurtësuar në masën e përcaktuar në kontratë.
  - c. Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës ka të drejtën që t'i kërkojë dëmshpërblim Kontraktuesit në masën e dëmit të shkaktuar.

#### **Neni 45      Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 45.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 45.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 46 Dokumente që i bashkëlidhen kësaj kontrate**

Pjesë Integrale e kësaj kontrate do të jenë:

1. Sigurimi i Kontratës
2. Formulari i Ofertës
3. Preventivi i shërbimeve
4. Specifikimet teknike
5. Material shpjegues Volume Larje/Fshirje/Mirëmbajtje/Kontenierë.
6. Harta treguese në zonën Tirana I.

**Neni 47 Të përgjithshme**

Kjo kontratë hartohet në 6 (gjashtë) kopje të njëjta në gjuhën shqipe, prej të cilave 5 (pesë) kopje i mban Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë dhe 1 (një) kopje e mban Kontraktuesi.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**AUTORITETI KONTRAKTOR**

**BASHKIA E TIRANËS**

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

**Erion VELIAJ**

**Titullar i Autoritetit Kontraktor**

**KONTRAKTUESI**

**“ANTE-GROUP” SHPK**

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

**Bardhjus Bushaj**

**Administratori**

**“GJIKURIA” SHPK**

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

**Florenc Gjiguria**

**Administratori**

Miratoi:

Taulant Tusha, Drejtor i Përgjithshëm Punëve Publike

Julian Zanaj, Drejtor i Prokurimeve

Entela Kruja, Përgjegjës Sekt. Prok. të Shërbimeve të Infrastrukturës  
Konceptoi:

Elsa Metaliaj, Specialist Sekt. Prok. të Shërbimeve të Infrastrukturës

Nr. i kopjeve: 6

Datë \_\_\_\_\_2018



BASHKIA  
TIRANË

NR.PROT. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_2017

## KONTRATË SHËRBIMI

### “SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS TIRANA II”

TIRANË

2017



## KONTRATË SHËRBIMI

### “SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS TIRANA II”

Sot me datë \_\_/\_\_/2017, nënshkruhet kjo Kontratë,

*Ndërmjet palëve:*

**BASHKISË SË TIRANËS**, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) K11729002L e përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor me adresë në Sheshi „Skënderbej“, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, që më poshtë do të quhet “**Autoriteti Kontraktor**”;

Dhe;

Operatorit Ekonomik “**Korsel**” shpk, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) J64104124G, me adresë në Objekt Privat, Blv: “F.S.Noli”, përballë Supermarketit “Elisabet”, Korçë, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë, **Z. Maksim Fejzulla**, më poshtë quajtur “**Kontraktuesi**”;

Dhe;

Operatorit Ekonomik “**Brai-Cata**” srl, me numër unik të identifikimit të subjektit 14942091, me adresë Sektori 6, RR; “VIRTUTII”, Nr. 48, Etaj 1, Bukuresht, Rumani përfaqësuar nga administratori i shoqërisë, **Z. Ceausescu Nicolae Daniel**, më poshtë quajtur “**Kontraktuesi**”;

#### **Neni 1 Baza Ligjore**

Të dyja palët, në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, bazuar në Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 659 e vijues, të Ligjit Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, Vkm. Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të nxjerrë në zbatim të tij, Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit “**Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II**”, si dhe ofertës të paraqitur nga Kontraktuesi për këtë procedurë të zhvilluar në datë 27.09.2017, bien dakort për më poshtë:

#### **Neni 2 Përkufizimet**

2.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit të procedurës për Prokurim me Objekt “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II», duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

“Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

“Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

“Llogaritja e Afateve” Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

“Mbetje” është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

“Mbeturina të vëllimshme dhe inerte”: do të konsiderohen në kuptimin e kësaj kontrate mbetjet urbane voluminoze si: paisje elektroshtëpiake, karkasa makinash, mbetje bimore të drunjtave, pajisje mobiljesh, orë dhe të gjitha llojet e objekteve të tjera të cilat për shkak të volumit, formës dhe përbërjes së tyre nuk mund të hidhen në kontenerët me volume prej 1.7 m<sup>3</sup>, të parashikuar për të kryer shërbimin. Në këtë grup do të përfshihen edhe mbeturinat solide inerte si: materiale mbetjesh ndërtimore, gërmimesh dhe prishjesh, dherëra, gurë, materiale qeramike, zhavore, etj, me prejardhje nga familjet.

“Krijues i mbetjeve” quhen të gjitha subjektet private komerciale, shërbimi, artizanale prodhuese, institucionale, tregjet e të gjitha llojeve, shërbimet ambulante, dhe të gjithë banorët rezidentë apo ata që bëhen rezidentë gjatë kohës së kontratës brenda zonës që do të kryhet aktiviteti i Kontraktuesit me kufij sipas hartës të vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Në kategorinë e Krijuesit i mbetjeve përfshihen dhe zjarrfikësat, stacionet policore, Bashkia dhe Njësitë Administrative, të gjitha godinat publike dhe shtetërore si dhe të gjithë institucionet arsimore publike dhe private të qytetit, të cilat ndodhen brenda kufizimeve të zonës në të cilën do të kryhet shërbimi objekt i kësaj kontrate.

“Edukim Publik Ambiental” nënkupton përpjekjet për ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të konsumatorëve apo banorëve të qytetit me qëllim përpunimin, transportin, largimin ose aspekte të tjera që lidhen me mbajtjen pastër të ambjentit.

**“Zonë e kontratës”** quhet hapësira e territorit brenda kufijve të përcaktuar në hartë. Kjo hartë është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, ku Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë shërbimet e pastrimit, administrimin e mbeturinave ndaj konsumatorëve ekzistues si dhe konsumatorëve që mund të shtohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

**“Proçes – Verbal”** quhet dokumenti i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë mbi kontrollin e ushtruar në terren që reflekton punën e pakryer, gjobat e penaltetit e vendosura në përputhje me kushtet e kësaj kontrate, cilësinë e shërbimit të pastrimit dhe problemet e konstatuara gjatë kontrollit.

**“Preventivi”** quhen vëllimet e punës të plotësuara me çmime, pjesë përbërëse e kontratës.

**”Situacioni”** quhet dokumenti i evidentimit faktik të situatës së punës së kryer në përputhje me zërat e punimeve të përcaktuar në kontratë (volumeve), në përputhje me preçesverbalet ditore, i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës. Situacionet janë ditore, mujore dhe vjetore.

**“Vlera totale e kontratës”** quhet shumatorja e viteve kontraktuale në përputhje me preventivat e punimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate duke përfshirë dhe rishikimin e çmimit në përputhje me inflacionin e deklaruar.

**“ Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor”**, quhen personat kompetent të emëruar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë të cilët janë përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të shërbimit të pastrimit dhe administrimit të kontratës.

**“Drejtori Teknik i Shërbimeve të Pastrimit”** është personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës, përfaqësues i Kontraktuesit, përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të pastrimit.

**“Vend Grumbullimi i Mbeturinave (VGM)”** është hapësira në të cilën do të kryhet shërbimi i heqjes së mbeturinave nga kontenierët dhe zona përreth kontenierëve siç është përcaktuar në hartë dhe në specifikimet teknike bashkëngjitur këtyre dokumentave të tenderit.

### **Neni 3            Objekti i Kontratës**

3.1      Objekti i kësaj kontrate është **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”**.

### **Neni 4            Afati i Kontratës**

4.1      Afati i kryerjes së shërbimit është **365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike x 3 (tre) vite nga data e lidhjes së kontratës**. Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe fillon efektet e saj në datë 28.12.2017, ora 00.<sup>01</sup> kohë në të cilën kontraktuesi fillon punë menjëherë

4.2      **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e rishikimit të volumeve të punimeve, objekt i kontratës në rast të ndryshimit të politikave të**

**institucionit (Autoriteti Kontraktor) lidhur me ofrimin e shërbimit të pastrimit.**

## **Neni 5 Vlera Totale dhe Vjetore e Kontratës**

5.1 Vlera totale e kontratës në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës është **612,427,235.7 (gjashtëqind e dymbëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë pikë shtatë) lekë me TVSH**

5.2 Vlera vjetore e kontratës në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës është 204,142,411.90 (dyqind e katër milion e njëqind e dyzetë e dy mijë e katërqind e njëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë) **lekë me TVSH në vit.**

## **Neni 6 Preventivi i Punimeve.**

6.1 Vlerësimi i zërave të punës do të kryhet në bazë të preventivit të ofertës të paraqitur në tender nga Kontraktuesi **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”** për volumet e përcaktuara si më poshtë:

EMERTIMI I SHERBIMEVE	NJESIA	VOLUME T PUNIMEVE	VOLUMENE DITE	ÇMIMI NJESI	VLERA (DITE)	DITE PUNE /VIT	VLERA (VJETORE)
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 7/JAVE	KONTENIER/DITE	915	915	186.000	170,190	365	62.119.350.00
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 3/JAVE	KONTENIER/DITE	111	111	186.000	20,646	156	3,220,776.00
LARJA DHE DEZINFEKTIMI I KONTENIEREVE	COPE /30 DITE	1,026	34	250.000	8,500	365	3,102,500.00
MIREMBAJTJA E VENDGRUMBULLIMIT TE MBETJEVE GJATE DITES DHE GRUMBULLIMI I MBETJEVE NDERTIMORE DHE TE VELLIMSHME	PIKA/DITE	396	396	54.000	21,384	365	7,805,160.00
FSHIRJA E RRUGEVE DHE TROTUAREVE ME PUNETORE	M2/DITË	490,421	490,421	0.400	196,168	365	71,601,466.00

FSHIRJA E RRUGEVE ME MAKINERI	M/L/DITE	18,974	18,974	0.700	13,281.8	365	4,847,857.00
MIREMBAJTJE RRUGESH KRYESORE	M2/DITË	34,286	34,286	0.9394533	32,210.1	365	11,756,684.98
LARJA E RRUGEVE 1 HERE NE DITE	M2/DITE	79,956	79,956	0.130	10,394.3	305	3,170,255.40
LARJA E DYTE E RRUGEVE (PARASHIKUAR PER 8 MUAJ TE VITIT OSE 240 DITE)	M2/DITE	79,956	79,956	0.130	10,394.3	240	2,494,627.20
SHUMA VITI 1							170,118,676.58
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							34,023,735.32
VLERA PERFUNDIMTARE							204,142,411.90
SHUMA VITI 2							170,118,676.58
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							34,023,735.32
VLERA PERFUNDIMTARE							204,142,411.90
SHUMA VITI 3							170,118,676.58
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							34,023,735.32
VLERA PERFUNDIMTARE							204,142,411.90
SHUMA VITI 1+2+3_PA TVSH							510,356,029.75
SHUMA VITI 1+2+3_ME TVSH							612,427,235.70

6.2 Preventivi i punimeve do të përdoret për llogaritjen e situacioneve që do të paraqiten për likuidim.

## **Neni 7 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli Procesverbaleve**

7.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

- 7.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 7.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 7.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 8 Informacioni Konfidencial**

- 8.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 8.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës.

## **Neni 9 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 9.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 9.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta
- 9.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështeti dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 9.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 10 Detyrimet e Vecanta të Kontraktuesit**

- 10.1 Kontraktuesi bie dakord të kryejë shërbimin e pastrimit të zonës së përcaktuar, objekt i kësaj kontrate, bazuar në zërat e punës të përcaktuar në Preventiv si dhe në përputhje me "Specifikime teknike", grafikun e miratuar si dhe metodologjinë e punës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

- 10.2 Kontraktuesi është i detyruar që brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve të paraqesë të gjitha mjetet, makineritë dhe pajisjet e paraqitura në ofertë sipas specifikimeve të përcaktuara në kapitullin “Specifikimet Teknike”.
- 10.3 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë stafin dhe punonjësit e paraqitur në ofertë në gatishmëri për punë në datën e përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve.
- 10.4 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë të gjithë punonjësit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.
- 10.5 Përfaqësuesit e Kontraktuesit të cilët marrin pjesë gjatë kontrollit të përditshëm, duhet të jenë të autorizuar zyrtarisht nga Drejtori teknik i shërbimeve të pastrimit ose administratori i shoqërisë.
- 10.6 Kontraktuesi do të ndërpresë zbatimin e punimeve të shërbimit të pastrimit, për një afat kohor të caktuar, në ato raste kur për shkaqe teknike (punime për rikonstruksionin e rrugëve) kryerja e shërbimit ose e një pjese të shërbimit është e pamundur. Ndërprerja e shërbimit ose modifikimi i tij, për këtë rast do të kryhet vetëm pas njoftimit zyrtar dhe miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës.
- 10.7 Drejtori Teknik i Shërbimeve të Pastrimit është personi përgjegjës i cili nënshkruan të gjitha procesverbalet ditore të mbajtura nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës.
- 10.8 Kontraktuesi është i detyruar që të ketë në cdo kohë në gatishmëri, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga kontrata në përputhje me specifikimet teknike dhe ofertën e paraqitur në tender. Në rast se përdorimi i një pjese të mjeteve dhe pajisjeve është i pamundur për shkaqe teknike për zona ose pika të caktuara, Kontraktuesi mund të ndryshojë një pjesë të mjeteve dhe paisjeve vetëm pas verifikimit dhe miratimit nga Bashkia e Tiranës të pengesave teknike.
- 10.9 Kontraktuesi është i detyruar të realizojë shërbimin e marrë përsipër në përputhje të plotë me dokumentat e tenderit, metodologjise se punes si edhe specifikimeve teknike dhe grafikun e punimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

## **Neni 11 Lejet dhe Liçensat**

- 11.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

## **Neni 12 Raportet**

- 12.1 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore në të cilat duhet të parashikojë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe paisjeve të cilat përdoren për proceset e punës sipas preventivit në përputhje me Specifikimet teknike. Në raporte duhet të paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjitha rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë si dhe një

përmbledhje të të gjitha situacioneve të cilat ja përcjell Kontraktuesit gjatë kësaj kohe.

- 12.2 Kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës 5 kopje të raportit vjetor brenda 10 ditëve nga përfundimi i cdo viti kontraktual të shoqëruar me situacionin e fundit të shërbimit.
- 12.3 Kontraktuesi duhet të dorëzojë duke filluar nga data 1 e çdo muaji situacionin mujor sëbashku me faturën, mbi volumin e punimeve të kryera për muajin paraardhës, bashkangjitur së cilës do të jenë fatura e ujit dhe volumin e mbeturinave të transportuara gjatë muajit paraardhës, në vend depozitimit e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës me verifikimin e situacionit mujor kryen likuidimin e tij brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së situacionit për likuidim, mos dorezimi i ketyre dokumentave i jep te drejten Autoritetit Kontraktor për moskryerjen e likuidimit të situacionit deri në paraqitjen e tyre. Mos likuidimi i pajustificuar nga ana e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Tiranë për dy muaj rresht i jep të drejtën Kontraktuesit të pezullojë shërbimin dhe të kërkojë dëmshpërblim, për paisjet makineritë dhe treguesit e tjerë financiarë për periudhën e kontratës së mbetur pa u realizuar.

### **Neni 13      Personeli i Kontraktuesit**

- 13.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë trajtim për të gjithë të punësuarit e tij në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Shqipëri.
- 13.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.
- 13.3 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 13.4 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 13.5 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.
- 13.6 Të gjithë drejtuesit e automjeteve, të punësuar nga Kontraktuesi duhet të jenë të kualifikuar për makinat e largimit të mbeturinave, duhet të kenë patentë të vlefshme lëshuar nga Republika e Shqipërisë me kategorinë përkatëse.
- 13.7 Kontraktuesi duhet të specializojë të gjithë të punësuarit e tij, të cilët kanë të bëjnë me mbledhjen e mbeturinave të ngurta në mënyrë që të jenë në gjendje të dallojnë mbeturinat e rrezikshme të infektuara dhe të papranueshme.
- 13.8 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjithë punonjësit me uniforma dhe me shenja dalluese të kompanisë.
- 13.9 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndaluar punonjësit e tij të marrin, të nxisin, ose të kërkojnë pagim shtesë nga klientët, ose persona të tjerë publik për largimin e mbeturinave të ngurta.



- 13.10 Kontraktuesi është i detyruar në punësimin e punonjësve të japë përparësi punonjësve aktualë që punojnë me pastrimin, mbledhjen dhe transportin e këtyre mbeturinave.
- 13.11 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjitha mjetet dhe paisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë së tij ashtu siç përcaktohet dhe nenin 35 “Specifikimet Teknike”.
- 13.12 Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtuesin Teknik. Drejtuesi Teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik i Punimeve të objektit është: **Maksim Fejzulla**.
- 13.13 Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:
- Zbatimin e shërbimit të pastrimit konform kontratës;
  - Dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet;
  - Ecurinë e shërbimit të pastrimit konform plan - organizimit dhe grafikut të shërbimit;
- 13.14 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor.
- 13.15 Drejtuesi teknik në këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin Teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlerëson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues Teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Autoritetin Kontraktor.

#### **Neni 14 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

- 14.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 14.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.
- 14.3 Kontraktuesi duhet të sigurohet pranë një shoqërie sigurimi me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës deri në datën e përfundimit të plotë të shërbimit të pastrimit. Sigurimi do të kryhet për humbje ose dëmtim të pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të pronave dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 14.4 Rregulloret për çertifikatat e siguracionit do të dorëzohen Supervisorëve për aprovim brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës. I gjithë ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse Kontraktuesi dështon të sigurojë çertifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosi të zgjasë periudhën e paraqitjes të çertifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep Kontraktuesit.

- 14.5 Ndryshime në afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor.

#### **Neni 15 Mbeturina të rrezikshme**

- 15.1 Përfaqësuesit e Kontraktuesit (të punësuarit e tij), kur konstatojnë praninë e çdo mbeturine të papranueshme brenda dhe jashtë kontenierit duhet të lajmërojnë Autoritetin Kontraktor, Bashkinë e Tiranës për këto mbeturina toksike, infektive ose të rrezikshme në mënyrë që bashkërisht të marrin masa për largimin e tyre. Në këto raste të dyja palët kallëzojnë pranë organeve kompetente për ndjekjen ligjore të shkaktarit.

#### **Neni 16 Kontakti me publikun**

- 16.1 Kontraktuesi duhet të ketë një zyrë brenda juridiksionit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës me qëllim që të komunikojë me Bashkinë dhe publikun në përputhje me “Specifikimet Teknike” pjesë përbërëse e kësaj kontratë. Kontraktuesi është i detyruar të vendos një numer telefoni për publikun i cili duhet të komunikohet Autoritetit kontraktor brenda 1 muaji nga lidhja e kontrates.

#### **Neni 17 Edukimi Publik Ambiental**

- 17.1 Kontraktuesi duhet të zhvillojë një program të edukimit publik të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Tiranës për të rritur në maksimum pjesëmarrjen në programin e menaxhimit të mbeturinave duke vënë një theks të veçantë në grumbullimin e tyre në kontenierë, fshirjen e rrugëve, transporti i mbeturinave voluminoze, rrugët tregtare dhe respektimin e orareve përkatëse. Ky program edukimi do të kryhet nga Kontraktuesi në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Tiranës duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit masiv.
- 17.2 Kontraktuesi do të kryejë një herë në 6 muaj programin e Edukimit Ambiental sipas idesë dhe përcaktimeve që do të jepen nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës.
- 17.3 Autoriteti Kontraktor do t’i njoftojë kohën dhe afatin në të cilin do të prodhohet dhe transmetohet spoti ose materiali informativ i shkruar broshura ose fletëpalosje.
- 17.4 Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës do të njoftojë me shkrim mbi detajet e idesë për prodhimin dhe shpërndarjen e spoteve, broshurave ose fletëpalosjeve mbi edukimin ambiental.
- 17.5 Kostoja për prodhimin dhe promovimin e programit të edukimit publik do të mbulohet nga kontraktori.

#### **Neni 18 Taksat**

- 18.1 Kontraktuesi është i detyruar të paguaj të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

## **Neni 19      Kontenierët, mjediset dhe paisjet**

- 19.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës i përcakton Kontraktuesit pikat e vendgrumbullimit të mbeturinave dhe numrin e kontenierëve për çdo pikë në zonën e kontraktuar në përputhje me zërat e punës së përcaktuar në preventiv, me specifikimet teknike, listës së rrugëve dhe hartës të zonës, të miratuara, pjesë përbërëse të kësaj kontrate. Kontenieret janë pronë e Kontraktuesit.
- 19.2 Kontraktuesi do të vendosë kontenierët në vendgrumbullimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, shoqëruar me proces-verbaleve të mbajtur nga përfaqësuesit e secilës palë. Proces-verbale të përmbajnë numrin e kontenierëve dhe pikat e vendgrumbullimit ku do të vendosen kontenierët.
- 19.3 Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve, kur këta të fundit dëmtohen për çdo rast dhe për çdo shkak. Kontraktuesi merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit.
- 19.4 Kontraktuesi ka përgjegjësi për larjen dhe dizinfektimin e kontenierëve në përputhje me Specifikimet Teknike pjesë përbërëse të kësaj kontrate.
- 19.5 Kontraktuesi do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti Kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rastin e humbjes ose vjedhjes së kontenierëve, Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zëvendësimin fizik të kontenierëve.
- 19.6 Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës i përcakton kontraktuesit vendin e depozitimit të mbeturinave të ngurta urbane dhe voluminoze.

## **Neni 20      Detyrime të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës.**

- 20.1 Autoriteti Kontraktor sensibilizon në mënyrë të herë pas herëshme banorët nëpërmjet lajmërimeve zyrtare ose mediave të shkruara dhe elektronike për mbajtjen pastër të ambientit.
- 20.2 Autoriteti Kontraktor përgjigjet për mirëmbajtjen e rrugës që çon në vendin e hedhjes së mbeturinave dhe sistemimin e tyre në fushën e depozitimit. Depozitimi i mbeturinave do të kryhet gjatë gjithë ditëve të javës. Autoriteti Kontraktor merr përsipër sistemimin e ambjenteteve ku do të vendosen kontenjerët për të mundësuar kryerjen e shërbimit.
- 20.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë është e detyruar të kryej pagesën për punën e kryer nga ana e Kontraktuesit në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

## **Neni 21      Mbikqyrja gjatë kryerjes së shërbimit**

- 21.1 Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor në prani të përfaqësuesëve të autorizuar të Kontraktuesit, kryejnë kontroll ditor të shërbimit sipas grafikëve të miratuar, nga Bashkia e Tiranës.
- 21.2 Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor mbajnë proces – verbale dhe situacione ditore për masën e kryerjes së shërbimit, aplikojnë ndalesa, gjoba dhe llogarisin masën e ndalesave për punë të pakryer sipas dispozitave të kësaj kontrate.

- 21.3 Situacionet ditore vendosen në sasi sipas çdo zëri pune të shprehur në lekë në përputhje me procesverablet ditore dhe preventivin e kësaj kontrate.
- 21.4 Kontrolli i punimeve do të kryhet në vendin dhe kohën e përcaktuar nga të dyja palët në grafik. Situacionet që nuk pranohen të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit marrin vlerë dhe pa nënshkrimin e tij në këto raste:
- a. Kur përfaqësuesi i Kontraktuesit nuk është prezent në kontrollin e punës sipas grafikut.
  - b. Në rastet e kontrollit të përbashkët, kur konstatimet e Perfaqsesit të Autoritetit Kontraktor nuk kontestohen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit me anë të provave konkrete si fotografi, video me datën dhe orën e kryerjes së fotografimit ose filmimit. Në rastin e paraqitjes së provave të mësipërme dhe të mospranimit të tyre nga ana e Supervizorit atëherë Kontraktuesi mund ti drejtohet me ankesë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë.
- 21.5 Situacionet mujore do të hartohen në bazë të proçes-verbaleve dhe situacioneve ditore të nëshkruara nga të dyja palët.

## **Neni 22 Likujdimet**

- 22.1 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për pagesën në afat të punimeve të kryera. Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit mujor të paraqitur nga Kontraktuesi me vlerë sipas volumeve të kryera, duke u zbritur masa e volumeve të shërbimit të pakryer si dhe penalitetet e mbajtura për punë të pakryer. Në situacion duhet të përfshihet vlera e T.V.SH.
- 22.2 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për diferencën e kostos së transportit të mbeturinave, në rast ndryshimi të vendit të depozitimit të mbeturinave të ngurta.
- 22.3 Pagesa do të kryhet pranë Bankës Pro Credits Bank, në numrin e llogarisë së Kontraktuesit IBAN AL06209415070000500025890201. Në rast ndryshimi të llogarisë nga ana e Kontraktuesit ky i fundit është i detyruar të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë.

## **Neni 23 Afatet e Pagesës**

- 23.1 Kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit kontraktues me shkrim. Kërkesa duhet të shoqërohet me Situacionin mujor të shërbimit të kryer e të miratuar, së bashku me faturën e TVSH-së.
- 23.2 Pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarikë nga dita që është marrë kërkesa për pagesë nga ana e Kontraktuesit.
- 23.3 Dita e pagesës do të jetë dita që fondet debitojnë nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 24 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

- 24.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë përtej afateve të parashikuara në nenin 23, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet

pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.

- 24.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dëm me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

## **Neni 25 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

- 25.1 Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 25.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të shperblim për dëmet e shkaktuara për shkak të vonesës në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 25.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 25.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 25.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

## **Neni 26 Ndryshimi i porosisë**

- 26.1 Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën e porosisë shtesë deri në një sasi që nuk kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregulla dhe mënyra të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.
- 26.2 Nevoja për volume shtesë përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor (Bashkia Tiranë) e cila identifikon volumet shtesë të cilat nevojiten të kryhen në vazhdim të kontratës.

## **Neni 27 Ndalesat, Penalitete dhe Gjobat**

- 27.1 Kontraktuesi do ta zhdëmtojë Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Tiranës për çdo dëmtim të shkaktuar për shkak të tij.
- 27.2 Kontraktuesi i nënshtrohet ndalesave dhe penalteteve për punë të pakryer si më poshtë:

- a. Në rastet kur identifikohen zëra të punës së pakryer të parashikuar nga preventivi i kontratës nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, atëherë përveç ndalesës për punë të pakryer, Kontraktuesi do të penalizohet me 5 – fishin e vlerës së zërit përkatës.
- b. Në rastet kur Kontraktuesi nuk kryen me cilësinë e kërkuar nga specifikimet teknike të kontratës shërbimin e proceseve të parashikuara për ndonjë zë pune, përveç ndalesës së pagesës për zërin e punës, Kontraktuesi do të penalizohet me 2-fishin e vlerës së zërit përkatës.
- c. Në rast të mos riparimit të plotë të kontenierëve apo zëvendësimin e tyre (në mënyrë që të plotësojë kushtet teknike, estetike dhe higjienosanitare), brenda afatit të përcaktuar më sipër nga Kontraktuesi, këtij të fundit do ti vendoset penalitet në masën 50.000 lekë për çdo kontenier , vlerë e cila do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.
- d. Kontraktuesi është i detyruar të pajisë punonjësit e tij me uniforma në të cilat të jenë vendosur qartë shenjat dalluese të shoqërisë Kontraktuese. Në rast të mos respektimit të detyrimit të mësipërm Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë i aplikojnë Kontraktuesit gjobë në masën nga 50.000 lekë, masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.
- e. Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 17 dhe kapitullit “Specifikimet teknike” për kryerjen e Edukimit Publik Ambjental, supervisorët e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë aplikojnë gjobë në masën 500.000 (pesëqindmijë) lekë. Kontraktuesit do ti njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambjental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e Njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambjental Autoriteti Kontraktor vendos penalitetin e rradhës në masën 1.000.000 (njëmilion) lekë. Gjobat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor në situacionin e rradhës të paraqitur për likuidim nga ana e Kontraktorit.
- f. Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 10.8 Detyrimeve Vecanta të Kontraktuesit Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë, aplikojnë ndalesë në vlera prej 2,000,000 (dymilion) lekë. Masë e cila do të aplikohet cdo muaj, deri në plotësimin e detyrimit. Masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.

27.3 Penalitetet e përcaktuara në nenin 27.2 ( a,b,c ) nuk aplikohen në rast se shërbimi nuk është kryer për arsyet e përmendura në nenin 10.6 si dhe 10.8 të kësaj kontrate.

27.4 Penalitetet dhe gjobat e aplikuar më lart nuk përjashtojnë dhe masat e tjera penalizuese që mund të aplikohen nga Institucione të tjera të parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

## **Neni 28 Siguracioni i Punonjësve**

28.1 Kontraktuesi përgjigjet për punësimin dhe sigurimin e nëpunësve dhe punëtorëve, sipas legjislacionit në fuqi. Kontraktuesi duhet të ketë të siguruar një numër punonjësish jo më të vogël se numri i punonjësve të deklaruar në ofertë. Kontraktuesi duhet ti paraqesë me kërkesën e Autoritetit Kontraktor listën e të gjithë punonjësve të siguruar si dhe çdo informacion tjetër në lidhje me punonjësit e shoqërisë.

### **Neni 29 Rrethana të paparashikuara**

29.1 Rrethanat e paparashikuara për arsye të cilave shërbimi nuk mund të kryhet nga Kontraktuesi do të konsiderohen sa vijon:

- a. Luftë e deklaruar apo jo, luftë civile, kryengritje, revolucion ose nga ndonjë ngjarje tjetër krejtësisht jashtë kontrollit të Autoriteti Kontraktor, Bashkisë Tiranë ose Kontraktuesit.
- b. Katastrofa natyrore.
- c. Akte vandale të vërtetuara si të tilla nga Kontraktuesi.

29.2 Në qoftë se gjatë zbatimit të kontratës krijohen rrethana si ato të përmendura në pikat e mësipërme të cilat pengojnë kontraktuesin të përmbushin të gjitha detyrimet kontraktuale dhe që nuk janë në kompetencat e Kontraktuesit, ai autorizohet të mbyllë kontratën ose të kërkojë një plotësim të saj, në të cilat do të merren parasysh dhe rastet e sipërpërmendura.

### **Neni 30 Përfaqësimi i Autoritetit Kontraktor**

30.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë garanton se i ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm paraprake për nënshkrimin dhe lidhjen e kësaj kontrate duke iu përgjigjur detyrimeve Ligjore.

### **Neni 31 Komunikimi**

31.1 Mënyra e komunikimit midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë dhe Kontraktuesit do të jetë me shkrim. Të gjitha njoftimet të cilat palët do ti drejtojnë njëri tjetrit duhet të hartohen me shkrim dhe të dorëzohen personalisht, me postë zyrtare ose postë elektronike duke iu adresuar palëve në mënyrën e mëposhtme:

- a. Për përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës adresa e plotë e Institucionit ose adresa e postës elektronike,
- b. Për përfaqësuesin e kontraktuesit, adresa e plotë e kontraktuesit ose adresa e postës elektronike të cilat palët në çdo kohë ia komunikojnë njëri tjetrit me shkrim

31.2 Njoftimet do të kenë efekte me marrjen në dorëzim nga palet.

### **Neni 32 Përfaqësimi i Palëve**

- 32.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 32.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 32.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

### **Neni 33 Negociatat dhe Amendamentet**

- 33.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 33.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 33.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

### **Neni 34 Transferimi i të Drejtave**

- 34.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

### **Neni 35 Specifikimet teknike**

#### **35.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane dhe Tregjeve.**

##### **Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e **1026** kontenierëve të ndara në **494 PGM (pika të grumbullimit të mbetjeve)** me volum 1.7 m<sup>3</sup>, brenda zonës së kontraktuar.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, **915** zbrazje kontenierësh/ditë, për zonën urbane

111 zbrazje 3 here/javë (156 ditë në vit) për zonën rurale (Farkë Rurale, Bërzhidë, Krrabë, Petrelë )

Në momentin që Autoriteti Kontraktor do të aktivizojë procesin e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në zonën "Tirana 2", 152 kontenierë do të do te bëhen pjese e këtij procesi.



Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën **Tirana 2** dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate.

Te gjithë kontenieret si dhe mirëmbajtja e tyre do të ofrohen nga Operatori i Shërbimit. Operatori i shërbimit duhet të disponojë 30 % te sasise se kerkuar te konteniereve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e shpalljes fitues dhe sasia e mbetur do të vendoset në zonën e pastrimit sipas pikave të grumbullimit, brenda 2 (dy) muajve nga data e fillimit të shërbimit.

### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a. Zbrazen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.

b. Duhet të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri ose duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

### **Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve**

a. Autoriteti kontratues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës së kontraktuar (396 PGM pjesa Tirana urbane, 32 PGM Nja Petrelë, 14 PGM Nja Krrabë, 32 PGM Nja Farke rural, 20 Nja Bërzhidë, në total 494 PGM. (Vendosja e tyre në vendet e përcaktuara do të bëhet sipas sistemit koordinativ(x,y) EGS 1984).

b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoritetit kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë konsiderohet e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.

2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**d.** Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës (për zonën urbane dhe gjysëm urbane) duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona urbane dhe gjysëm urbane të jetë krejtësisht e pastër, ndërsa për zonën rurale ky shërbim të kryhet gjatë ditës.

Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

**e.** Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërbushjen e tyre.

**f.** Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të kontenerëve dhe e pikave të grumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të shpeshtohet në funksion të sasise së depozituar të mbetjeve por gjithmonë duke mos kaluar parashikimin kontraktual dhe preventivin e punimeve.

### **Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të pa transportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete.

**b.** Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

**c.** Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontraktor në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontraktor.

**d.** Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së

parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t'u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**e.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

**f.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**g.** Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimive të pastrimit.

**h.** N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rena gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**i.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **8 (tetë) copë**;
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **3 (tre) copë**;
3. Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin "Specifikimet teknike", pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjëndje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenerët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenerëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenerëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenerëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori do të riparojë ose të zëvendësojë kontenerët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenerëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenerëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete.
- e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenerëve.
- f. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenerët duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet dhe kontenerët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

### **35.2 Larja dhe dezinfektimi i kontenerëve**

#### **Volumet e punimeve**

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë 1026 kontenerë të volumeve 1.7 m<sup>3</sup>/ në muaj ose mesatarisht 34 kontenerë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontratues.

#### **Metodologjia**

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenerët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje. Kontenerët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.

2. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezifektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezifektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

### **Grafikët e punimeve**

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezifektimin e kontenierëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penaltete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **Rregulla për t'u zbatuar**

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..

### **Mjetet dhe pajisjet**

1. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një)copë**.
2. Lëndë dezifektuese dhe aromatizuese për dezifektimin e kontenierëve.
3. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezifektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezifektimin e kontenierëve.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

### **35.3 Mirëmbajtja e vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme.**

### **Volumet e punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht pikat e grumbullimit të mbetjeve, **396** vendgrumbullime mbetjesh. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën “Tirana 2” si dhe në hartën për këto zone.

### **Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

**a.** Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonën perkatese, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (amballazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t’u depozituar nëpër kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën perkatese sado larg kontenierit të jetë hedhur.

**b.** Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme, të hedhura jashtë kontenierëve, si dhe në gjithë hapësirat publike dhe territoriale të zonës do të përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.

**d.** Pas pastrimit kontenierët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.

**f.** Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e këtij shërbimi, pregatiten nga sipermarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën vendgrumbullim mbetjesh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

**g.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

**h.** Grafikët që do të paraqiten për miratim, duhet të pregatiten në mënyrë të tillë që punimet të fillojnë nga ora 10.00 deri në 18.00, me qëllim që gjithë kësaj periudhe kohore të gjithë kontenierët dhe vendet rreth tyre të jenë krejtësisht të pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

**i.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërmbushjen e tyre.

**j.** Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër pikën e grumbullimit të mbeturinave në përputhje me Rregullores me VKB Nr.1 dt.05.02.2007 “Për Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit”.

**k.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kontenierë të tejmbushur me mbetje urbane, ndërtime, të vëllimshme dhe sipërfaqe rreth tyre të papastruara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga njoftimi apo konstatimi i problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit dhe do të përballet me penalitetet e parashikuara në përputhje me me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**l.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe deklaruar të të makinerive dhe pajisjeve dhe punëtorë për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

**m.** Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë operatori i shërbimit për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballet me penalitetet dhe gjopa në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**n.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

**P.** Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të pikave vendgrumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve voluminoze pagesa për këtë shërbim do të kryhet sipas numrit faktik të këtyre vendgrumbullimeve në terren. Cdo ndryshim do të reflektohet në situacionet mujore të pagesave.

## **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane dhe mbetjeve ndërtime, të vëllimshme si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

2. Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimeve dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**;
3. Vegla pune si lopata, fshesa për të gjithë shoferët dhe punëtorët.

4. Çdo makineri për kryerjen e këtij shërbimi duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
5. Një listë e makinave për transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së mësipërme
6. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit dhe një numër kontenierësh me volum të madh duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
7. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

### **35.4 Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.**

#### **Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **622,404** m<sup>2</sup> dhe volume ditore prej 490,421 m<sup>2</sup> në ditë (rrugët e kategorisë së III do të fshihen **2** herë në javë). Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 2 (bashkëngjitur kësaj kontrate) dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate.

#### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

**a.** Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj (për rrugët e kategorisë së I), si dhe sipërfaqen e plotë rrugë + trotuar për kategorinë e III.

**b.** Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.

**c.** Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.

**d.** Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.



e. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambientit rreth tyre bëhet gjatë natës.

f. Proçesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotualet e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotualet e qytetit).

### **Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.

b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

### **Rregulla për t'u zbatuar**

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një "Zyrë të Kontaktimit" për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së

parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**d.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

**e.** Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**f.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

**g.** Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

**h.** Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
2. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

### **35.5 Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike.**

#### **Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet. në një gjatësi lineare prej

**18,974** ml në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 2 dhe sipas hartës bashkëngjitur.

### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

**a.** Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë nga parkimi. Më pas çdo mbeturinë e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punëtorët e shërbimit të fshirjes me krahë..

**b.** Në të gjitha gjatësitë lineare dhe segmentet e lira nga parkimi, të rrugëve , të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri. Fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

### **Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora **21.00-04.00**.

**b.** Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 7.00 zona të jetë krejtësisht e pastër.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.

2. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

### **Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë

se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit .

**b.** Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja e rrugës me makineri teknologjike për fshirjen e rrugëve, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.

**d.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

**e.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;
- b. Makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e rrugëve, mund të kontrollohen në çdo kohe nga Autoriteti kontrator për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të lahen dhe pastrohen në fillim ose në fund të intinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.
- c. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontrator sipas një formati të miratuar paraprakisht.
- d. Automjetet, pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kësaj kontrate.
- e. Një listë e makinave fshirëse do t'i paraqitet Autoritetit kontrator para fillimit të veprimtarisë së fshirjes.

## **35.6 Mirëmbajtja dhe pastrimi gjatë ditës i akseve kryesore rrugore.**

### **Volumi i punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht të gjitha trotuaret e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha trotuaret e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, për një pjesë të rrugëve në një sipërfaqe prej **34,286** m<sup>2</sup> në ditë nga ora 10.00 deri 18.00 .

Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve për zonën Tirana 2, sipas hartës bashkëngjitur.

### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbim i mirëmbajtjes dhe pastrimit të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, konsiston në:

Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet për mbulim si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve, mbajtjen pastër gjatë ditës të koshave rrugorë dhe vendit rreth tyre, etj

### **Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të bëhet gjatë ditës nga ora 10.00 deri 18.00  
**c.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që gjatë gjithë ditës trotuarët e përcaktuar për shërbim të jenë krejtësisht e pastër ose duke u pastruar.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit, pregatiten nga sipërmarresi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo segment rrugorë.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penaltete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **Rregulla për t'u zbatuar**

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen trotuare të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit .

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.

d. Gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujës-jellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrore apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t’i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

e. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të pastrimit gjatë ditës, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

f. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoha për mosplotësim të tyre.

h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

### **Mjetet dhe pajisjet**

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundur kryerjen me cilësi të shërbimit.

### **35.7 Larja e rrugëve me makinë teknologjike**

#### **Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës ashtu dhe për shërbimin e dytë të larjes gjatë ditës.

1. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim një herë në ditë gjatë natës, parashikuar në metodologji për të

gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 79,956 m<sup>2</sup> në ditë përgjatë 305 ditëve të periudhës kontraktuale. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e larjes me makineri për zonën Tirana 2.

2. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makineri si shërbim i dytë ditor, si larje gjatë ditës në një sipërfaqe të përgjithshme prej 79,956 m<sup>2</sup>/ditë, sipas listës së rrugëve dhe volumeve të përcaktuara për larjen dy herë në ditë, për zonën Tirana 2 përgjatë muajve më të nxehtë të vitit.( gjithsej 240 ditë)

### **Specifikimet teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

1. Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.
2. Larjen me presion, me makineri teknologjike larëse, si shërbim i dytë ditor, të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara për këtë shërbim, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.
3. Gjatë shërbimit të parë të larjes (gjatë natës) shpejtësia e operimit të makinave larëse gjatë procesit të larjes (zbrazjes së ujit) duhet të variojë nga 8-10 km/orë kurse gjatë shërbimit të dytë të larjes nga 15-20 km/orë.

### **Plani i Punës dhe grafikët e punimeve**

1. Larja e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.
2. Larja e rrugëve si shërbim i dytë ditor, do bëhet çdo ditë, gjatë periudhës 15 Mars – 15 Nëntor , ( gjithsej 240 ditë) nga ora 12.00 –19.00.
3. Larja me presion, me makinë teknologjike do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 07.00 dhe në orën 19.00 për shërbimin e dytë të larjes, zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e larë.
4. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
5. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

6. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

7. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **Rregulla për tu zbatuar**

1. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.

2. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e larjes me presion të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0,8 litër ujë për 1 m<sup>2</sup> rrugë për larjen e darkës dhe 0.6 litër ujë për m<sup>2</sup> për larjen e ditës.

3. Larja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë.

4. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes me makineri për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.

5. Përfaqësuesit e Autoritetit kontraktor do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes së dytë dhe mund ti kërkojë Operatorit të Shërbimit kryerjen e këtij shërbimi në ditët e tjera të vitit ose gjatë stinës së verës kur të jetë e nevojshme, në përputhje me çmimet njësi të preventivit të punimeve dhe sipërfaqeve të rrugëve sipas listës së rrugëve bashkëngjitur kontratës, një kërkesë zyrtare të Autoritetit kontraktor, si dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.

6. Do të konsiderohet e pavlefshme larja e rrugëve në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontraktor për shkaqe të ndryshme.

7. Autoriteti kontraktor do të nxisë Operatori i shërbimitn të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për larjen e rrugëve, si puse, etj.

8. Listat përkatëse të rrugëve që do lahen i bashkëngjiten kësaj kontrate.

9. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do mbarten nga operatori i shërbimit.

10. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për larjen e rrugëve.



## **Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

1. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **1 (një) copë**; Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.
2. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
3. Të gjitha makinat për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
5. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.
6. Një listë e makinave larëse do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së larjes.

### **35.8 “Edukimi Publik Mjedisor”**

Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatori i shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së operatori i shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Ky kontakt mund të realizohet si nëpërmjet mass-mediave ashtu edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese.

Operatori i shërbimit duhet të mundësoj shpërndarjen e materialeve informative të paktën një here në gjashtë muaj (duke filluar nga dita e firmosjes së kontratës). Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotjes, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese

duhet të jenë të tilla që të ftojnë qytetarët e kryeqytetit të bëhen pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

Operatori i shërbimit duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik mjedisor që të parkohet në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.

Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontraktor.

Në rast të mos përmbushjes të edukimit mjedisor apo plotësimit të pjesshëm të tij aplikohen gjyba.

Ne bashkepunim me Autoritetin Kontraktor, Operatori i zones duhet te pregatisë dhe te promovojë spote publicitare qe percjellin mesazhin e Bashkise Tirane ne kete kontekst. Keto spote duhet te realizohen dhe te publikohen ne disa nga TV e Kryeqytetit që do të saktësohen nga Autoriteti Kontraktor, fluksi i promovimit te tyre do te saktësohet nga Autoriteti Kontraktor ndersa kostot e ketij sherbimi do te jene ne ngarkim te Operatorit te shërbimit.

### **35.9. Specifikimet teknike të Kontenierëve**

**Sasia e kërkuar e kontenierëve për zonën “Tirana II” është 1026 copë.**

#### **TE DHENA TEKNIKE TE KONTENIERIT 1700 LITRA:**

Kontenierët do të përdoren për grumbullimin e mbetjeve urbane dhe duhet të kenë karakteristikat si më poshtë vijojnë:

#### ***Trupi i kontenierit (vaska):***

Trupi i kontenierit nga brenda (vaska e zinguar). Ekstra përforcim i bazës së rrotës, i ngjitur tek kontenieri. Sistem kullimi fundor për derdhjen e lëngjeve të grumbulluar nga mbetjet apo gjatë larjes së kontenierit. Kapaciteti i plote 1700 litra. Doreza anesore për terheqjen e kontenierit.

Kontenierët duhet të jenë të lyer me bojë(vaska) Portokalli,(kapaku i kuq). Spesori i profilit te vaskes 1.5-4 mm.

#### **Kapaku**

Metalik. Me përforcues të tërthortë për ekstra rezistencë.Profil i harkuar ose i drejtë për rrjedhje të ujrave të shiut. Sistemi i hapjes së kapakut me pedale qëndrore. Ndër të tjera kapaku duhet jetë i pajisur edhe me një dorezë, në pjesën e përparme ose anesore, për raste të hapjes së kapakut në mënyrë manuale.Ngjyra e kapakut, e kuqe.

#### **Pedalja**

Pedalja duhet të jetë me profil metalik me spesor 4 mm për ekstra rezistencë.

#### **Rrotat**

Rrota rezistente me çelik të galvanizuar në qendër dhe unazë gome rezistente në pjesën e kontaktit me tokën. Diametri i rrotës 200mm dhe me rrotullim 360°. 4 rrota të kthyeshme (me kokë rrotulluese), me gomë plastike solide, me kuzhineta, kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 250kg;

## **Modeli i kapjes së kazanit**

Attacco Bologna/ Din.

### **Sinjalistika**

Operatori duhet të sigurojë dhe ngjisë adezivë tek kazanët, me informacion mbi mënyrën e dorëzimit të mbetjeve, ndalimet, eiketa, adëzivë për ndalim parkimi para kazanëve, shirita me ngjyre fosforeshente, logo e Bashkisë së Tiranës. (Pas miratimit të formatit nga Bashkia Tirane). Ofertuesi mund të ofrojë edhe modele të tjera por duke marrë paraprakisht miratimin e autoritetit kontraktor si dhe duke respektuar gjithnjë kohën e parashikuar për dorëzimin e kontenierëve.

### **Targë e fiksuar (gozhduar) ose e stampuar**

Mbi çdo kazanë, nga prodhuesi, do të fiksohet një targë me dimension 10cm x 4cm ku do të stampohet një kod identifikimi për kazanin me 6 shifra (duke u nisur nga 000000 e deri në 002500), viti i fabrikimit të kazanit dhe kapaciteti.

### **Përputhja**

Sipas normativës UNI EN 840 (UNI 10571).

### **Të tjera.**

Kazani duhet të jetë në gjendje të durojë gjatë kohës, për të gjithë përbërsit, temperatura nga -20°C deri +50°C;

Kazani duhet të strukturuar në mënyrë që të garantojë një mbajtje peshe deri në 450kg, pa pësuar asnjë deformim permanent

Hapja minimale, me gjysëm pedale duhet të jetë 450mm, ndërsa në fazën e zbrazjes ose të larjes duhet të jetë minimalisht 1000mm.

## **Neni 36 Forca Madhore**

36.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

36.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

36.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij

sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

### **Neni 37      Garancia e kontratës**

- 37.1** Garancia e kontratës do të jetë në masën 10 % të vlerës totale të kontratës të llogaritur në bazë të preventivit total të ofruar nga shoqëria fituese dhe konkretisht në vlerën **61,242,724** (gjashtëdhjetë e një million e dyqind e dyzetë e dy mijë e shtatëqind e njëzetë e katër) **lekë**.
- 37.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 37.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.
- 37.4 Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontrates.

### **Neni 38      Klauzolë shtesë**

- 38.1 Kushtet dhe termat e kësaj kontrate nuk mund të ndryshohen ose modifikohen përveçse me vullnetin e palëve.

### **Neni 39      Legjislacioni**

- 39.1 Kontrata do të qeveriset nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

### **Neni 40    Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

- 40.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

### **Neni 41    Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

- 41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.
- 41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

### **Neni 42    Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

- 42.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 42.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

42.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

#### **Neni 43 Ndërprerja për Mosplotësim**

43.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

43.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

#### **Neni 44 Zgjidhja e kontratës**

44.1 Në rast të shkeljeve të dispozitave të kësaj kontrate nga pala shkelëse, ajo është e detyruar ti rregullojë ato. Palës shkelëse i ngarkohen shpenzimet e rregullimit të këtyre shkeljeve.

44.2 Me konstatimin e shkeljeve të kontratës, Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës i bën njoftim me shkrim Kontraktuesit për konstatimin dhe detyrimin e Kontraktuesit për rregullimin e tyre brenda afateve të parashikuara në kontratë.

44.3 Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë po nuk kufizohen në sa vijon:

- a. Nëse Kontraktuesi nuk kryen shërbimin e pastrimit në një pjesë të zonës apo në të gjithë zonën e parashikuar në këtë kontratë, për një periudhë të pandërprerë prej 7 ditësh me përjashtim të rastit të përcaktuar në neni 10.7 të kësaj kontrate.
- b. Nëse masa e punës së pakryer dhe e penaliteteve të aplikuara tejkalon 15 % të vlerës vjetore të kontratës.
- c. Nëse Kontraktuesi falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit.
- d. Nëse Kontraktuesi nuk ka në dispozicion dhe gjëndje pune, apo ndryshon gjatë kohëzgjatjes së kontratës automjetet e kërkuara sipas Specifikimeve Teknike dhe të paraqitura nga Kontraktuesi në ofertë pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë.

44.4 Nëse kontrata për shkak të shkeljeve priset atëherë Autoritetit Kontraktor Bashkisë i lindin këto të drejta:

- a. E drejta për të deklaruar kontratën të prishur duke i dhënë Kontraktuesit një njoftim me shkrim brenda një afati prej 30 ditësh, me argumentat përkatëse. Në qoftë se kontrata priset, Kontraktuesi duhet të sigurojë shërbimin e pastrimit për një periudhë prej 90 ditësh nga dita e njoftimit të prishjes së kontratës. Për këtë kohë Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë është e detyruar të kryejë pagesën e shërbimit.

- b. Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, ka të drejtën të sekuestrojë garancinë e kontratës të ngurtësuar në masën e përcaktuar në kontratë.
- c. Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës ka të drejtën që t'i kërkojë dëmshpërblim Kontraktuesit në masën e dëmit të shkaktuar.

#### **Neni 45 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 45.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
- 45.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 46 Dokumente që i bashkëlidhen kësaj kontrate**

Pjesë Integrale e kësaj kontrate do të jenë:

1. Sigurimi i Kontratës
2. Formulari i Ofertës
3. Preventivi i shërbimeve
4. Specifikimet teknike
5. Material shpjegues Volume Larje/Fshirje/Mirëmbajtje/Kontenierë.
6. Harta treguese në zonën Tirana 2.

#### **Neni 47 Të përgjithshme**

Kjo kontratë hartohet në 6 (gjashtë) kopje të njëjta në gjuhën shqipe, prej të cilave 4 (katër) kopje i mban Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë dhe 1 (një) kopje e mban Kontraktuesi.

### **PALËT KONTRAKTUESE**

**AUTORITETI KONTRAKTOR**

**BASHKIA E TIRANËS**

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

**Erion VELIAJ**

**Titullar i Autoritetit Kontraktor**

**KONTRAKTUESI**

**“KORSEL” SHPK**

**“BRAI-CATA” srl**

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

**Maksim FEJZULLA**

**CEAUSESCU Nicolae Daniel**

**Administratori**



BASHKIA  
TIRANË

---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

NR.PROT. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_2018

**KONTRATË SHËRBIMI**

**“SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS TIRANA III”**

**TIRANË**

**2018**

## KONTRATË SHËRBIMI

### “SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS TIRANA III”

Sot me datë \_\_\_/\_\_\_/ 2018, nënshkruhet kjo Kontratë,

*Ndërmjet palëve:*

**BASHKISË SË TIRANËS**, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) K11729002L e përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor me adresë në Sheshi „Skënderbej“, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, që më poshtë do të quhet “**Autoriteti Kontraktor**”;

dhe

Shoqërisë “**Alko Impex general**” degë e shoqërisë së huaj. e regjistruar me Rregjistrim Fillestar CN-202267-01-09, datë 26.01.2009, me seli të shoqërisë në adresën Rr.“Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Kati 8, prane St. te Trenit, Tiranë me administrator të shoqërisë Z. Arbër Abazi me Nipt K91326028I i mëposhtëquajtur “**Kontraktor**”;

#### **Neni 1 Baza Ligjore**

Të dyja palët, në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, bazuar në Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 659 e vijues, të Ligjit Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, Vkm. Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të nxjerrë në zbatim të tij, Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit “**Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III**”, si dhe ofertës të paraqitur nga Kontraktuesi për këtë procedurë të zhvilluar në datë 27.09.2017, bien dakort përsa më poshtë:

#### **Neni 2 Përkufizimet**

2.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit të procedurës për Prokurim me Objekt “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III», duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“**Çmim kontrate**” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“**Objekt i kontratës**” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.



“**Palë (t)**” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“**Autoriteti Kontraktor**” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“**Kontraktues**” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

“**Shërbime**” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

“**Termat e References**” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

“**Llogaritja e Afateve**” Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

“**Mbetje**” është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

“**Mbeturina të vëllimshme dhe inerte**”: do të konsiderohen në kuptimin e kësaj kontrate mbetjet urbane voluminoze si: pajisje elektroshtëpiake, karkasa makinash, mbetje bimore të drunjtave, pajisje mobiljesh, orendi dhe të gjitha llojet e objekteve të tjera të cilat për shkak të volumit, formës dhe përbërjes së tyre nuk mund të hidhen dhe nuk duhet të hidhen në kontenerët me volume prej 1.7 m<sup>3</sup>, të parashikuar për të kryer shërbimin. Në këtë grup do të përfshihen edhe mbeturinat solide inerte si: materiale mbetjesh ndërtimore, gërmimesh dhe prishjesh, dherëra, gurë, materiale qeramike, zhavore, etj, me prejardhje nga familjet.

“**Krijues i mbetjeve**” quhen të gjitha subjektet private komerciale, shërbimi, artizanale prodhuese, institucionale, tregjet e të gjitha llojeve, shërbimet ambulante, dhe të gjithë banorët rezidentë apo ata që bëhen rezidentë gjatë kohës së kontratës brenda zonës që do të kryhet aktiviteti i Kontraktuesit me kufij sipas hartës të vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Në kategorinë e Krijuesit i mbetjeve përfshihen dhe zjarrfikësat, stacionet policore, Bashkia dhe Njësitë Administrative, të gjitha godinat publike dhe shtetërore si dhe të gjithë institucionet arsimore publike dhe private të qytetit, të cilat ndodhen brenda kufizimeve të zonës në të cilën do të kryhet shërbimi objekt i kësaj kontrate.

“**Edukim Publik Ambiental**” nënkupton përpjekjet për ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të konsumatorëve apo banorëve të qytetit me qëllim përpunimin, transportin, largimin ose aspekte të tjera që lidhen me mbajtjen pastër të ambientit.

“**Zonë e kontratës**” quhet hapësira e territorit brenda kufijve të përcaktuar në hartë. Kjo hartë është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, ku Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë shërbimet e pastrimit, administrimit e mbeturinave ndaj konsumatorëve ekzistues si dhe konsumatorëve që mund të shtohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

“**Proçes – Verbal**” quhet dokumenti i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë mbi kontrollin e ushtruar në terren që reflekton punën e pakryer, gjobat

e penaltitet e vendosura në përputhje me kushtet e kësaj kontrate, cilësinë e shërbimit të pastrimit dhe problemet e konstatuara gjatë kontrollit.

**“Preventivi”** quhen vëllimet e punës të plotësuara me çmime, pjesë përbërëse e kontratës.

**”Situacioni”** quhet dokumenti i evidentimit faktik të situatës së punës së kryer në përputhje me zërat e punimeve të përcaktuar në kontratë (volumeve), në përputhje me precesverbalet ditore, i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës. Situacionet janë ditore, mujore dhe vjetore.

**“Vlera totale e kontratës”** quhet shumatorja e viteve kontraktuale në përputhje me preventivat e punimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate duke përfshirë dhe rishikimin e çmimit në përputhje me inflacionin e deklaruar.

**“Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor”**, quhen personat kompetent të emëruar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë të cilët janë përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të shërbimit të pastrimit dhe administrimit të kontratës.

**“Drejtori Teknik i Shërbimeve të Pastrimit”** është personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës, përfaqësues i Kontraktuesit, përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të pastrimit.

**“Vend Grumbullimi i Mbeturinave (VGM)”** është hapësira në të cilën do të kryhet shërbimi i heqjes së mbeturinave nga kontenierët dhe zona përreth kontenierëve siç është përcaktuar në hartë dhe në specifikimet teknike bashkëngjitur këtyre dokumentave të tenderit.

### **Neni 3           Objekti i Kontratës**

3.1     Objekti i kësaj kontrate është **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”**.

### **Neni 4           Afati i Kontratës**

4.1     Afati i kryerjes së shërbimit është **365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike x 3 (tre) vite nga data e lidhjes së kontratës**. Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe fillon efektet e saj në datë \_\_\_/\_\_\_/2018, ora 00.<sup>01</sup> kohë në të cilën kontraktuesi fillon pune menjëherë.

4.2     **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e rishikimit të volumeve të punimeve, objekt i kontratës në rast të ndryshimit të politikave të institucionit (Autoriteti Kontraktor) lidhur me ofrimin e shërbimit të pastrimit.**

### **Neni 5           Vlera Totale dhe Vjetore e Kontratës**

5.1 Vlera totale e kontratës në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës është **568,519,169 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë me TVSH**

5.2 Vlera vjetore e kontratës në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës është 189,506,390 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë) **lekë me TVSH në vit.**

## Neni 6 Preventivi i Punimeve.

6.1 Vlerësimi i zërave të punës do të kryhet në bazë të preventivit të ofertës të paraqitur në tender nga Kontraktuesi **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I”** për volumet e përcaktuara si më poshtë:

EMERTIMI I SHERBIMEVE	NJESIA	VOLUMET PUNIMEVE	VOLUMENE DITE	ÇMIMI NJESI	VLERA (DITE)	DITE PUNE /VIT	VLERA (VJETORE)
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 7/JAVE	KONTENIER /DITE	796	796	450	358,200	365	130,743,000
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 3 /JAVE	KONTENIER /DITE	110	110	450	49,500	156	7,722,000
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 2 /JAVE	KONTENIER /DITE	44	44	450	19,800	104	2,059,200
LARJA DHE DEZIFKTIMI I KONTENIEREVE	COPE / 30 DITE	951	32	15	480	365	175,200
MIREMBAJTJA E VEND GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE GJATE DITES DHE GRUMBULLIMI I MBETJEVE NDERTIMORE DHE TE VELLIMSHME	PIKA /DITE	338	338	50	16,900	365	6,168,500
FSHIRJA E RRUGEVE DHE TROTUAREVE ME PUNETORE	M2/DITE	401,897	401,897	0.05	20,095	365	7,334,620
FSHIRJA E RRUGEVE ME MAKINERI	ML/DITË	16,736	16,736	0.04	669	365	244,346
MIREMBAJTJE RRUGESH KRYESORE	M2/DITE	44,937	44,937	0.04	1,797	365	656,080

LARJA E PARE E RRUGEVE (PARASHIKUAR PER 10 MUAJ TE VITIT)	M2/DITË	129,314	123,314	0.04	5,173	305	1,577,631
LARJA E DYTE E RRUGEVE (PARASHIKUAR PER 8 MUAJ TE VITIT OSE 240 DITE)	M2/DITË	129,314	129,314	0.04	5,173	240	1,241,414
SHUMA VITI 1							157,921,991
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							31,584,398
VLERA PERFUNDIMTARE							189,506,390
SHUMA VITI 2							157,921,991
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							31,584,398
VLERA PERFUNDIMTARE							189,506,390
SHUMA VITI 3							157,921,991
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							31,584,398
VLERA PERFUNDIMTARE							189,506,390
SHUMA VITI 1+2+3_PA TVSH							473,765,974
SHUMA VITI 1+2+3_ME TVSH							568,519,169

6.2 Preventivi i punimeve do të përdoret për llogaritjen e situacioneve që do të paraqiten për likuidim.

## **Neni 7 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli Procesverbaleve**

7.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

7.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

- 7.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 7.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 8 Informacioni Konfidencial**

- 8.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 8.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës.

## **Neni 9 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 9.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 9.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta
- 9.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 9.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 10 Detyrimet e Vecanta të Kontraktuesit**

- 10.1 Kontraktuesi bie dakord të kryejë shërbimin e pastrimit të zonës së përcaktuar, objekt i kësaj kontrate, bazuar në zërat e punës të përcaktuar në Preventiv si dhe në përputhje me "Specifikime teknike", grafikun e miratuar si dhe metodologjinë e punës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.
- 10.2 Kontraktuesi është i detyruar që brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve të paraqesë të gjitha mjetet, makineritë dhe pajisjet e paraqitura në ofertë sipas specifikimeve të përcaktuara në kapitullin "Specifikimet Teknike".

- 10.3 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë stafin dhe punonjësit e paraqitur në ofertë në gatishmëri për punë në datën e përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve.
- 10.4 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë të gjithë punonjësit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.
- 10.5 Përfaqësuesit e Kontraktuesit të cilët marrin pjesë gjatë kontrollit të përditshëm, duhet të jenë të autorizuar zyrtarisht nga Drejtori teknik i shërbimeve të pastrimit ose administratori i shoqërisë.
- 10.6 Kontraktuesi do të ndërpresë zbatimin e punimeve të shërbimit të pastrimit, për një afat kohor të caktuar, në ato raste kur për shkaqe teknike (punime për rikonstruksionin e rrugëve) kryerja e shërbimit ose e një pjese të shërbimit është e pamundur. Ndërprerja e shërbimit ose modifikimi i tij, për këtë rast do të kryhet vetëm pas njoftimit zyrtar dhe miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës.
- 10.7 Drejtori Teknik i Shërbimeve të Pastrimit është personi përgjegjës i cili nënshkruan të gjitha procesverbalet ditore të mbajtura nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës.
- 10.8 Kontraktuesi është i detyruar që të ketë në cdo kohë në gatishmëri, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga kontrata në përputhje me specifikimet teknike dhe ofertën e paraqitur në tender. Në rast se përdorimi i një pjese të mjeteve dhe pajisjeve është i pamundur për shkaqe teknike për zona ose pika të caktuara, Kontraktuesi mund të ndryshojë një pjesë të mjeteve dhe paisjeve vetëm pas verifikimit dhe miratimit nga Bashkia e Tiranës të pengesave teknike.
- 10.9 Kontraktuesi është i detyruar të realizojë shërbimin e marrë përsipër në përputhje të plotë me dokumentat e tenderit, metodologjise se punes si edhe specifikimeve teknike dhe grafikun e punimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

## **Neni 11 Lejet dhe Liçensat**

- 11.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

## **Neni 12 Raportet**

- 12.1 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore në të cilat duhet të parashikojë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe paisjeve të cilat përdoren për proceset e punës sipas preventivit në përputhje me Specifikimet teknike. Në raporte duhet të paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjitha rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë si dhe një përmbledhje të të gjitha situacioneve të cilat ja përcjell Kontraktuesit gjatë kësaj kohe.
- 12.2 Kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës 5 kopje të raportit vjetor brenda 10 ditëve nga përfundimi i cdo viti kontraktual të shoqëruar me situacionin e fundit të shërbimit.

- 12.3 Kontraktuesi duhet të dorëzojë duke filluar nga data 1 e çdo muaji situacionin mujor sëbashku me faturën, mbi volumin e punimeve të kryera për muajin paraardhës, bashkangjitur së cilës do të jenë fatura e ujit dhe volumin e mbeturinave të transportuara gjatë muajit paraardhës, në vend depozitimit e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës me verifikimin e situacionit mujor kryen likuidimin e tij brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së situacionit për likuidim, mos dorezimi i ketyre dokumentave i jep te drejten Autoritetit Kontraktor për moskryrjen e likuidimit të situacionit deri në paraqitjen e tyre. Mos likuidimi i pajustificuar nga ana e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Tiranë për dy muaj rresht i jep të drejtën Kontraktuesit të pezullojë shërbimin dhe të kërkojë dëmshpërbim, për paisjet makineritë dhe treguesit e tjerë financiarë për periudhën e kontratës së mbetur pa u realizuar.

### **Neni 13 Personeli i Kontraktuesit**

- 13.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë trajtim për të gjithë të punësuarit e tij në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Shqipëri.
- 13.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.
- 13.3 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 13.4 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.
- 13.5 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.
- 13.6 Të gjithë drejtuesit e automjeteve, të punësuar nga Kontraktuesi duhet të jenë të kualifikuar për makinat e largimit të mbeturinave, duhet të kenë patentë të vlefshme lëshuar nga Republika e Shqipërisë me kategorinë përkatëse.
- 13.7 Kontraktuesi duhet të specializojë të gjithë të punësuarit e tij, të cilët kanë të bëjnë me mbledhjen e mbeturinave të ngurta në mënyrë që të jenë në gjendje të dallojnë mbeturinat e rrezikshme të infektuara dhe të papranueshme.
- 13.8 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjithë punonjësit me uniforma dhe me shenja dalluese të kompanisë.
- 13.9 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndaluar punonjësit e tij të marrin, të nxisin, ose të kërkojnë pagim shtesë nga klientët, ose persona të tjerë publik për largimin e mbeturinave të ngurta.
- 13.10 Kontraktuesi është i detyruar në punësimin e punonjësve të japë përparësi punonjësve aktualë që punojnë me pastrimin, mbledhjen dhe transportin e këtyre mbeturinave.
- 13.11 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjitha mjetet dhe paisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë së tij ashtu siç përcaktohet dhe nenin 35 “Specifikimet Teknike”.

- 13.12 Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtuesin Teknik. Drejtuesi Teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik i Punimeve të objektit është: **Alaudin Behluli**.
- 13.13 Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:
- Zbatimin e shërbimit të pastrimit konform kontratës;
  - Dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet;
  - Ecurinë e shërbimit të pastrimit konform plan - organizimit dhe grafikut të shërbimit;
- 13.14 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor.
- 13.15 Drejtuesi teknik në këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin Teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlereson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues Teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Autoritetin Kontraktor.

#### **Neni 14 Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale**

- 14.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 14.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.
- 14.3 Kontraktuesi duhet të sigurohet pranë një shoqërie sigurimi me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës deri në datën e përfundimit të plotë të shërbimit të pastrimit. Sigurimi do të kryhet për humbje ose dëmtim të pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të pronave dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 14.4 Rregulloret për çertifikatat e siguracionit do të dorëzohen Supervizorëve për aprovim brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës. I gjithë ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse Kontraktuesi dështon të sigurojë certifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosi të zgjasë periudhën e paraqitjes të çertifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresë koston e tij nga pagesa që i jep Kontraktuesit.
- 14.5 Ndryshime në afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor.

#### **Neni 15 Mbeturina të rrezikshme**

- 15.1 Përfaqësuesit e Kontraktuesit (të punësuarit e tij), kur konstatojnë praninë e çdo mbeturine të papranueshme brenda dhe jashtë kontenierit duhet të lajmërojnë Autoritetin Kontraktor, Bashkinë e Tiranës për këto mbeturina toksike, infektive



ose të rrezikshme në mënyrë që bashkërisht të marrin masa për largimin e tyre. Në këto raste të dyja palët kallëzojnë pranë organeve kompetente për ndjekjen ligjore të shkaktarit.

#### **Neni 16            Kontakti me publikun**

16.1 Kontraktuesi duhet të ketë një zyrë brenda juridiksionit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës me qëllim që të komunikojë me Bashkinë dhe publikun në përputhje me “Specifikimet Teknike” pjesë përbërëse e kësaj kontratë. Kontraktuesi është i detyruar të vendos një numer telefoni për publikun i cili duhet të komunikohet Autoritetit kontraktor brenda 1 muaji nga lidhja e kontrates.

#### **Neni 17            Edukimi Publik Ambiental**

17.1 Kontraktuesi duhet të zhvillojë një program të edukimit publik të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Tiranës për të rritur në maksimum pjesëmarrjen në programin e menaxhimit të mbeturinave duke vënë një theks të veçantë në grumbullimin e tyre në kontenierë, fshirjen e rrugëve, transporti i mbeturinave voluminoze, rrugët tregtare dhe respektimin e orareve përkatëse. Ky program edukimi do të kryhet nga Kontraktuesi në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Tiranës duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit masiv.

17.2 Kontraktuesi do të kryejë një herë në 6 muaj programin e Edukimit Ambiental sipas idesë dhe përcaktimeve që do të jepen nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës.

17.3 Autoriteti Kontraktor do t’i njoftojë kohën dhe afatin në të cilin do të prodhohet dhe transmetohet spoti ose materiali informativ i shkruar broshura ose fletëpalosje.

17.4 Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës do të njoftojë me shkrim mbi detajet e idesë për prodhimin dhe shpërndarjen e spoteve, broshurave ose fletëpalosjeve mbi edukimin ambiental.

17.5 Kostoja për prodhimin dhe promovimin e programit të edukimit publik do të mbulohet nga kontraktori.

#### **Neni 18            Taksat**

18.1 Kontraktuesi është i detyruar të paguaj të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

#### **Neni 19            Kontenierët, mjediset dhe paisjet**

19.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës i përcakton Kontraktuesit pikat e vendgrumbullimit të mbeturinave dhe numrin e kontenierëve për çdo pikë në zonën e kontraktuar në përputhje me zërat e punës së përcaktuara në preventiv, me specifikimet teknike, listës së rrugëve dhe hartës të zonës, të miratuara, pjesë përbërëse të kësaj kontrate. Kontenieret janë pronë e Kontraktuesit.

19.2 Kontraktuesi do të vendosë kontenierët në vendgrumbullimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, shoqëruar me proces-verbaleve të

mbajtur nga përfaqësuesit e secilës palë. Proces-verbalet do të përmbajnë numrin e kontenierëve dhe pikat e vendgrumbullimit ku do të vendosen kontenierët.

- 19.3 Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve, kur këta të fundit dëmtohen për çdo rast dhe për çdo shkak. Kontraktuesi merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit.
- 19.4 Kontraktuesi ka përgjegjësi për larjen dhe dizinfektimin e kontenierëve në përputhje me Specifikimet Teknike pjesë përbërëse të kësaj kontrate.
- 19.5 Kontraktuesi do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti Kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rastin e humbjes ose vjedhjes së kontenierëve, Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zëvendësimin fizik të kontenierëve.
- 19.6 Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës i përcakton kontraktuesit vendin e depozitimit të mbeturinave të ngurta urbane dhe voluminoze.

## **Neni 20 Detyrime të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës.**

- 20.1 Autoriteti Kontraktor sensibilizon në mënyrë të herë pas herëshme banorët nëpërmjet lajmërimeve zyrtare ose mediave të shkruara dhe elektronike për mbajtjen pastër të ambjentit.
- 20.2 Autoriteti Kontraktor përgjigjet për mirëmbajtjen e rrugës që çon në vendin e hedhjes së mbeturinave dhe sistemimin e tyre në fushën e depozitimit. Depozitimi i mbeturinave do të kryhet gjatë gjithë ditëve të javës. Autoriteti Kontraktor merr përsipër sistemimin e ambjeneteve ku do të vendosen kontenjerët për të mundësuar kryerjen e shërbimit.
- 20.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë është e detyruar të kryej pagesën për punën e kryer nga ana e Kontraktuesit në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

## **Neni 21 Mbikqyrja gjatë kryerjes së shërbimit**

- 21.1 Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor në prani të përfaqësuesëve të autorizuar të Kontraktuesit, kryejnë kontroll ditor të shërbimit sipas grafikëve të miratuar, nga Bashkia e Tiranës.
- 21.2 Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor mbajnë proces – verbale dhe situacione ditore për masën e kryerjes së shërbimit, aplikojnë ndalesa, gjoba dhe llogarisin masën e ndalesave për punë të pakryer sipas dispozitave të kësaj kontrate.
- 21.3 Situacionet ditore vendosen në sasi sipas çdo zëri pune të shprehur në lekë në përputhje me procesverbalet ditore dhe preventivin e kësaj kontrate.
- 21.4 Kontrolli i punimeve do të kryhet në vendin dhe kohën e përcaktuar nga të dyja palët në grafik. Situacionet që nuk pranohen të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit marrin vlerë dhe pa nënshkrimin e tij në këto raste:
  - a. Kur përfaqësuesi i Kontraktuesit nuk është prezent në kontrollin e punës sipas grafikut.
  - b. Në rastet e kontrollit të përbashkët, kur konstatimet e Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor nuk kontestohen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit me anë të provave konkrete si fotografi, video me datën dhe orën e kryerjes së

fotografimit ose filmimit. Në rastin e paraqitjes së provave të mësipërme dhe të mospranimit të tyre nga ana e Supervisorit atëherë Kontraktuesi mund ti drejtohet me ankesë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë.

- 21.5 Situacionet mujore do të hartohen në bazë të proces-verbaleve dhe situacioneve ditore të nëshkruara nga të dyja palët.

## **Neni 22 Likujdimet**

- 22.1 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për pagesën në afat të punimeve të kryera. Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit mujor të paraqitur nga Kontraktuesi me vlerë sipas volumeve të kryera, duke u zbritur masa e volumeve të shërbimit të pakryer si dhe penalitetet e mbajtura për punë të pakryer. Në situacion duhet të përfshihet vlera e T.V.SH.
- 22.2 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për diferencën e kostos së transportit të mbeturinave, në rast ndryshimi të vendit të depozitimit të mbeturinave të ngurta.
- 22.3 Pagesa do të kryhet pranë Bankës Kombetare Tregtare, në numrin e llogarisë së Kontraktuesit Nr. 421328773, IBAN AL6820511210328773CLPRCLALLB. Në rast ndryshimi të llogarisë nga ana e Kontraktuesit ky i fundit është i detyruar të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë.

## **Neni 23 Afatet e Pagesës**

- 23.1 Kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit kontraktues me shkrim. Kërkesa duhet të shoqërohet me Situacionin mujor të shërbimit të kryer e të miratuar, së bashku me faturën e TVSH-së.
- 23.2 Pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarikë nga dita që është marrë kërkesa për pagesë nga ana e Kontraktuesit.
- 23.3 Dita e pageses do të jetë dita që fondet debitojnë nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 24 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

- 24.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë përtej afateve të parashikuara në nenin 23, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 24.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

## **Neni 25 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

- 25.1 Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

- 25.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të shperblim per dëmet e shkaktuara per shkak te vonesës në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 25.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 25.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 25.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

#### **Neni 26      Ndryshimi i porosisë**

- 26.1 Autoriteti kontraktor rezervon te drejtën e porosisë shtesë deri në një sasi që nuk kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregulla dhe mënyra të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.
- 26.2 Nevoja për volume shtesë përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor (Bashkia Tiranë) e cila identifikon volumet shtesë të cilat nevojiten të kryhen në vazhdim të kontratës.

#### **Neni 27      Ndalesat, Penalitete dhe Gjobat**

- 27.1 Kontraktuesi do ta zhdëmtojë Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Tiranës për çdo dëmtim të shkaktuar për shkak të tij.
- 27.2 Kontraktuesi i nënshtrohet ndalesave dhe penaliteteve për punë të pakryer si më poshtë:
- a. Në rastet kur identifikohen zëra të punës së pakryer të parashikuar nga preventivi i kontratës nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, atëhere përveç ndalesës për punë të pakryer, Kontraktuesi do të penalizohet me 5 – fishin e vlerës së zërit përkatës.
  - b. Në rastet kur Kontraktuesi nuk kryen me cilësinë e kërkuar nga specifikimet teknike të kontratës shërbimin e proceseve të parashikuara për ndonjë zë pune, përveç ndalesës së pagesës për zërin e punës, Kontraktuesi do të penalizohet me 2-fishin e vlerës së zërit përkatës.
  - c. Në rast të mos riparimit të plotë të kontenierëve apo zëvendësimin e tyre (në mënyrë që te plotësojë kushtet teknike, estetike dhe higjenosanitare), brenda afatit të përcaktuar më sipër nga Kontraktuesi, këtij të fundit do ti vendoset penalitet në masën 50.000 lekë për çdo kontenier , vlerë e cila do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.

- d. Kontraktuesi është i detyruar të pajisë punonjësit e tij me uniforma në të cilat të jenë vendosur qartë shenjat dalluese të shoqërisë Kontraktuese. Në rast të mos respektimit të detyrimit të mësipërm Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë i aplikojnë Kontraktuesit gjobë në masën nga 50.000 lekë, masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likujdim.
- e. Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 17 dhe kapitullit “Specifikimet teknike” për kryerjen e Edukimit Publik Ambjental, supervizorët e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë aplikojnë gjobë në masën 500.000 (pesëqindmijë) lekë. Kontraktuesit do ti njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambjental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e Njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambjental Autoriteti Kontraktor vendos penalitetin e rradhës në masën 1.000.000 (njëmilion) lekë. Gjobat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor në situacionin e rradhës të paraqitur për likujdim nga ana e Kontraktorit.
- f. Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 10.8 Detyrimete Vecanta të Kontraktuesit Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë, aplikojnë ndalesë në vlera prej 2,000,000 (dymilion) lekë. Masë e cila do të aplikohet cdo muaj, deri ne plotësimin e detyrimit. Masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likujdim.

27.3 Penalitetet e përcaktuara në nenin 27.2 ( a,b,c ) nuk aplikohen në rast se shërbimi nuk është kryer për arsyet e përmendura në nenin 10.6 si dhe 10.8 të kësaj kontrate.

27.4 Penalitetet dhe gjobat e aplikuara më lart nuk përjashtojnë dhe masat e tjera penalizuese që mund të aplikohen nga Institucione të tjera të parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

## **Neni 28 Siguracioni i Punonjësve**

28.1 Kontraktuesi përgjigjet për punësimin dhe sigurimin e nëpunësve dhe punëtorëve, sipas legjislacionit në fuqi. Kontraktuesi duhet të ketë të siguruar një numër punonjësish jo më të vogël se numri i punonjësve të deklaruar në ofertë. Kontraktuesi duhet ti paraqesë me kërkesën e Autoritetit Kontraktor listën e të gjithë punonjësve të siguruar si dhe çdo informacion tjetër në lidhje me punonjësit e shoqërisë.

## **Neni 29 Rrethana të paparashikuara**

29.1 Rrethanat e paparashikuara për arsye të të cilave shërbimi nuk mund të kryhet nga Kontraktuesi do të konsiderohen sa vijon:

- a. Luftë e deklaruar apo jo, luftë civile, kryengritje, revolucion ose nga ndonjë ngjarje tjetër krejtësisht jashtë kontrollit të Autoriteti Kontraktor, Bashkisë Tiranë ose Kontraktuesit.
  - b. Katastrofa natyrore.
  - c. Akte vandale të vërtetuara si të tilla nga Kontraktuesi.
- 29.2 Në qoftë se gjatë zbatimit të kontratës krijohen rrethana si ato të përmendura në pikat e mësipërme të cilat pengojnë kontraktuesin të përmbushin të gjitha detyrimet kontraktuale dhe që nuk janë në kompetencat e Kontraktuesit, ai autorizohet të mbyllë kontratën ose të kërkojë një plotësim të saj, në të cilat do të merren parasysh dhe rastet e sipërpërmendura.

### **Neni 30 Përfaqësimi i Autoritetit Kontraktor**

- 30.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë garanton se i ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm paraprake për nënshkrimin dhe lidhjen e kësaj kontrate duke iu përgjigjur detyrimeve Ligjore.

### **Neni 31 Komunikimi**

- 31.1 Mënyra e komunikimit midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë dhe Kontraktuesit do të jetë me shkrim. Të gjitha njoftimet të cilat palët do ti drejtojnë njëri tjetrit duhet të hartohen me shkrim dhe të dorëzohen personalisht, me postë zyrtare ose postë elektronike duke iu adresuar palëve në mënyrën e mëposhtme:
- a. Për përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës adresa e plotë e Institucionit ose adresa e postës elektronike,
  - b. Për përfaqësuesin e kontraktuesit, adresa e plotë e kontraktuesit ose adresa e postës elektronike të cilat palët në çdo kohë ia komunikojnë njëri tjetrit me shkrim
- 31.2 Njoftimet do të kenë efekte me marrjen në dorezim nga palet.

### **Neni 32 Përfaqësimi i Palëve**

- 32.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 32.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 32.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

### **Neni 33 Negociatat dhe Amendamentet**

- 33.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 33.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 33.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

### **Neni 34 Transferimi i të Drejtave**

- 34.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

### **Neni 35 Specifikimet teknike**

#### **35.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane dhe Tregjeve.**

##### **35.1.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e **950** kontenierëve të ndara në **479** PGM (pika të grumbullimit të mbetjeve) me volum 1.7 m<sup>3</sup>, brenda zonës së kontraktuar.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, 796 zbrazje kontenierësh/ditë, për zonën urbane

110 zbrazje 3 here/javë(156 ditë në vit) për zonën rurale (Vaqarr, Ndroq, Pezë).

44 zbrazje 2 here/javë(104 ditë në vit) për zonën rurale (Baldushk).

Në momentin që Autoriteti Kontraktor do të aktivizojë procesin e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në zonën “Tirana 3”, 126 kontenierë do të do të bëhen pjese e këtij procesi.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën **Tirana 3** dhe sipas hartës së zonës.

Te gjithë kontenieret si dhe mirëmbajtja e tyre do të ofrohen nga Operatori i Shërbimit. Operatori i shërbimit duhet të disponojë 30 % te sasise se kerkuar te konteniereve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e shpalljes fitues dhe sasia e mbetur do të vendoset në zonën e pastrimit sipas pikave të grumbullimit, brenda 2 (dy) muajve nga data e fillimit të shërbimit.

##### **35.1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a. Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.

b. Duhet të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri ose duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

### **35.1.2 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve**

a. Autoriteti kontratues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës së kontraktuar (338 PGM pjesa Tirana urbane, 29 PGM Nja Pezë, 22 PGM Nja Vaqarr, 43 PGM Nja Baldushk, 47 Ndroq, në total 479 PGM. (Vendosja e tyre në vendet e përcaktuara do të bëhet sipas sistemit koordinativ(x,y) ËGS 1984).

b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoritetit kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë konsiderohet e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

d. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës (për zonën urbane dhe gjysëm urbane) duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona urbane dhe gjysëm urbane të jetë krejtësisht e pastër, ndërsa për zonën rurale ky shërbim të kryhet gjatë ditës.

Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe



në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikon e Punimeve.

**e.** Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

**f.** Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të konteinerëve dhe e pikave të grumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të shpeshtohet në funksion të sasise së depozituar të mbetjeve por gjithmonë duke mos kaluar parashikimin kontraktual dhe preventivin e punimeve.

### **35.1.3 Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të pa transportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth konteinerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete.

**b.** Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambiente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së konteinerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

**c.** Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontraktor në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontraktor.

**d.** Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**e.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

**f.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**g.** Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga konteinerët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrastimin e konteinerëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që konteinerët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

**h.** N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penaltetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**i.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

#### **35.1.4 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **6 (gjashtë) copë;**
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **4 (katër) copë;**
3. Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin “Specifikimet teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

#### **4. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjëndje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së

kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori do të riparojë ose të zëvendësojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete.

- e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.
- f. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet dhe kontenierët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet te prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

## **35.2 Larja dhe dezifektimi i kontenierëve**

### **35.2.1 Volumet e punimeve**

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezifektojë 951 kontenierë të volumeve 1.7 m<sup>3</sup>/ në muaj ose mesatarisht 32 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

### **35.2.2 Metodologjia**

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezifektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezifektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezifektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

### **35.2.3 Grafikët e punimeve**

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezifektimin e kontenierëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura,

respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

#### **35.2.4 Rregulla për t'u zbatuar**

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..

#### **35.2.5 Mjetet dhe pajisjet**

1. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një)copë**.

2. Lëndë dezifektuese dhe aromatizuese për dezifektimin e kontenierëve.

3. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezifektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezifektimin e kontenierëve.

4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

### **35.3 Mirëmbajtja e vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme.**

#### **35.3.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht pikat e grumbullimit të mbetjeve, **338** vendgrumbullime mbetjesh. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën “Tirana 3 ” si dhe në hartën për këto zone.

#### **35.3.2 Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

**a.** Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonën perkatese, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (amballazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t'u depozituar nëpër kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën perkatese sado larg kontenierit të jetë hedhur.

**b.** Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme, të hedhura jashtë kontenierëve, si dhe në gjithë hapësirat publike dhe territoriale të zonës do të

përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.

**d.** Pas pastrimit kontenierët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.

**f.** Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e këtij shërbimi, përgatiten nga sipermarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën vendgrumbullim mbetjesh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

**g.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

**h.** Grafikët që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që punimet të fillojnë nga ora 10.00 deri në 18.00, me qëllim që gjithë kësaj periudhe kohore të gjithë kontenierët dhe vendet rreth tyre të jenë krejtësisht të pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

**i.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërmbushjen e tyre.

**j.** Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër pikën e grumbullimit të mbeturinave në përputhje me Rregullores me VKB Nr.1 dt.05.02.2007 "Për Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit".

**k.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kontenierë të tejmbushur me mbetje urbane, ndërtimore, të vëllimshme dhe sipërfaqe rreth tyre të papastruara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga njoftimi apo konstatimi i problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit dhe do të përballet me penalitetet e parashikuara në përputhje me me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**l.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe deklaruar të të makinerive dhe pajisjeve dhe punëtorë për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

**m.** Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë operatori i shërbimit për mbledhjen dhe largimin e

mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballet me penaltetet dhe gjopa në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**n.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

**P.** Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të pikave vendgrumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve voluminoze pagesa për këtë shërbim do të kryhet sipas numrit faktik të këtyre vendgrumbullimeve në terren. Cdo ndryshim do të reflektohet në situacionet mujore të pagesave.

### **35.3.3 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane dhe mbetjeve ndërtimore, të vëllimshme si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

2. Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre ) copë**;
3. Vegla pune si lopata, fshesa për të gjithë shoferët dhe punëtorët.
4. Çdo makineri për kryerjen e këtij shërbimi duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
5. Një listë e makinave për transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së mësipërme
6. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit dhe një numër kontenierësh me volum të madh duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
7. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

## **35.4 Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.**

### **35.4.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **401,897** m<sup>2</sup> në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 3 , sipas hartës bashkëngjitur.

#### **35.4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

**a.** Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj (për rrugët e kategorisë së I ), si dhe sipërfaqen e plotë rrugë + trotuar për kategorinë e III.

**b.** Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.

**c.** Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.

**d.** Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.

**e.** Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambjentit rreth tyre bëhet gjatë natës.

**f.** Procesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotuaret e qytetit).

#### **35.4.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.

**b.** Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në

rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

**f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

#### **35.4.4 Rregulla për t'u zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.

**b.** Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për të dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**d.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

**e.** Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**f.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

**g.** Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoba për mosplotësim të tyre.



**h.** Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

### **35.4.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
2. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

## **35.5 Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike.**

### **35.5.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet. në një gjatësi lineare prej **16,736** ml në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 3 dhe sipas hartës bashkëngjitur.

### **35.5.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

**a.** Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë nga parkimi. Më pas çdo mbeturinë e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punëtorët e shërbimit të fshirjes me krahë..

**b.** Në të gjitha gjatësitë lineare dhe segmentet e lira nga parkimi, të rrugëve , të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri. Fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

### **35.5.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora **21.00-04.00**.

**b.** Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 7.00 zona të jetë krejtësisht e pastër.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund

të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktoheh saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penaltete, gjoha dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

#### **35.5.4 Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit .

**b.** Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja e rrugës me makineri teknologjike për fshirjen e rrugëve, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.

**d.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

**e.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

#### **35.5.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rrul, sistem

thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;

- b. Makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e rrugëve, mund të kontrollohen në çdo kohe nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të lahen dhe pastrohen në fillim ose në fund të intinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.
- c. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.
- d. Automjetet, pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kësaj kontrate.
- e. Një listë e makinave fshirëse do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së fshirjes.

## **35.6 Mirëmbajtja dhe pastrimi gjatë ditës i akseve kryesore rrugore.**

### **35.6.1 Volumi i punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht të gjitha trotuaret e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha trotuaret e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, për një pjesë të rrugëve në një sipërfaqe prej **44,937** m<sup>2</sup> në ditë nga ora 10.00 deri 18.00 .

Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve për zonën Tirana 3 , sipas hartës bashkëngjitur.

### **35.6.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbim i mirëmbajtjes dhe pastrimit të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, konsiston në:

Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet për mbulim si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve, mbajtjen pastër gjatë ditës të koshave rrugorë dhe vendit rreth tyre, etj

### **35.6.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

- a. Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të bëhet gjatë ditës nga ora 10.00 deri 18.00

**c.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që gjatë gjithë ditës trotuarët e përcaktuar për shërbim të jenë krejtësisht e pastër ose duke u pastruar.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit, përgatiten nga sipërmarresi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo segment rrugorë.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

#### **35.6.4 Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen trotuare të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.

**b.** Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00. Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për të dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.

**d.** Gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujës-jellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t’i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrim të tyre brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

e. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të pastrimit gjatë ditës, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

f. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoha për mosplotësim të tyre.

h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjenike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

### **35.6.5 Mjetet dhe pajisjet**

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

## **35.8 Larja e rrugëve me makinë teknologjike**

### **35.8.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës ashtu dhe për shërbimin e dytë të larjes gjatë ditës.

1. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim një herë në ditë gjatë natës, parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **129,314** m<sup>2</sup> në ditë përgjatë 305 ditëve të periudhës kontraktuale. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e larjes me makineri për zonën Tirana 3 .

2. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makineri si shërbim i dytë ditor, si larje gjatë ditës në një sipërfaqe të përgjithshme prej **129,314** m<sup>2</sup>/ditë, sipas listës së rrugëve dhe volumeve të përcaktuara për larjen dy herë në ditë, për zonën Tirana 3 përgjatë muajve më të nxehtë të vitit.( gjithsej 240 ditë)

### **35.8.3 Specifikimet teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

1. Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

2. Larjen me presion, me makineri teknologjike larëse, si shërbim i dytë ditor, të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara për këtë shërbim, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

3. Gjatë shërbimit të parë të larjes (gjatë natës) shpejtësia e operimit të makinave larëse gjatë procesit të larjes (zbrazjes së ujit) duhet të variojë nga 8-10 km/orë kurse gjatë shërbimit të dytë të larjes nga 15-20 km/orë.

#### **35.8.4 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve**

1. Larja e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.
2. Larja e rrugëve si shërbim i dytë ditor, do bëhet çdo ditë, gjatë periudhës 15 Mars – 15 Nëntor , ( gjithsej 240 ditë) nga ora 12.00 –19.00.
3. Larja me presion, me makinë teknologjike do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 07.00 dhe në orën 19.00 për shërbimin e dytë të larjes, zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e larë.
4. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
5. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
6. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
7. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

#### **35.8.5 Rregulla për tu zbatuar**

1. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.
2. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e larjes me presion të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0,8 litër ujë për 1 m<sup>2</sup> rrugë për larjen e darkës dhe 0.6 litër ujë për m<sup>2</sup> për larjen e ditës.
3. Larja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë.
4. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes me makineri për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.

5. Përfaqësuesit e Autoritetit kontraktor do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes së dytë dhe mund ti kërkojë Operatorit të Shërbimit kryerjen e këtij shërbimi në ditët e tjera të vitit ose gjatë stinës së verës kur të jetë e nevojshme, në përputhje me çmimet njësi të preventivit të punimeve dhe sipërfaqeve të rrugëve sipas listës së rrugëve bashkëngjitur kontratës, një kërkesë zyrtare të Autoritetit kontraktor, si dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.
6. Do të konsiderohet e pavlefshme larja e rrugëve në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontraktor për shkaqe të ndryshme.
7. Autoriteti kontraktor do të nxisë Operatori i shërbimitn të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për larjen e rrugëve, si puse, etj.
8. Listat përkatëse të rrugëve që do lahen i bashkëngjiten kësaj kontrate.
9. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do mbarten nga operatori i shërbimit.
10. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për larjen e rrugëve.

### **35.8.6 Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

1. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**; Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.
2. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
3. Të gjitha makinat për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
5. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

6. Një listë e makinave larëse do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së larjes.

### **35.9 “Edukimi Publik Mjedisor”**

Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatori i shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së operatori i shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Ky kontakt mund të realizohet si nëpërmjet mass-mediave ashtu edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese.

Operatori i shërbimit duhet të mundësoj shpërndarjen e materialeve informative të paktën një here në gjashtë muaj (duke filluar nga dita e firmosjes së kontratës). Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotjes, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë qytetarët e kryeqytetit të bëhen pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

Operatori i shërbimit duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik mjedisor që të parkohet në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.

Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontraktor.

Në rast të mos përmbushjes të edukimit mjedisor apo plotësimit të pjesëshëm të tij aplikohen gjyba.

Në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor, Operatori i zonës duhet të pregatisë dhe të promovojë spote publicitare që përcjellin mesazhin e Bashkisë Tirane në këto kontekste. Këto spote duhet të realizohen dhe të publikohen në disa nga TV e Kryeqytetit që do të saktësohen nga Autoriteti Kontraktor, fluksi i promovimit të tyre do të saktësohet nga Autoriteti Kontraktor ndërsa kostot e kësaj shërbimi do të jenë në ngarkim të Operatorit të shërbimit.

### **35.10. Specifikimet teknike të Kontenierëve**

**Sasia e kërkuar e kontenierëve për zonën “Tirana III” është 950 copë.**

Materiali fotografik shërben për qëllim informues dhe orientues.

**TE DHENA TEKNIKE TE KONTENIERIT 1700 LITRA:**



Kontenierët do të përdoren për grumbullimin e mbetjeve urbane dhe duhet të kenë karakteristikat si më poshtë vijojnë:

***Trupi i kontenierit (vaska):***

Trupi i kontenierit nga brenda (vaska e zinguar). Ekstra përforcim i bazës së rrotës, i ngjitur tek kontenieri. Sistem kullimi fundor për derdhjen e lëngjeve të grumbulluar nga mbetjet apo gjatë larjes së kontenierit. Kapaciteti i plote 1700 litra. Doreza anesore për terheqjen e kontenierit.

Kontenierët duhet të jenë të lyer me bojë(vaska) Portokalli,(kapaku i kuq). Spesori i profilit të vaskës 1.5-4 mm.

**Kapaku**

Metalik. Me përforcues të tërthortë për ekstra rezistencë.Profil i harkuar ose i drejtë për rrjedhje të ujrave të shiut. Sistemi i hapjes së kapakut me pedale qendrore. Ndër të tjera kapaku duhet jetë i pajisur edhe me një dorezë, në pjesën e përparme ose anesore, për raste të hapjes së kapakut në mënyrë manuale.Ngjyra e kapakut, e kuqe.

**Pedalja**

Pedalja duhet të jetë me profil metalik me spesor 4 mm për ekstra rezistencë.

***Rrotat***

Rrota rezistente me çelik të galvanizuar në qendër dhe unazë gome rezistente në pjesën e kontaktit me tokën. Diametri i rrotës 200mm dhe me rrotullim 360°. 4 rrota të kthyeshme (me kokë rrotulluese), me gomë plastike solide, me kuzhineta, kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 250kg;

**Modeli i kapjes së kazanit**

Attacco Bologna/ Din.

**Sinjalistika**

Operatori duhet të sigurojë dhe ngjisë adezivë tek kazanët, me informacion mbi mënyrën e dorëzimit të mbetjeve, ndalimet, eiketa, adëzivë për ndalim parkimi para kazanëve, shirita me ngjyre fosforeshente, logo e Bashkisë së Tiranës. (Pas miratimit të formatit nga Bashkia Tirane). Ofertuesi mund të ofrojë edhe modele të tjera por duke marrë paraprakisht miratimin e autoritetit kontraktor si dhe duke respektuar gjithnjë kohën e parashikuar për dorëzimin e kontenierëve.

**Targë e fiksuar (gozhduar) ose e stampuar**

Mbi çdo kazanë, nga prodhuesi, do të fiksohet një targë me dimension 10cm x 4cm ku do të stampohet një kod identifikimi për kazanin me 6 shifra (duke u nisur nga 000000 e deri në 002500), viti i fabrikimit të kazanit dhe kapaciteti.

**Përputhja**

Sipas normativës UNI EN 840 (UNI 10571).

**Të tjera.**

Kazani duhet të jetë në gjendje të durojë gjatë kohës, për të gjithë përbërsit, temperatura nga -20°C deri +50°C;

Kazani duhet të strukturuar në mënyrë që të garantojë një mbajtje peshe deri në 450kg, pa pësuar asnjë deformim permanent

Hapja minimale, me gjysëm pedale duhet të jetë 450mm, ndërsa në fazën e zbrazjes ose të larjes duhet të jetë minimalisht 1000mm.

### **Neni 36 Forca Madhore**

36.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

36.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

36.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

### **Neni 37 Garancia e kontratës**

37.1 Garancia e kontratës do të jetë në masën 10 % të vlerës totale të kontratës të llogaritur në bazë të preventivit total të ofruar nga shoqëria fituese dhe konkretisht në vlerën **56,851,917** (pesëdhjetë e gjashtë million e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) **lekë**.

37.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t’i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

37.3 Sigurimi i kontrates do t’i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

37.4 Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontrates.

### **Neni 38 Klauzolë shtesë**

38.1 Kushtet dhe termat e kësaj kontrate nuk mund të ndryshohen ose modifikohen përveçse me vullnetin e palëve.

### **Neni 39 Legjislacioni**

39.1 Kontrata do të qeveriset nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

#### **Neni 40 Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

40.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

#### **Neni 41 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

#### **Neni 42 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

42.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

42.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

42.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

#### **Neni 43 Ndërprerja për Mosplotësim**

43.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

43.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

#### **Neni 44 Zgjidhja e kontratës**

44.1 Në rast të shkeljeve të dispozitave të kësaj kontrate nga pala shkelëse, ajo është e detyruar ti rregullojë ato. Palës shkelëse i ngarkohen shpenzimet e rregullimit të këtyre shkeljeve.

44.2 Me konstatimin e shkeljeve të kontratës, Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës i bën njoftim me shkrim Kontraktuesit për konstatimin dhe detyrimin e Kontraktuesit për rregullimin e tyre brenda afateve të parashikuara në kontratë.

44.3 Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë po nuk kufizohen në sa vijon:

- a. Nëse Kontraktuesi nuk kryen shërbimin e pastrimit në një pjesë të zonës apo në të gjithë zonën e parashikuar në këtë kontratë, për një periudhë të pandërprerë prej 7 ditësh me përjashtim të rastit të përcaktuar në neni 10.7 të kësaj kontrate.
- b. Nëse masa e punës së pakryer dhe e penalteteve të aplikuara tejkalon 15 % të vlerës vjetore të kontratës.
- c. Nëse Kontraktuesi falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit.
- d. Nëse Kontraktuesi nuk ka në dispozicion dhe gjëndje pune, apo ndryshon gjatë kohëzgjatjes së kontratës automjetet e kërkuara sipas Specifikimeve Teknike dhe të paraqitura nga Kontraktuesi në ofertë pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë.

44.4 Nëse kontrata për shkak të shkeljeve priset atëherë Autoritetit Kontraktor Bashkisë i lindin këto të drejta:

- a. E drejta për të deklaruar kontratën të prishur duke i dhënë Kontraktuesit një njoftim me shkrim brenda një afati prej 30 ditësh, me argumentat përkatëse. Në qoftë se kontrata priset, Kontraktuesi duhet të sigurojë shërbimin e pastrimit për një periudhë prej 90 ditësh nga dita e njoftimit të prishjes së kontratës. Për këtë kohë Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë është e detyruar të kryejë pagesën e shërbimit.
- b. Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, ka të drejtën të sekuestrojë garancinë e kontratës të ngurtësuar në masën e përcaktuar në kontratë.
- c. Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës ka të drejtën që t'i kërkojë dëmshpërblim Kontraktuesit në masën e dëmit të shkaktuar.

#### **Neni 45 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

45.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

45.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjisllacionit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 46 Dokumente që i bashkëlidhen kësaj kontrate**

Pjesë Integrale e kësaj kontrate do të jenë:

1. Sigurimi i Kontratës
2. Formulari i Ofertës
3. Preventivi i shërbimeve
4. Specifikimet teknike
5. Material shpjegues Volume Larje/Fshirje/Mirëmbajtje/Kontenierë.
6. Harta treguese në zonën Tirana 3.

#### **Neni 47 Të përgjithshme**

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje të njëjta në gjuhën shqipe, prej të cilave 4 (katër) kopje i mban Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë dhe 1 (një) kopje e mban Kontraktuesi.

## **PALËT KONTRAKTUESE**

### **AUTORITETI KONTRAKTOR**

### **BASHKIA E TIRANËS**

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

**Erion VELIAJ**

**Titullar i Autoritetit Kontraktor**

### **KONTRAKTUESI**

**”ALKO –IMPEX GENERAL  
CONSTRUCTION” DSHH**

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

**ARBER ABAZI**

**Administratori**

Miratoi:

Taulant Tusha, Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike

Julian Zanaj, Drejtor i Prokurimeve

Entela Kruja, Pergj. Sekt. Prok. të Shërbimeve të Infrastrukturës

Konceptoi:

Gertila Nikolli, Specialist Sekt. Prok. të Shërbimeve të Infrastrukturës

Nr. i kopjeve: 5

Datë \_\_\_\_\_2018



**BASHKIA  
TIRANË**

NR.PROT. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_2017

## **KONTRATË SHËRBIMI**

### **“SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS TIRANA IV”**

**TIRANË**

**2017**

## KONTRATË SHËRBIMI

### “SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS TIRANA IV”

Sot me datë \_\_/\_\_/2017, nënshkruhet kjo Kontratë,

*Ndërmjet palëve:*

**BASHKISË SË TIRANËS**, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) K11729002L e përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor me adresë në Sheshi „Skënderbej“, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, që më poshtë do të quhet “**Autoriteti Kontraktor**”;

dhe

Operatorit Ekonomik “**Fusha**” **shpk**, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) J61922018S, me adresë në Njësia Bashkiake Nr. 2, Rr: “Murat Toptani”, Godina Nr. 25, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i Degës së shoqërisë në Shqipëri, **Z. Shkëlqim Fusha**, më poshtë quajtur “**Kontraktuesi**”;

#### **Neni 1 Baza Ligjore**

Të dyja palët, në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, bazuar në Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 659 e vijues, të Ligjit Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, Vkm. Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të nxjerrë në zbatim të tij, Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit “**Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV**”, si dhe ofertës të paraqitur nga Kontraktuesi për këtë procedurë të zhvilluar në datë 27.09.2017, bien dakort përsa më poshtë:

#### **Neni 2 Përkufizimet**

2.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit të procedurës për Prokurim me Objekt “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV», duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“**Çmim kontrate**” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“**Objekt i kontratës**” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“**Palë (t)**” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

**“Autoriteti Kontraktor”** do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

**“Kontraktues”** do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

**“Shërbime”** do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

**“Termet e References”** shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**“Llogaritja e Afateve”** Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

**“Mbetje”** është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

**“Mbeturina të vëllimshme dhe inerte”**: do të konsiderohen në kuptimin e kësaj kontrate mbetjet urbane voluminoze si: paisje elektroshtëpiake, karkasa makinash, mbetje bimore të drunjtave, pajisje mobiljesh, orëdit dhe të gjitha llojet e objekteve të tjera të cilat për shkak të vëllimit, formës dhe përbërjes së tyre nuk mund të hidhen dhe nuk duhet të hidhen në kontenerët me vëllim prej 1.7 m<sup>3</sup>, të parashikuar për të kryer shërbimin. Në këtë grup do të përfshihen edhe mbeturinat solide inerte si: materiale mbetjesh ndërtimore, gërmimesh dhe prishjesh, dherëra, gurë, materiale qeramike, zhavore, etj, me prejardhje nga familjet.

**“Krijues i mbetjeve”** quhen të gjitha subjektet private komerciale, shërbimi, artizanale prodhuese, institucionale, tregjet e të gjitha llojeve, shërbimet ambulante, dhe të gjithë banorët rezidentë apo ata që bëhen rezidentë gjatë kohës së kontratës brenda zonës që do të kryhet aktiviteti i Kontraktuesit me kufij sipas hartës të vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Në kategorinë e Krijues i mbetjeve përfshihen dhe zjarrfikësat, stacionet policore, Bashkia dhe Njësitë Administrative, të gjitha godinat publike dhe shtetërore si dhe të gjithë institucionet arsimore publike dhe private të qytetit, të cilat ndodhen brenda kufizimeve të zonës në të cilën do të kryhet shërbimi objekt i kësaj kontrate.

**“Edukim Publik Ambiental”** nënkupton përpjekjet për ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të konsumatorëve apo banorëve të qytetit me qëllim përpunimin, transportin, largimin ose aspekte të tjera që lidhen me mbajtjen pastër të ambjentit.

**“Zonë e kontratës”** quhet hapësira e territorit brenda kufijve të përcaktuar në hartë. Kjo hartë është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, ku Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë shërbimet e pastrimit, administrimit e mbeturinave ndaj konsumatorëve ekzistues si dhe konsumatorëve që mund të shtohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

**“Proçes – Verbal”** quhet dokumenti i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë mbi kontrollin e ushtruar në terren që reflekton punën e pakryer, gjobat



e penaltitet e vendosura në përputhje me kushtet e kësaj kontrate, cilësinë e shërbimit të pastrimit dhe problemet e konstatuara gjatë kontrollit.

**“Preventivi”** quhen vëllimet e punës të plotësuara me çmime, pjesë përbërëse e kontratës.

**”Situacioni”** quhet dokumenti i evidentimit faktik të situatës së punës së kryer në përputhje me zërat e punimeve të përcaktuar në kontratë (volumeve), në përputhje me precesverbalet ditore, i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës. Situacionet janë ditore, mujore dhe vjetore.

**“Vlera totale e kontratës”** quhet shumatorja e viteve kontraktuale në përputhje me preventivat e punimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate duke përfshirë dhe rishikimin e çmimit në përputhje me inflacionin e deklaruar.

**“Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor”**, quhen personat kompetent të emëruar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë të cilët janë përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të shërbimit të pastrimit dhe administrimit të kontratës.

**“Drejtori Teknik i Shërbimeve të Pastrimit”** është personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës, përfaqësues i Kontraktuesit, përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të pastrimit.

**“Vend Grumbullimi i Mbeturinave (VGM)”** është hapësira në të cilën do të kryhet shërbimi i heqjes së mbeturinave nga kontenierët dhe zona përreth kontenierëve siç është përcaktuar në hartë dhe në specifikimet teknike bashkëngjitur këtyre dokumentave të tenderit.

### **Neni 3           Objekti i Kontratës**

3.1     Objekti i kësaj kontrate është **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV”**.

### **Neni 4           Afati i Kontratës**

4.1     Afati i kryerjes së shërbimit është **365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike x 3 (tre) vite nga data e lidhjes së kontratës**. Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe fillon efektet e saj në datë 28.12.2017, ora 00.<sup>01</sup> kohë në të cilën kontraktuesi fillon pune menjëherë.

4.2     **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e rishikimit të volumeve të punimeve, objekt i kontratës në rast të ndryshimit të politikave të institucionit (Autoriteti Kontraktor) lidhur me ofrimin e shërbimit të pastrimit.**

### **Neni 5           Vlera Totale dhe Vjetore e Kontratës**

5.1 Vlera totale e kontratës në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës është **838,800,920.52 (tetëqind e tridhjetë e tetë milion e tetëqind mijë e nëntëqind e njëzetë pikë pesëdhjetë e dy) lekë me TVSH**

5.2 Vlera vjetore e kontratës në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës është 279,600,306.84 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind mijë e treqind e gjashtë pikë tetëdhjetë e katër) **lekë me TVSH në vit.**

## Neni 6 Preventivi i Punimeve.

6.1 Vlerësimi i zërave të punës do të kryhet në bazë të preventivit të ofertës të paraqitur në tender nga Kontraktuesi **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV”** për volumet e përcaktuara si më poshtë:

EMERTIMI I SHERBIMEVE	NJESIA	VOLUMET PUNIMEVE	VOLUMENE DITE	ÇMIMI NJESI	VLERA (DITE)	DITE PUNE /VIT	VLERA (VJETORE)
GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE (KONTENIER 1.7 M3) 7/JAVE	KONTENIER /DITE	1,373	1,373	212.00	291,076	365	106,242,740
LARJA DHE DEZIFEKTIMI I KONTENIEREVE	COPE / 30 DITE	1,373	46	356.000	16,376	365	5,977,240
MIREMBAJTJA E VEND GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE GJATE DITES DHE GRUMBULLIMI I MBETJEVE NDERTIMORE DHE TE VELLIMSHME	PIKA /DITE	548	548	92.00	50,416	365	18,401,840
FSHIRJA E RRUGEVE DHE TROTUAREVE ME PUNETORE	M2/DITE	774,222	774,222	0.22	170,329	365	62,170,027
FSHIRJA E RRUGEVE ME MAKINERI	M <sup>L</sup> /DITË	31,984	31,984	0.82	26,227	365	9,572,811
MIREMBAJTJE RRUGESH KRYESORE	M2/DITE	61,546	61,546	0.40	24,618	365	8,985,716
LARJA E RRUGEVE NJE HERE NE DITE (PARASHIKUAR PER 10 MUAJ TE VITIT)	M2/DITË	168,337	168,337	0.30	50,501	305	15,402,836
LARJA E DYTE E RRUGEVE (PARASHIKUAR PER 8 MUAJ TE VITIT OSE 240 DITE)	M2/DITE	92,962	92,962	0.28	26,029	240	6,247,046
SHUMA VITI I							233,000,255.70
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%							46,600,051.14

VLERA PERFUNDIMTARE	279,600,306.84
SHUMA VITI 2	233,000,255.70
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%	46,600,051.14
VLERA PERFUNDIMTARE	279,600,306.84
SHUMA VITI 3	233,000,255.70
TATIM MBI VLEREN E SHTUAR 20%	46,600,051.14
VLERA PERFUNDIMTARE	279,600,306.84
SHUMA VITI 1+2+3_PA TVSH	699,000,767.10
SHUMA VITI 1+2+3_ME TVSH	838,800,920.52

6.2 Preventivi i punimeve do të përdoret për llogaritjen e situacioneve që do të paraqiten për likuidim.

## **Neni 7 Praktikant Korruprive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli Procesverbaleve**

- 7.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruprive. Veprimet korruprive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 7.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 7.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 7.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 8 Informacioni Konfidencial**

- 8.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 8.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës.

#### **Neni 9 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 9.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 9.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurt
- 9.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 9.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 10 Detyrimet e Vecanta të Kontraktuesit**

- 10.1 Kontraktuesi bie dakord të kryejë shërbimin e pastrimit të zonës së përcaktuar, objekt i kësaj kontrate, bazuar në zërat e punës të përcaktuar në Preventiv si dhe në përputhje me "Specifikime teknike", grafikun e miratuar si dhe metodologjinë e punës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.
- 10.2 Kontraktuesi është i detyruar që brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve të paraqesë të gjitha mjetet, makineritë dhe pajisjet e paraqitura në ofertë sipas specifikimeve të përcaktuara në kapitullin "Specifikimet Teknike".
- 10.3 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë stafin dhe punonjësit e paraqitur në ofertë në gatishmëri për punë në datën e përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve.
- 10.4 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë të gjithë punonjësit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.
- 10.5 Përfaqësuesit e Kontraktuesit të cilët marrin pjesë gjatë kontrollit të përditshëm, duhet të jenë të autorizuar zyrtarisht nga Drejtori teknik i shërbimeve të pastrimit ose administratori i shoqërisë.
- 10.6 Kontraktuesi do të ndërpresë zbatimin e punimeve të shërbimit të pastrimit, për një afat kohor të caktuar, në ato raste kur për shkaqe teknike (punime për rikonstruksionin e rrugëve) kryerja e shërbimit ose e një pjese të shërbimit është e pamundur. Ndërprerja e shërbimit ose modifikimi i tij, për këtë rast do të kryhet vetëm pas njoftimit zyrtar dhe miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës.

- 10.7 Drejtori Teknik i Shërbimeve të Pastrimit është personi përgjegjës i cili nënshkruan të gjitha procesverbalet ditore të mbajtura nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës.
- 10.8 Kontraktuesi është i detyruar që të ketë në cdo kohë në gatishmëri, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga kontrata në përputhje me specifikimet teknike dhe ofertën e paraqitur në tender. Në rast se përdorimi i një pjese të mjeteve dhe pajisjeve është i pamundur për shkaqe teknike për zona ose pika të caktuara, Kontraktuesi mund të ndryshojë një pjesë të mjeteve dhe paisjeve vetëm pas verifikimit dhe miratimit nga Bashkia e Tiranës të pengesave teknike.
- 10.9 Kontraktuesi është i detyruar të realizojë shërbimin e marrë përsipër në përputhje të plotë me dokumentat e tenderit, metodologjise se punes si edhe specifikimeve teknike dhe grafikun e punimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

### **Neni 11 Lejet dhe Liçensat**

- 11.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

### **Neni 12 Raportet**

- 12.1 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore në të cilat duhet të parashikojë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe paisjeve të cilat përdoren për proceset e punës sipas preventivit në përputhje me Specifikimet teknike. Në raporte duhet të paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjitha rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë si dhe një përmbledhje të të gjitha situacioneve të cilat ja përcjell Kontraktuesit gjatë kësaj kohe.
- 12.2 Kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës 5 kopje të raportit vjetor brenda 10 ditëve nga përfundimi i cdo viti kontraktual të shoqëruar me situacionin e fundit të shërbimit.
- 12.3 Kontraktuesi duhet të dorëzojë duke filluar nga data 1 e çdo muaji situacionin mujor sëbashku me faturën, mbi volumin e punimeve të kryera për muajin paraardhës, bashkangjitur së cilës do të jenë fatura e ujit dhe volumin e mbeturinave të transportuara gjatë muajit paraardhës, në vend depozitimit e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës me verifikimin e situacionit mujor kryen likujdimin e tij brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së situacionit për likujdim, mos dorezimi i ketyre dokumentave i jep te drejten Autoritetit Kontraktor për moskryerjen e likujdimit të situacionit deri në paraqitjen e tyre. Mos likujdimi i pajustificuar nga ana e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Tiranë për dy muaj rresht i jep të drejtën Kontraktuesit të pezullojë shërbimin dhe të kërkojë dëmshpërblim, për paisjet makineritë dhe treguesit e tjerë financiarë për periudhën e kontratës së mbetur pa u realizuar.

### **Neni 13 Personeli i Kontraktuesit**

- 13.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë trajtim për të gjithë të punësuarit e tij në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Shqipëri.

- 13.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.
- 13.3 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 13.4 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 13.5 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.
- 13.6 Të gjithë drejtuesit e automjeteve, të punësuar nga Kontraktuesi duhet të jenë të kualifikuar për makinat e largimit të mbeturinave, duhet të kenë patentë të vlefshme lëshuar nga Republika e Shqipërisë me kategorinë përkatëse.
- 13.7 Kontraktuesi duhet të specializojë të gjithë të punësuarit e tij, të cilët kanë të bëjnë me mbledhjen e mbeturinave të ngurta në mënyrë që të jenë në gjendje të dallojnë mbeturinat e rrezikshme të infektuara dhe të papranueshme.
- 13.8 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjithë punonjësit me uniforma dhe me shenja dalluese të kompanisë.
- 13.9 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndaluar punonjësit e tij të marrin, të nxisin, ose të kërkojnë pagim shtesë nga klientët, ose persona të tjerë publik për largimin e mbeturinave të ngurta.
- 13.10 Kontraktuesi është i detyruar në punësimin e punonjësve të japë përparësi punonjësve aktualë që punojnë me pastrimin, mbledhjen dhe transportin e këtyre mbeturinave.
- 13.11 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjitha mjetet dhe paisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë së tij ashtu siç përcaktohet dhe nenin 35 “Specifikimet Teknike”.
- 13.12 Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtuesin Teknik. Drejtuesi Teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik i Punimeve të objektit është: **Avni Sinakoli**.
- 13.13 Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:
  - Zbatimin e shërbimit të pastrimit konform kontratës;
  - Dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet;
  - Ecurinë e shërbimit të pastrimit konform plan - organizimit dhe grafikut të shërbimit;
- 13.14 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor.
- 13.15 Drejtuesi teknik në këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin Teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlereson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues Teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Autoritetin Kontraktor.

#### **Neni 14 Siguracioni i Përgjegjësive Profesionale**

- 14.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 14.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.
- 14.3 Kontraktuesi duhet të sigurohet pranë një shoqërie sigurimi me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës deri në datën e përfundimit të plotë të shërbimit të pastrimit. Sigurimi do të kryhet për humbje ose dëmtim të pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të pronave dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 14.4 Rregulloret për çertifikatat e siguracionit do të dorëzohen Supervizorëve për aprovim brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës. I gjithë ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse Kontraktuesi dështon të sigurojë çertifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosi të zgjasë periudhën e paraqitjes të çertifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresë koston e tij nga pagesa që i jep Kontraktuesit.
- 14.5 Ndryshime në afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor.

#### **Neni 15 Mbeturina të rrezikshme**

- 15.1 Përfaqësuesit e Kontraktuesit (të punësuarit e tij), kur konstatojnë praninë e çdo mbeturine të papranueshme brenda dhe jashtë kontenierit duhet të lajmërojnë Autoritetin Kontraktor, Bashkinë e Tiranës për këto mbeturina toksike, infektive ose të rrezikshme në mënyrë që bashkërisht të marrin masa për largimin e tyre. Në këto raste të dyja palët kallëzojnë pranë organeve kompetente për ndjekjen ligjore të shkaktarit.

#### **Neni 16 Kontakti me publikun**

- 16.1 Kontraktuesi duhet të ketë një zyrë brenda juridiksionit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës me qëllim që të komunikojë me Bashkinë dhe publikun në përputhje me “Specifikimet Teknike” pjesë përbërëse e kësaj kontratë. Kontraktuesi është i detyruar të vendosë një numer telefoni për publikun i cili duhet të komunikohet Autoritetit kontraktor brenda 1 muaji nga lidhja e kontratës.

#### **Neni 17 Edukimi Publik Ambiental**

- 17.1 Kontraktuesi duhet të zhvillojë një program të edukimit publik të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Tiranës për të rritur në maksimum pjesëmarrjen në programin e menaxhimit të mbeturinave duke vënë një theks të veçantë në grumbullimin e tyre në kontenierë, fshirjen e

rrugëve, transporti i mbeturinave voluminoze, rrugët tregtare dhe respektimin e orareve përkatëse. Ky program edukimi do të kryhet nga Kontraktuesi në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Tiranës duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit masiv.

- 17.2 Kontraktuesi do të kryejë një herë në 6 muaj programin e Edukimit Ambjental sipas idesë dhe përcaktimeve që do të jepen nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës.
- 17.3 Autoriteti Kontraktor do t'i njoftojë kohën dhe afatin në të cilin do të prodhohet dhe transmetohet spoti ose materiali informativ i shkruar broshura ose fletëpalosje.
- 17.4 Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës do të njoftojë me shkrim mbi detajet e idesë për prodhimin dhe shpërndarjen e spoteve, broshurave ose fletëpalosjeve mbi edukimin ambjental.
- 17.5 Kostoja për prodhimin dhe promovimin e programit të edukimit publik do të mbulohet nga kontraktori.

#### **Neni 18 Taksat**

- 18.1 Kontraktuesi është i detyruar të paguaj të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

#### **Neni 19 Kontenierët, mjediset dhe paisjet**

- 19.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës i përcakton Kontraktuesit pikat e vendgrumbullimit të mbeturinave dhe numrin e kontenierëve për çdo pikë në zonën e kontraktuar në përputhje me zërat e punës së përcaktuara në preventiv, me specifikimet teknike, listës së rrugëve dhe hartës të zonës, të miratuara, pjesë përbërëse të kësaj kontrate. Kontenieret janë pronë e Kontraktuesit.
- 19.2 Kontraktuesi do të vendosë kontenierët në vendgrumbullimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, shoqëruar me proces-verbaleve të mbajtur nga përfaqësuesit e secilës palë. Proces-verbale do të përmbajnë numrin e kontenierëve dhe pikat e vendgrumbullimit ku do të vendosen kontenierët.
- 19.3 Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve, kur këta të fundit dëmtohen për çdo rast dhe për çdo shkak. Kontraktuesi merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit.
- 19.4 Kontraktuesi ka përgjegjësi për larjen dhe dizinfektimin e kontenierëve në përputhje me Specifikimet Teknike pjesë përbërëse të kësaj kontrate.
- 19.5 Kontraktuesi do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti Kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rastin e humbjes ose vjedhjes së kontenierëve, Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zëvendësimin fizik të kontenierëve.
- 19.6 Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës i përcakton kontraktuesit vendin e depozitimit të mbeturinave të ngurta urbane dhe voluminoze.

#### **Neni 20 Detyrime të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë së Tiranës.**



- 20.1 Autoriteti Kontraktor sensibilizon në mënyrë të herë pas herëshme banorët nëpërmjet lajmërimeve zyrtare ose mediave të shkruara dhe elektronike për mbajtjen pastër të ambjentit.
- 20.2 Autoriteti Kontraktor përgjigjet për mirëmbajtjen e rrugës që çon në vendin e hedhjes së mbeturinave dhe sistemimin e tyre në fushën e depozitimit. Depozitimi i mbeturinave do të kryhet gjatë gjithë ditëve të javës. Autoriteti Kontraktor merr përsipër sistemimin e ambjeneteve ku do të vendosen kontenjerët për të mundësuar kryerjen e shërbimit.
- 20.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë është e detyruar të kryej pagesën për punën e kryer nga ana e Kontraktuesit në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

## **Neni 21 Mbikqyrja gjatë kryerjes së shërbimit**

- 21.1 Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor në prani të përfaqësuesëve të autorizuar të Kontraktuesit, kryejnë kontroll ditor të shërbimit sipas grafikëve të miratuar, nga Bashkia e Tiranës.
- 21.2 Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor mbajnë proces – verbale dhe situacione ditore për masën e kryerjes së shërbimit, aplikojnë ndalesa, gjoba dhe llogarisin masën e ndalesave për punë të pakryer sipas dispozitave të kësaj kontrate.
- 21.3 Situacionet ditore vendosen në sasi sipas çdo zëri pune të shprehur në lekë në përputhje me procesverbalet ditore dhe preventivin e kësaj kontrate.
- 21.4 Kontrolli i punimeve do të kryhet në vendin dhe kohën e përcaktuar nga të dyja palët në grafik. Situacionet që nuk pranohen të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit marrin vlerë dhe pa nënshkrimin e tij në këto raste:
  - a. Kur përfaqësuesi i Kontraktuesit nuk është prezent në kontrollin e punës sipas grafikut.
  - b. Në rastet e kontrollit të përbashkët, kur konstatimet e Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor nuk kontestohen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit me anë të provave konkrete si fotografi, video me datën dhe orën e kryerjes së fotografimit ose filmimit. Në rastin e paraqitjes së provave të mësipërme dhe të mospranimit të tyre nga ana e Supervizorit atëherë Kontraktuesi mund ti drejtohet me ankesë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë.
- 21.5 Situacionet mujore do të hartohen në bazë të proces-verbaleve dhe situacioneve ditore të nëshkruara nga të dyja palët.

## **Neni 22 Likujdimet**

- 22.1 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për pagesën në afat të punimeve të kryera. Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit mujor të paraqitur nga Kontraktuesi me vlerë sipas volumeve të kryera, duke u zbritur masa e volumeve të shërbimit të pakryer si dhe penalitetet e mbajtura për punë të pakryer. Në situacion duhet të përfshihet vlera e T.V.SH.
- 22.2 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për diferencën e kostos së transportit të mbeturinave, në rast ndryshimi të vendit të depozitimit të mbeturinave të ngurta.

- 22.3 Paga do të kryhet pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në numrin e llogarisë së Kontraktuesit Nr. 401004455, IBAN AL3720511564004455CLPRCLALLA. Në rast ndryshimi të llogarisë nga ana e Kontraktuesit ky i fundit është i detyruar të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë.

### **Neni 23 Afatet e Pagesës**

- 23.1 Kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit kontraktues me shkrim. Kërkesa duhet të shoqërohet me Situacionin mujor të shërbimit të kryer e të miratuar, së bashku me faturën e TVSH-së.
- 23.2 Paga për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarikë nga dita që është marrë kërkesa për pagesë nga ana e Kontraktuesit.
- 23.3 Dita e pagesës do të jetë dita që fondet debitojnë nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 24 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

- 24.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë përtej afateve të parashikuara në nenin 23, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 24.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

### **Neni 25 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

- 25.1 Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 25.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të shperblim për dëmet e shkaktuara për shkak të vonesës në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 25.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japë kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 25.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 25.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

## **Neni 26 Ndryshimi i porosisë**

- 26.1 Autoriteti kontraktor rezervon te drejtën e porosisë shtesë deri në një sasi që nuk kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregulla dhe mënyra të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.
- 26.2 Nevoja për volume shtesë përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor (Bashkia Tiranë) e cila identifikon volumet shtesë të cilat nevojiten të kryhen në vazhdim të kontratës.

## **Neni 27 Ndalesat, Penalitete dhe Gjobat**

- 27.1 Kontraktuesi do ta zhdëmtojë Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Tiranës për çdo dëmtrim të shkaktuar për shkak të tij.
- 27.2 Kontraktuesi i nënshtrohet ndalesave dhe penalteteve për punë të pakryer si më poshtë:
- a. Në rastet kur identifikohen zëra të punës së pakryer të parashikuar nga preventivi i kontratës nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, atëherë përveç ndalesës për punë të pakryer, Kontraktuesi do të penalizohet me 5 – fishin e vlerës së zërit përkatës.
  - b. Në rastet kur Kontraktuesi nuk kryen me cilësinë e kërkuar nga specifikimet teknike të kontratës shërbimin e proceseve të parashikuara për ndonjë zë pune, përveç ndalesës së pagesës për zërin e punës, Kontraktuesi do të penalizohet me 2-fishin e vlerës së zërit përkatës.
  - c. Në rast të mos riparimit të plotë të kontenierëve apo zëvendësimin e tyre (në mënyrë që te plotësojë kushtet teknike, estetike dhe higjienosanitare), brenda afatit të përcaktuar më sipër nga Kontraktuesi, këtij të fundit do ti vendoset penaltet në masën 50.000 lekë për çdo kontenier , vlerë e cila do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.
  - d. Kontraktuesi është i detyruar të pajisë punonjësit e tij me uniforma në të cilat të jenë vendosur qartë shenjat dalluese të shoqërisë Kontraktuese. Në rast të mos respektimit të detyrimit të mësipërm Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë i aplikojnë Kontraktuesit gjobë në masën nga 50.000 lekë, masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.
  - e. Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 17 dhe kapitullit “Specifikimet teknike” për kryerjen e Edukimit Publik Ambjental, supervisorët e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë aplikojnë gjobë në masën 500.000 (pesëqindmijë) lekë. Kontraktuesit do ti njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambjental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e Njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambjental Autoriteti Kontraktor vendos penaltetin e rradhës në masën 1.000.000 (njëmilion) lekë. Gjobat do të mbahen naga Autoriteti Kontraktor në situacionin e rradhës të paraqitur për likuidim nga ana e Kontraktorit.
  - f. Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 10.8 Detyrimete Vecanta të Kontraktuesit Përfaqësuesit e

Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë, aplikojnë ndalesë në vlera prej 2,000,000 (dymilion) lekë. Masë e cila do të aplikohet cdo muaj, deri ne plotësimin e detyrimit. Masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.

- 27.3 Penalitetet e përcaktuara në nenin 27.2 ( a,b,c ) nuk aplikohen në rast se shërbimi nuk është kryer për arsyet e përmendura në nenin 10.6 si dhe 10.8 të kësaj kontrate.
- 27.4 Penalitetet dhe gjobat e aplikuara më lart nuk përjashtojnë dhe masat e tjera penalizuese që mund të aplikohen nga Institucione të tjera të parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

### **Neni 28 Siguracioni i Punonjësve**

- 28.1 Kontraktuesi përgjigjet për punësimin dhe sigurimin e nëpunësve dhe punëtorëve, sipas legjislacionit në fuqi. Kontraktuesi duhet të ketë të siguruar një numër punonjësish jo më të vogël se numri i punonjësve të deklaruar në ofertë. Kontraktuesi duhet ti paraqesë me kërkesën e Autoritetit Kontraktor listën e të gjithë punonjësve të siguruar si dhe çdo informacion tjetër në lidhje me punonjësit e shoqërisë.

### **Neni 29 Rrethana të paparashikuara**

- 29.1 Rrethanat e paparashikuara për arsye të cilave shërbimi nuk mund të kryhet nga Kontraktuesi do të konsiderohen sa vijon:
- Luftë e deklaruar apo jo, luftë civile, kryengritje, revolucion ose nga ndonjë ngjarje tjetër krejtësisht jashtë kontrollit të Autoriteti Kontraktor, Bashkisë Tiranë ose Kontraktuesit.
  - Katastrofa natyrore.
  - Akte vandale të vërtetuara si të tilla nga Kontraktuesi.
- 29.2 Në qoftë se gjatë zbatimit të kontratës krijohen rrethana si ato të përmendura në pikat e mësipërme të cilat pengojnë kontraktuesin të përmbushin të gjitha detyrimet kontraktuale dhe që nuk janë në kompetencat e Kontraktuesit, ai autorizohet të mbyllë kontratën ose të kërkojë një plotësim të saj, në të cilat do të merren parasysh dhe rastet e sipërpërmendura.

### **Neni 30 Përfaqësimi i Autoritetit Kontraktor**

- 30.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë garanton se i ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm paraprake për nënshkrimin dhe lidhjen e kësaj kontrate duke iu përgjigjur detyrimeve Ligjore.

### **Neni 31 Komunikimi**

- 31.1 Mënyra e komunikimit midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë dhe Kontraktuesit do të jetë me shkrim. Të gjitha njoftimet të cilat palët do ti drejtojnë njëri tjetrit duhet të hartohen me shkrim dhe të dorëzohen personalisht,

me postë zyrtare ose postë elektronike duke iu adresuar palëve në mënyrën e mëposhtme:

- a. Për përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës adresa e plotë e Institucionit ose adresa e postës elektronike,
- b. Për përfaqësuesin e kontraktuesit, adresa e plotë e kontraktuesit ose adresa e postës elektronike të cilat palët në çdo kohë ia komunikojnë njëri tjetrit me shkrim

31.2 Njoftimet do të kenë efekte me marrjen në dorezim nga palet.

### **Neni 32 Përfaqësimi i Palëve**

32.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

32.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

32.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

### **Neni 33 Negociatat dhe Amendamentet**

33.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

33.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

33.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

### **Neni 34 Transferimi i të Drejtave**

34.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

### **Neni 35 Specifikimet teknike**

#### **35.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane dhe Tregjeve.**

#### **Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e **1373** kontenierëve të ndara në **548 PGM (pika të grumbullimit të mbetjeve)** me volum 1.7 m<sup>3</sup>, brenda zonës së kontraktuar.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, **1373** zbrazje kontenierësh/ditë.

Në momentin që Autoriteti Kontraktor do të aktivizojë procesin e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në zonën “Tirana 4”, 228 e kontenierë do të do të bëhen pjesë e këtij procesi. Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën **Tirana 4** dhe sipas hartës së zonës.

Te gjithë kontenieret si dhe mirëmbajtja e tyre do të ofrohen nga Operatori i Shërbimit. Operatori i shërbimit duhet të disponojë 30 % të sasise se kerkuar te konteniereve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e shpalljes fitues dhe sasia e mbetur do të vendoset në zonën e pastrimit sipas pikave të grumbullimit, brenda 2 (dy) muajve nga data e fillimit të shërbimit.

### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a. Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.

b. Duhet të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri ose duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

### **Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve**

a. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës (548 PGM pjesa Tirana 4. (Vendosja e tyre në vendet e përcaktuara do të bëhet sipas sistemit koordinativ(x,y) EGS 1984).

b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontrates me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë konsiderohet e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenerësh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

d. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës (për zonën urbane dhe gjysëm urbane) duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona urbane dhe gjysëm urbane të jetë krejtësisht e pastër, ndërsa për zonën rurale ky shërbim të kryhet gjatë ditës.

Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

e. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërbushjen e tyre.

f. Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të kontenerëve dhe e pikave të grumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të shpeshtohet në funksion të sasise së depozituar të mbetjeve por gjithmonë duke mos kaluar parashikimin kontraktual dhe preventivin e punimeve.

### **Rregulla për t'u zbatuar**

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të pa transportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete.

b. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontraktor në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë

numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontraktor.

**d.** Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**e.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

**f.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**g.** Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

**h.** N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoha të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**i.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoha për mosplotësim këtij detyrimi.

## **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **11 (njëmbëdhjetë) copë;**
2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **2 (dy) copë;**



3. Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin “Specifikimet teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

#### **4. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezifektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.

d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori do të riparojë ose të zëvendësojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete.

e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.

f. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet dhe kontenierët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

### **35.2 Larja dhe dezifektimi i kontenierëve**

#### **Volumet e punimeve**

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezifektojë 1373 kontenierë të volumeve 1.7 m<sup>3</sup>/ në muaj ose mesatarisht 46 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

#### **Metodologjia**

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundur kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

### **Grafikët e punimeve**

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **Rregulla për t'u zbatuar**

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..

#### **Mjetet dhe pajisjet**

1. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundur ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një)copë**.
2. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese për dezinfektimin e kontenierëve.
3. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezinfektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezinfektimin e kontenierëve.
  5. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

### **35.3 Mirëmbajtja e vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme.**

#### **Volumet e punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht pikat e grumbullimit të mbetjeve, **548** vendgrumbullime mbetjesh. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i

mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën “Tirana 4” si dhe në hartën për kete zone.

### **Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

**a.** Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonën perkatese, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (amballazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t’u depozituar nëpër kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën perkatese sado larg kontenierit të jetë hedhur.

**b.** Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme, të hedhura jashtë kontenierëve, si dhe në gjithë hapësirat publike dhe territoriale të zonës do të përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.

**d.** Pas pastrimit kontenierët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.

**f.** Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e këtij shërbimi, përgatiten nga sipermarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën vendgrumbullim mbetjesh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

**g.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

**h.** Grafikët që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që punimet të fillojnë nga ora 10.00 deri në 18.00 , me qëllim që gjithë kësaj periudhe kohore të gjithë kontenierët dhe vendet rreth tyre të jenë krejtësisht të pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

**i.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura,

respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërbushjen e tyre.

**j.** Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër pikën e grumbullimit të mbeturinave në përputhje me Rregullores me VKB Nr.1 dt.05.02.2007 “Për Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit”.

**k.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kontenierë të tejmbushur me mbetje urbane, ndërtimore, të vëllimshme dhe sipërfaqe rreth tyre të papastruara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga njoftimi apo konstatimi i problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit dhe do të përballet me penalitetet e parashikuara në përputhje me me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**l.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe deklaruar të të makinerive dhe pajisjeve dhe punëtorë për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

**m.** Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë operatori i shërbimit për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballet me penalitetet dhe gjoba në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**n.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

**P.** Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të pikave vendgrumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve voluminoze pagesa për këtë shërbim do të kryhet sipas numrit faktik të këtyre vendgrumbullimeve në terren. Cdo ndryshim do të reflektohet në situacionet mujore të pagesave.

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane dhe mbetjeve ndërtimore, të vëllimshme si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

2. Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m<sup>3</sup>. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **5 (pesë) copë;**

3. Vegla pune si lopata, fshesa për të gjithë shoferët dhe punëtorët.
4. Çdo makineri për kryerjen e këtij shërbimi duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
5. Një listë e makinave për transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së mësipërme
6. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit dhe një numër kontenierësh me volum të madh duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
7. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

### **35.4 Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.**

#### **Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotualet dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotualet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **774,222 m<sup>2</sup>** në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 4, sipas hartës bashkëngjitur.

#### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

**a.** Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj (për rrugët e kategorisë së I), si dhe sipërfaqen e plotë rrugë + trotuar për kategorinë e III.

**b.** Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.

**c.** Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.

**d.** Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.

e. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambjentit rreth tyre bëhet gjatë natës.

f. Proçesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotualet e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotualet e qytetit).

### **Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.

b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **Rregulla për t'u zbatuar**

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një "Zyrë të Kontaktimit" për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së

parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**d.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

**e.** Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**f.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

**g.** Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoha për mosplotësim të tyre.

**h.** Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
2. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

### **35.5 Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike.**

#### **Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet. në një gjatësi lineare prej **31,984** ml në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për

shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 4 (bashkëngjitur kësaj kontrate) dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate.

### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

**a.** Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë nga parkimi. Më pas çdo mbeturinë e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punëtorët e shërbimit të fshirjes me krahë..

**b.** Në të gjitha gjatësitë lineare dhe segmentet e lira nga parkimi, të rrugëve , të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri. Fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

### **Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora **21.00-04.00**.

**b.** Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 7.00 zona të jetë krejtësisht e pastër.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.

2. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

### **Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë



se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit .

**b.** Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja e rrugës me makineri teknologjike për fshirjen e rrugëve, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.

**d.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

**e.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m<sup>3</sup>, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;
- b. Makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e rrugëve, mund të kontrollohen në çdo kohe nga Autoriteti kontrator për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të lahen dhe pastrohen në fillim ose në fund të intinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.
- c. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontrator sipas një formati të miratuar paraprakisht.
- d. Automjetet, pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kësaj kontrate.
- e. Një listë e makinave fshirëse do t'i paraqitet Autoritetit kontrator para fillimit të veprimtarisë së fshirjes.

## **35.6 Mirëmbajtja dhe pastrimi gjatë ditës i akseve kryesore rrugore.**

### **Volumi i punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht të gjitha trotuaret e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha trotuaret e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, për një pjesë të rrugëve në një sipërfaqe prej **61,546** m<sup>2</sup> në ditë nga ora 10.00 deri 18.00 .

Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve për zonën Tirana 4, sipas hartës bashkëngjitur.

### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbim i mirëmbajtjes dhe pastrimit të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, konsiston në:

Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet për mbulim si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve, mbajtjen pastër gjatë ditës të koshave rrugorë dhe vendit rreth tyre, etj

### **Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të bëhet gjatë ditës nga ora 10.00 deri 18.00

**c.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që gjatë gjithë ditës trotuarët e përcaktuar për shërbim të jenë krejtësisht e pastër ose duke u pastruar.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit, pregatiten nga sipërmarresi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo segment rrugorë.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**f.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **Rregulla për tu zbatuar**

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen trotuare të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit .

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.

d. Gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësllësit,ujrave të zeza, hidrantëve,në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t’i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

e. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të pastrimit gjatë ditës, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

f. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoha për mosplotësim të tyre.

h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

### **Mjetet dhe pajisjet**

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

## **35.8 Larja e rrugëve me makinë teknologjike**

### **Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës ashtu dhe për shërbimin e dytë të larjes gjatë ditës.

1. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim një herë në ditë gjatë natës, parashikuar në metodologji për të

gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **168,337** m<sup>2</sup> në ditë përgjatë 305 ditëve të periudhës kontraktuale. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e larjes me makineri për zonën Tirana 4.

**2.** Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makineri si shërbim i dytë ditor, si larje gjatë ditës në një sipërfaqe të përgjithshme prej **92,962** m<sup>2</sup>/ditë, sipas listës së rrugëve dhe volumeve të përcaktuara për larjen dy herë në ditë, për zonën Tirana 4 përgjatë muajve më të nxehtë të vitit.( gjithsej 240 ditë)

### **Specifikimet teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

**1.** Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

**2.** Larjen me presion, me makineri teknologjike larëse, si shërbim i dytë ditor, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara për këtë shërbim, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

**3.** Gjatë shërbimit të parë të larjes (gjatë natës) shpejtësia e operimit të makinave larëse gjatë procesit të larjes (zbrazjes së ujit) duhet të variojë nga 8-10 km/orë kurse gjatë shërbimit të dytë të larjes nga 15-20 km/orë.

### **Plani i Punës dhe grafikët e punimeve**

**1.** Larja e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.

**2.** Larja e rrugëve si shërbim i dytë ditor, do bëhet çdo ditë, gjatë periudhës 15 Mars – 15 Nëntor , ( gjithsej 240 ditë) nga ora 12.00 –19.00.

**3.** Larja me presion, me makinë teknologjike do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 07.00 dhe në orën 19.00 për shërbimin e dytë të larjes, zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e larë.

**4.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

**5.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

6. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

7. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **Rregulla për t'u zbatuar**

1. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.

2. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e larjes me presion të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0,8 litër ujë për 1 m<sup>2</sup> rrugë për larjen e darkës dhe 0.6 litër ujë për m<sup>2</sup> për larjen e ditës.

3. Larja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë.

4. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes me makineri për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.

5. Përfaqësuesit e Autoritetit kontraktor do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes së dytë dhe mund ti kërkojë Operatorit të Shërbimit kryerjen e këtij shërbimi në ditët e tjera të vitit ose gjatë stinës së verës kur të jetë e nevojshme, në përputhje me çmimet njësi të preventivit të punimeve dhe sipërfaqeve të rrugëve sipas listës së rrugëve bashkëngjitur kontratës, një kërkesë zyrtare të Autoritetit kontraktor, si dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.

6. Do të konsiderohet e pavlefshme larja e rrugëve në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontraktor për shkaqe të ndryshme.

7. Autoriteti kontraktor do të nxisë Operatori i shërbimitn të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për larjen e rrugëve, si puse, etj.

8. Listat përkatëse të rrugëve që do lahen i bashkëngjiten kësaj kontrate.

9. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do mbarten nga operatori i shërbimit.

10. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për larjen e rrugëve.

## **Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

1. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**; Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.
2. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
3. Të gjitha makinat për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
5. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.
6. Një listë e makinave larëse do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së larjes.

### **35.9 “Edukimi Publik Mjedisor”**

Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatorit i shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve ne burim, etj periudhës së kontratës.

Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së operatorit i shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Ky kontakt mund të realizohet si nëpërmjet mass-mediave ashtu edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese.

Operatori i shërbimit duhet të mundësoj shpërndarjen e materialeve informative të paktën një here ne gjashtë muaj (duke filluar nga dita e firmosjes se kontrates). Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotjes, parandalimin e

saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë qytetarët e kryeqytetit të bëhen pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

Operatori i shërbimit duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik mjedisor që të parkohet në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.

Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontraktor.

Në rast të mos përmbushjes të edukimit mjedisor apo plotësimit të pjeshëm të tij aplikohen gjoba.

Ne bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor, Operatori i zones duhet të pregatisë dhe të promovojë spote publicitare që percjellin mesazhin e Bashkisë Tirane në këto kontekste. Këto spote duhet të realizohen dhe të publikohen në disa nga TV e Kryeqytetit që do të saktësohen nga Autoriteti Kontraktor, fluksi i promovimit të tyre do të saktësohet nga Autoriteti Kontraktor ndërsa kostot e këtij shërbimi do të jenë në ngarkim të Operatorit të shërbimit.

#### **35.10. Specifikimet teknike të Kontenierëve**

**Sasia e kërkuar e kontenierëve për zonën “Tirana IV” është 1373 copë.**

##### **TE DHENA TEKNIKE TE KONTENIERIT 1700 LITRA:**

Kontenierët do të përdoren për grumbullimin e mbetjeve urbane dhe duhet të kenë karakteristikat si më poshtë vijojnë:

##### ***Trupi i kontenierit (vaska):***

Trupi i kontenierit nga brenda (vaska e zinguar). Ekstra përforcim i bazës së rrotës, i ngjitur tek kontenieri. Sistem kullimi fundor për derdhjen e lëngjeve të grumbulluar nga mbetjet apo gjatë larjes së kontenierit. Kapaciteti i plote 1700 litra. Doreza anesore për terheqjen e kontenierit.

Kontenierët duhet të jenë të lyer me bojë(vaska) Portokalli,(kapaku i kuq). Spesori i profilit të vaskës 1.5-4 mm.

##### **Kapaku**

Metalik. Me përforcues të tërthortë për ekstra rezistencë. Profil i harkuar ose i drejtë për rrjedhje të ujrave të shiut. Sistemi i hapjes së kapakut me pedale qendrore. Ndër të tjera kapaku duhet jetë i pajisur edhe me një dorezë, në pjesën e përparme ose anesore, për raste të hapjes së kapakut në mënyrë manuale. Ngjyra e kapakut, e kuqe.

##### **Pedalja**

Pedalja duhet të jetë me profil metalik me spesor 4 mm për ekstra rezistencë.

##### **Rrotat**

Rrota rezistente me çelik të galvanizuar në qendër dhe unazë gome rezistente në pjesën e kontaktit me tokën. Diametri i rrotës 200mm dhe me rrotullim 360°. 4 rrota të

kthyeshme (me kokë rrotulluese), me gomë plastike solide, me kuzhineta, kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 250kg;

### **Modeli i kapjes së kazanit**

Attacco Bologna/ Din.

### **Sinjalistika**

Operatori duhet të sigurojë dhe ngjisë adezivë tek kazanët, me informacion mbi mënyrën e dorëzimit të mbetjeve, ndalimet, eiketa, adëzivë për ndalim parkimi para kazanëve, shirita me ngjyre fosfoeshente, logo e Bashkisë së Tiranës. (Pas miratimit të formatit nga Bashkia Tirane). Ofertuesi mund të ofrojë edhe modele të tjera por duke marrë paraprakisht miratimin e autoritetit kontraktor si dhe duke respektuar gjithnjë kohën e parashikuar për dorëzimin e kontenierëve.

### **Targë e fiksuar (gozhduar) ose e stampuar**

Mbi çdo kazanë, nga prodhuesi, do të fiksohet një targë me dimension 10cm x 4cm ku do të stampohet një kod identifikimi për kazanin me 6 shifra (duke u nisur nga 000000 e deri në 002500), viti i fabrikimit të kazanit dhe kapaciteti.

### **Përputhja**

Sipas normativës UNI EN 840 (UNI 10571).

### **Të tjera.**

Kazani duhet të jetë në gjendje të durojë gjatë kohës, për të gjithë përbërsit, temperatura nga -20°C deri +50°C;

Kazani duhet të strukturuar në mënyrë që të garantojë një mbajtje peshe deri në 450kg, pa pësuar asnjë deformim permanent

Hapja minimale, me gjysëm pedale duhet të jetë 450mm, ndërsa në fazën e zbrazjes ose të larjes duhet të jetë minimalisht 1000mm.

## **Neni 36 Forca Madhore**

36.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

36.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.



36.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

#### **Neni 37 Garancia e kontratës**

**37.1** Garancia e kontratës do të jetë në masën 10 % të vlerës totale të kontratës të llogaritur në bazë të preventivit total të ofruar nga shoqëria fituese dhe konkretisht në vlerën **83,880,092** (tetëdhjetë e tre milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë nentëdhjetë e dy) **lekë**.

37.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

37.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

37.4 Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontrates.

#### **Neni 38 Klauzolë shtesë**

38.1 Kushtet dhe termat e kësaj kontrate nuk mund të ndryshohen ose modifikohen përveçse me vullnetin e palëve.

#### **Neni 39 Legjislacioni**

39.1 Kontrata do të qeveriset nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

#### **Neni 40 Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

40.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

#### **Neni 41 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

#### **Neni 42 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

42.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

42.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

42.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

#### **Neni 43 Ndërprerja për Mosplotësim**

43.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

43.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

#### **Neni 44 Zgjidhja e kontratës**

44.1 Në rast të shkeljeve të dispozitave të kësaj kontrate nga pala shkelëse, ajo është e detyruar ti rregullojë ato. Palës shkelëse i ngarkohen shpenzimet e rregullimit të këtyre shkeljeve.

44.2 Me konstatimin e shkeljeve të kontratës, Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës i bën njoftim me shkrim Kontraktuesit për konstatimin dhe detyrimin e Kontraktuesit për rregullimin e tyre brenda afateve të parashikuara në kontratë.

44.3 Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë po nuk kufizohen në sa vijon:

- a. Nëse Kontraktuesi nuk kryen shërbimin e pastrimit në një pjesë të zonës apo në të gjithë zonën e parashikuar në këtë kontratë, për një periudhë të pandërprerë prej 7 ditësh me përjashtim të rastit të përcaktuar në neni 10.7 të kësaj kontrate.
- b. Nëse masa e punës së pakryer dhe e penaliteteve të aplikuara tejkalon 15 % të vlerës vjetore të kontratës.
- c. Nëse Kontraktuesi falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit.
- d. Nëse Kontraktuesi nuk ka në dispozicion dhe gjëndje pune, apo ndryshon gjatë kohëzgjatjes së kontratës automjetet e kërkuara sipas Specifikimeve Teknike dhe të paraqitura nga Kontraktuesi në ofertë pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë.

44.4 Nëse kontrata për shkak të shkeljeve priset atëherë Autoritetit Kontraktor Bashkisë i lindin këto të drejta:

- a. E drejta për të deklaruar kontratën të prishur duke i dhënë Kontraktuesit një njoftim me shkrim brenda një afati prej 30 ditësh, me argumentat përkatëse. Në qoftë se kontrata priset, Kontraktuesi duhet të sigurojë shërbimin e pastrimit për një periudhë prej 90 ditësh nga dita e njoftimit të prishjes së kontratës. Për këtë kohë Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë është e detyruar të kryejë pagesën e shërbimit.

- b. Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, ka të drejtën të sekuestrojë garancinë e kontratës të ngurtësuar në masën e përcaktuar në kontratë.
- c. Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës ka të drejtën që t'i kërkojë dëmshpërblim Kontraktuesit në masën e dëmit të shkaktuar.

#### **Neni 45 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

45.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

45.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 46 Dokumente që i bashkëlidhen kësaj kontrate**

Pjesë Integrale e kësaj kontrate do të jenë:

1. Sigurimi i Kontratës
2. Formulari i Ofertës
3. Preventivi i shërbimeve
4. Specifikimet teknike
5. Material shpjegues Volume Larje/Fshirje/Mirëmbajtje/Kontenierë.
6. Harta treguese në zonën Tirana 4.

#### **Neni 47 Të përgjithshme**

Kjo kontratë hartohet në 6 (gjashtë) kopje të njëjta në gjuhën shqipe, prej të cilave 4 (katër) kopje i mban Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë dhe 1 (një) kopje e mban Kontraktuesi.

### **PALËT KONTRAKTUESE**

**AUTORITETI KONTRAKTOR**

**KONTRAKTUESI**

**BASHKIA E TIRANËS**

**“FUSHA” SHPK**

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

*Emri dhe firma e Përfaqësuesit*

**Erion VELIAJ**

**Shkëlqim Fusha**

**Titullar i Autoritetit Kontraktor**

**Administratori**

**KONTRATE SHËRBIMI**


Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkinë e Tiranës

BASHKIA TIRANË

27496 7 net  
Dt 13.9.16

**KONTRATË SHËRBIMI**

Për administrimin e shërbimit të pastrimit dhe mbledhjes të mbetjeve urbane në Bashkinë e Tiranës

CV - 

## KONTRATE SHËRBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

### MIDIS

**Bashkisë Tiranë**, me seli në Tiranë, Sheshi Skënderbej 2, përfaqësuar nga Kryetari, Z. Erion Veliaj, lindur në Tiranë, më 17 Dhjetor 1979, me numër personal H91217035J, i cili vepron në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 23.05.2016 (në vijim referuar si "**Bashkia**")

dhe

**ECO TIRANA Sh.A.**, me seli ligjore në Tiranë, Rruga e Bogdaneve, pallati EuroCol, kati i V, zyra 34 dhe NIPT L61908027S, përfaqësuar nga Administratori i Vetëm Z. Diego Testi, lindur në Verona, më 22 shkurt 1968, me pasaportë nr. AA3709303, me adresë për shkak të detyrës pranë selisë ligjore të shoqërisë i cili vepron në baze të vendimit të Këshillit të Administratoreve të datës 25 gusht 2016 (në vijim referuar si "**Eco Tirana**")

#### Kushtet paraprake:


- A. Bashkia e Tiranës ka krijuar një shoqëri me objekt të posacëm shërbimin e pastrimit që zotëron autonomi funksionale të duhur (Eco Tirana), përmes së cilës synon të ofrojë shërbime për qytetarët e Tiranës duke përdorur teknologji, metodologji dhe nivele cilësore në lartësinë e një kryeqyteti Europian, rol të cilin qyteti i Tiranës aspiron të luaj
- B. Bashkia e Tiranës synon krijimin e një sistemi grumbullimi të diferencuar të mbetjeve, i cili bazohet në parimin e rikuperimit të materialeve për uljen e konsumit të burimeve natyrore dhe nxitjen e krijimit dhe zhvillimit të një sistemi industrial të trajtimit të mbetjeve nëpërmjet hedhjes në tregun e brendshëm të mbetjeve për tu përpunuar,
- C. Bashkia e Tiranës nëpërmjet një shoqërie me objekt të posacëm shërbimin e pastrimit synon t'i përcjellë qytetarve, mbi të gjithë studentëve, informacionet e nevojshme për administrimin e duhur të mbetjeve të prodhuara dhe për të sensibilizuar qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit;
- D. Bashkia me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 23.05.2016 ka vendosur themelimin e shoqërisë Eco Tirana, duke i dhënë asaj formën juridike të një ndërmarrje publike.
- E. Bashkia me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 23.05.2016 ka vendosur që Eco Tirana do të mbulojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve urbane për atë pjesë të territorit të Bashkisë së Tiranës të përcaktuar në Shtojcën B si "Zona e Kuqe" dhe në përfundim të muajit të 18 (tetëmbëdhjetë), në mungesë të ankesave objektive dhe të dokumentuara në lidhje me mbarëvajtjen e shërbimit, administrimi i grumbullimit të mbetjeve urbane do të shtrihet në mënyrë automatike në të gjithë Bashkinë e Tiranës për një kohëzgjatje totale prej 25 (njëzet e pesë) vjetësh;

**Përveç sa** parashikohet në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 23.05.2016, është në interesin e palëve të përcaktohen kushtet ekonomike dhe mënyrat e kryerjes së shërbimit të pastrimit të mjedisit që i është besuar Eco Tirana-s;

**Duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake palët bien dakord për sa më poshtë:**

#### Neni 1 - Kushtet paraprake dhe shtojcat

- 1.1 Kushtet paraprake dhe shtojcat (Specifikimet teknike) janë pjesë përbërëse dhe thelbsore e kësaj kontrate.
- 1.2 Përkufizime:
  - a. "E drejta për ofrimin e shërbimit" - dhënia e drejtpërdrejtë e së drejtës për ofrimin e Shërbimit Shoqërisë nga ana e Bashkisë;
  - b. "Shtojca/Shtojcat" – aktet dhe dokumentat që janë pjesë përbërëse dhe thelbsore e kësaj Kontrate, të përcaktuar më sipër;
  - c. "Specifikimet teknike" - dokumenti, bashkëlidhur kësaj Kontrate si Shtojca C, i cili përcakton dhe rregullon punët/aktivitetet që përbëjnë Shërbimin. Në rast mospërputhje të mundshme midis përmbytjes së këtij parashikimi dhe Specifikimeve Teknike, kjo e fundit do të mbizotërojë;



## KONTRATE SHERBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

- d. "Bashkia" – njësia vendore për të cilin ofrohet Shërbimi i përcaktuar në Specifikimet Teknike;
- e. "Kontrata" –ky akt dhe Shtojcat e tij;
- f. "Pagesa për Shërbimin" – shpërblimi i Eco Tirana për kryerjen e Shërbimit, duke zbritur Tarifën e Shërbimeve Opsionale;
- g. "Data Efektive" - data e marrjes për herë të parë të Shërbimeve Bazë, qofshin këto të pjesshme, të cilët do të kryhen efektivisht dhe gradualisht nga Eco Tirana sipas afateve të përcaktuara në Shtojcën A;
- h. "Raporti i Vlerësimit" - raporti i vlerësimit i lëshuar nga Bashkia në lidhje me sasinë, cilësinë, afatin, shpenzimet për punët/aktivitetet e kryera nga Eco Tirana në vitin paraardhës, i pajisur me shënime për rezervat dhe shkeljet e konstatuara eventualisht nga Bashkia ose nga palë të treta, për Penalitetet e aplikuara dhe për çdo aspekt tjetër i rëndësishëm;
- i. "Sigurimi i kontratës" – garancia bankare ose sigurim i dhënë nga Eco Tirana për Bashkinë;
- j. "Ditët" – ditët kalendarike dhe të njëpasnjëshme, me shtyrje ditën e parë të punës në rast të përfundimit të afatit në ditë feste;
- k. "Pala/Palët" – subjektet nënshkruese të kësaj Kontrate, individualisht ose bashkarisht;
- l. "Plani Vjetor i Aktiviteteve" –plani i hartuar dhe i azhurnuar çdo vit nga Eco Tirana që tregon llojet, sasinë dhe cmimet indikative perkatëse të shërbimeve të planifikuara për tu kryer në vitin që i referohet, i cili merr miratim paraprak nga Bashkia e Tiranës;
- m. "Plani i Komunikimit" – modeli i organizimit, i parashikuar në Specifikimet Teknike, i realizuar nga Eco Tirana në zbatim të parashikimeve mbi aksesin e publikut në informacionin mjedisor. Plani i komunikimit realizohet nëpërmjet një sistemi online, i cili mundëson komunikim midis Eco Tirana, Bashkive, përdoruesve dhe në përgjithësi subjekteve, private e publike, që janë të përfshirë për çdo arsye në administrimin e integruar të mbetjeve, duke përfshirë shoqatat e konsumatorëve., i cili vendos një sistem monitorimi të përhershëm në përputhje me parametrat e përcaktuara në këtë Kontratë, si dhe i një sistemi informimi të vazhdueshëm në lidhje me aktivitetet e administrimit;
- n. "Polica e Sigurimit" – sigurimi i lëshuar nga një shoqëri sigurimi për mbulimin e dëmeve eventualisht të shkaktuar ndaj të tretëve nga Eco Tirana gjatë kryerjes së Shërbimit;
- o. "Raportimi i administrimit të shërbimit" – dokumenti nëpërmjet të cilit Eco Tirana, me qëlimin për të mundësuar monitorimin dhe kontrollin e Shërbimit dhe zbatimin e Kontratës, raporton rezultatet e Shërbimit çdo tre muaj dhe çdo vit ;
- p. "Shërbimet Plotësuese" – shërbime me kërkesë që përfshihen në kuadër të shërbimeve të pastrimit urban, të cilat kryhen vetëm me kërkesë specifike të Bashkisë, që janë plotësuese të Shërbimeve Bazë, me kusht që të jenë përcaktuar në Specifikimet Teknike dhe të jenë negociuar me marrëveshje të veçantë dhe të sjellin shtimin e tarifës përkatëse;
- q. "Shërbimet Bazë" – shërbimet e administrimit të mbetjeve, të programuara ose sipas kërkesës, për tu kryer në territorin e Bashkisë, siç përcaktohen në Specifikimet Teknike;
- r. "Shërbimet Opsionale" – shërbimet me kërkesë, jashtë Shërbimit dhe Pagesës së Shërbimit, që nuk përfshihen në sektorin e administrimit të mbetjeve dhe të pastrimit urban, të cilët aktivizohen në diskrecionin e Bashkisë dhe që nuk jepen në mënyrë ekskluzive.,;
- s. "Shërbimi" – tërësia e shërbimeve të administrimit të mbetjeve urbane dhe çdo gjëje të ngjashme, të prodhuara në territorin e Bashkisë, të programuara ose me kërkesë, që identifikohen me Shërbimet Bazë dhe Shërbimet Plotësuese, të cilat përfshijnë aktivitetet/punët në vijim:
  - (i) grumbullimin e diferencuar dhe të padiferencuar, rrugor ose shtëpiak, të:
    - 1. mbetjeve shtëpiake me prejardhje nga objekte dhe vende me destinacion banimi;
    - 2. mbetjeve jo të rrezikshme me prejardhje nga objekte dhe vende me destinacion të ndryshëm nga pika 1), të ngjashme me mbetjet urbane për sa i përket cilësisë dhe sasisë;
    - 3. mbetjeve me prejardhje nga pastrimi i rrugëve;
    - 4. mbetjeve të çfarëdolloj natyre ose prejardhjeje, që gjenden në rrugë dhe zona publike ose në rrugët dhe zonat private gjithsesi në përdorim publik;
    - 5. mbetjeve vegjetale me prejardhje nga zonat e gjelbra, si kopshte, parqe dhe zona të ngjashme në zonat ku e drejta e ofrimit të shërbimit i është caktuar Eco Tirana-s;
  - (ii) pastrimin urban, i përbërë nga shërbimet e:
    - 1. fshirjes manuale, mekanike ose të përzier të rrugëve dhe shesheve publike ose private në përdorim publik;
    - 2. larjes së rrugëve dhe shesheve publike ose private në përdorim publik;
    - 3. pastrimit të kazanëve rrugor dhe panairëve dhe tregjeve të rregulluara;
    - 4. heqjen e mbetjeve të braktisura;



## KONTRATE SHËRBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranes

(iii) transportimin dhe vendosjen në impiantet e rikuperimit, trajtimit dhe asgjësimit përfundimtar;

(iv) dhe aktivitete të fshirjes së rrugëve në mënyrë manuale, mekanike ose të përzier, përfshirë edhe larjen e rrugëve, të kryera në zona publike ose private në përdorim publik, të zhvilluara sipas sasisë dhe mënyrave të përcaktuara në Specifikimet Teknike.

### Neni 2 – Objekti i Kontratës

- 2.1 Në bazë të kësaj Kontrate, Bashkia i jep të drejtën ekskluzive të ofrimit të Shërbimit të pastrimit Eco Tirana-s, e cila pranon, Shërbim i cili do të kufizohet fillimisht në "ZONËN E KUQE" (siç përcaktohet në planimetrinë e bashkëlidhur si Shtojca B) dhe, më pas në harkun kohor të 18 muajve, do të fillojë shtrirjen e shërbimeve derisa të mbulojë të gjithë territorin e Bashkisë, nëse nuk do të ketë motive objektivi të dokumentuara të mospërbushjes së rëndë dhe të vazhduar të shërbimeve nga ana e Eco Tirana.
- 2.2 Llojet dhe sasinë e kryerjes së shërbimit përcaktohen në Shtojcën C – Specifikimet Teknike.
- 2.3 Përveç niveleve të sasisë dhe cilësisë së shërbimit të përcaktuara në Specifikimet Teknike, Eco Tirana do të jetë e lirë të organizojë oraret dhe ditët e grumbullimit sipas kriterëve të efikasitetit organizativ, të cilat do t'i komunikohen Bashkisë nëpërmjet Planit Vjetor të Aktiviteteve, i cili mund të rishikohet çdo gjashtë muaj me marrëveshje të përbashkët midis palëve në bazë të nevojave për shërbim.
- 2.4 Nga kjo Kontratë përjashtohet administrimi i mbetjeve të veçanta dhe administrimi i mbetjeve të rrezikshme, sipas klasifikimit, për të cilat Eco Tirana, mund të lidhë kontrata të posaçme shërbimi drejtpërdrejt me prodhuesit.

### Neni 3 – Karakteri i Shërbimeve

- 3.1 Shërbimet objekt i kësaj Kontrate konsiderohen plotësisht si shërbim publik dhe nuk mund të pezullohen ose braktisen, me përjashtim të grevave ose rasteve të tjera të forcës madhore. Pa përjashtuar këtu, mjetet/ndërrhyrjet e tjera të parashikuara nga kjo Kontratë dhe çdo vendim të jashtëzakonshëm dhe urgjent të Kryetarit të Bashkisë, në rastet e emergjencës shëndetësore ose higjienës publike me karakter ekskluzivisht lokal, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit publik thelbësor.
- 3.2 Nëse kushtet klimatike të jashtëzakonshme (rreshje të dendura bore, përmytje dhe/ose mot me intensitet të veçantë dhe të dhunshëm) do e bënin të pamundur kryerjen e shërbimit sipas planifikimit, ai mund të pezullohet përkohësisht deri në riparimin e rrugëve dhe normalizimin e lëvizjes së mjeteve të përdorura.

### Neni 4 - Format e bashkëpunimit

Eco Tirana, përveç detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontratë, është e gatshme të ofrojë bashkëpunimin e saj në format e përcaktuara në vijim:

- a. bashkëpunim teknik për organizimin e nismave të grumbullimit të diferencuar në nivele të ndryshme, duke përfshirë studime të mundshme fizibiliteti për realizimin e ishujve ekologjik, ndërtimin e landfillëve, projektimin dhe realizimin e impianteve specifike për administrimin, trajtimin dhe pasurimin e mbetjeve;
- b. koordinimin e shërbimeve;
- c. mbledhje, përpunim dhe shpërndarjen e të dhënave të prodhimit të mbetjeve të Bashkisë;
- d. kryerjen e shërbimeve të tjera publike të mundshme të lidhura me pastrimin e territorit, me marrëveshje paraprake me shkrim midis palëve për sa i përket kushteve shtesë të tyre me natyrë teknike, organizative dhe ekonomike. Këto shërbime të mëtejshme duhet të rregullohen me një shtojcë të posaçme plotësuese të kësaj Kontrate, nëse kërkohen me karakter të vazhdueshëm ose periodik, ose me kërkesë për ofertë dhe me preventivin përkatës të pranuar, nëse kërkohen me karakter të përkohshëm;
- e. nxitjen e formave alternative të asgjësimit që lejojnë një reduktim të sasisë së mbetjeve që do të

## KONTRATE SHËRBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranes

- f. asgjësohen, në bazë të teknologjive më të përparuara në dispozicion të Eco Tirana dhe në përputhje me udhëzimet e dhëna nga organet e caktuara për organizimin e asgjësimit të mbetjeve; programimin e fushatave të sensibilizimit të qytetarëve mbi shërbimet e aktivizuara ose për tu aktivizuar dhe mbi rreziqet industriale që rrjedhin prej tyre.

### Neni 5 – Kohëzgjatja e Kontratës


- 5.1 Përveç sa parashikohet në vendimin e Këshillit nr. 40, datë 23.05.2016 dhe në nenin 1.2 më sipër, kohëzgjatja e kësaj Kontrate është jo më pak se 25 vjet duke filluar nga Data Efektive e Shërbimit, e rinovueshme për një kohëzgjatje të barabartë ose të ndryshme me vullnetin e shprehur të palëve nënshkruese.
- 5.2 Data Efektive do të rezultojë nga procesverbali i posaçëm i nënshkruar nga Palët për dorëzimin dhe marrjen njëkohësisht përsipër të Shërbimeve bazë.
- 5.3 Nëse në përfundim të kësaj Kontrate nuk do të kenë përfunduar formalitetet në lidhje me procedurën e re për dhënien e së drejtës së ofrimit të Shërbimit, Eco Tirana do të garantojë kryerjen dhe vazhdimësinë e tij sipas kushteve të njëjta teknike dhe ekonomike, deri në datën e marrjes së tij nga subjekti zëvendësues sipas vendimeve ose dispozitave që do të merren ose të bihen dakord, por gjithsesi jo më vonë se një vit nga data e përfundimit të Kontratës.

### Neni 6 – Parimet themelore

Mënyrat e ofrimit të shërbimit frymëzohen nga parimet themelore të barazisë, paanësisë, vazhdimësisë, pjesëmarrjes efikase, efektivitetit dhe kostos së ulët si dhe në zbatimin e standardeve të cilësisë si të drejta themelore të përdoruesve.

### Neni 7 - Standardet minimale të cilësisë së shërbimit

- 7.1 Eco Tirana merr përsipër të garantojë standardet të përshtatshme të cilësisë së shërbimit të përcaktuara në Specifikimet Teknike.
- 7.2 Eco Tirana, në fushën e vlerësimit të strukturave dhe stafit, garanton standarde të larta cilësore dhe ekonomike të të gjithë procedurës së dhënies së Shërbimit, jo më të ulta se ato të përcaktuara në Specifikimet Teknike.
- 7.3 Transparenca – me të cilën do të kuptojmë aksesueshmërinë, në informacionet që lidhen me çdo aspekt të organizimit të Eco Tirana, treguesve që lidhen me mbarëvajtjen e administrimit dhe përdorimin e burimeve, rezultatet e aktivitetit të matjes dhe vlerësimit të kryer në këtë drejtim nga ana e organeve kompetente përmes mjeteve të përcaktuara në Planin e Komunikimit – përbën një kërkesë të domosdoshëm të shërbimeve të ofruara.
- 7.4 Eco Tirana zbaton në Planin e Komunikimit një sistem treguesish të produktivitetit dhe të matësve të cilësisë së rendimentit të stafit, i cili lidhet me rendimentin individual dhe me rezultatin e arritur nga struktura e ndërmarrjes në tërësinë e saj.
- 7.5 Eco Tirana parashikon organizimin e dëgjësave publike vjetore mbi funksionimin dhe objektivat e përmirësimit të Shërbimit, me pjesëmarrjen e shoqatave të konsumatorëve dhe të përdoruesve, organizatave sindikale, studiuesve dhe medias, dhe shpërndarjen e përmbajtjes së tij siç përcaktohet në Planin e Komunikimit.
- 7.6 Përveç cilësisë së shërbimeve, Eco Tirana merr përsipër të fillojë grumbullimin e diferencuar të materialit të shumëfishtë të përzgjedhshëm dhe të arrijë e përqindjes minimale të grumbullimit të diferencuar, të përcaktuar nga legjislati në fuqi dhe nga mjetet e planifikimit të sektorit dhe në çdo rast në përputhje me objektivat e përcaktuar me miratimin e Këshillit Bashkiak në lidhje me të ardhurat financiare të vëna në dispozicion nga Bashkia për të mbuluar kostot shtesë që rrjedhin nga aktivitetet e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave sipas ligjit.
- 7.7 Standardet fillestare të efikasë dhe besueshmërisë së Shërbimit përcaktohen në Specifikimet





## KONTRATE SHERBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranes

Teknike dhe mund të përditësohen periodikisht me marrëveshje ndërmjet palëve, për t'i përshtatur me nevojat në ndryshim të Shërbimit.


### Neni 8 - Komunikimet midis Bashkisë dhe Eco Tirana

Bashkia do të njoftojë emrat e jo më shumë se tre zyrtarëve të Administratës së Bashkisë nëpërmjet të cilëve do të kryhet çdo komunikim në lidhje me administrimin e Kontratës dhe kushtet e ofrimit të Shërbimit. Me qëllim lehtësimin e marrëdhënieve, Eco Tirana do t'i komunikojnë Bashkisë listën e emrave dhe të numrave të telefonit të zyrtarëve të ngarkuar me administrimin e shërbimeve objekt të kësaj Kontrate.

### Art. 9 - Detyrime dhe angazhime të Eco Tirana ndaj Bashkisë

#### 9.1 Eco Tirana detyrohet të:

- a. fillojë Shërbimin, Shërbimet Plotësuese dhe Shërbime Opsionale, në përputhje me parashikimet e Specifikimeve Teknike dhe Planit të Aktiviteteve që do t'i përcillen Bashkisë sipas afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.
- b. organizojë ofrimin e Shërbimit sipas logjikave të tregut për të minimizuar kostot dhe maksimizuar cilësinë për të njëjtën kosto.
- c. kryejë Shërbimin në përputhje me linjat e përgjithshme teknike dhe administrative të tij të përfshira në Specifikimet Teknike.
- d. të dakortësojë çdo vit në bashkëpunim me Bashkinë hartimin e Planit Vjetor të Aktiviteteve në përputhje me Specifikimet Teknike.
- e. kryejë Shërbimin sipas standarteve me të mira profesionale dhe në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi dhe me aktet autorizuese dhe rregulluese të organeve kompetente si dhe në përputhje me kërkesat e Specifikimeve Teknike të kësaj Kontrate, me kërkesat rregullatore të Bashkisë dhe me dispozitat ligjore në mënyrë që të sigurojë rezultatin e kërkuar, në veçanti:
  - (i) duke kontrolluar në vend kushtet e vendeve dhe zbatimin e udhëzimeve të marra, me përgjegjësinë për t'i përshtatur me strukturën efektive të këtyre vendeve;
  - (ii) duke patur në kontroll të gjitha specifikat dhe detajet e ofrimit të Shërbimit, duke paralajmëruar në mënyrë të menjëhershme ndryshimet apo shtesat e nevojshme për ta mundësuar ofrimin e një Shërbimi konform kërkesave që rrjedhin nga karakteristikat e Shërbimit;
  - (iii) kur është e nevojshme të marrë në dorëzim çelësat e hyrjes në vendet ku duhet të kryhen shërbimet apo depozituar mjetet dhe materialet, duke marrë përsipër çdo detyrim dhe përgjegjësi përkatëse;
  - (iv) t'i komunikojë paraprakisht Bashkisë numrin e punonjësve që do të punësohen për kryerjen e Shërbimit dhe personave të ngarkuar për sigurinë;
  - (v) të pajisë të gjithë punonjësit e saj me kartë identifikimi.
- f. të disponojë gjatë kohëzgjatjes së Kontratës një organizim të përshtatshëm të mjeteve dhe burimeve njerëzore për ekzekutimin e përsosur të detyrimeve kontraktore, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulluese në fushën e administrimit të mbetjeve dhe të sigurisë në punë. Organizimi duhet të konceptohet dhe funksionojë duke u mbështetur në parimin e domosdoshmërisë, me qëllim shmangien e krijimit të kostove që tejkalojnë standardet më të mira të tregut ose që kanë lidhje me zëra jothelbësor apo që nuk kanë si qëllim të drejtpërdrejt përmirësimin e cilësisë së Shërbimit;
- g. të sigurojë mirëmbajtjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të automjeteve të përdorura dhe eventualisht zëvendësimin e tyre të menjëhershëm në rast të vjetërimit;
- h. të përmirësojë gjatë kohës nivelet e cilësisë së Shërbimit, duke i kushtuar rëndësi në veçanti aspekteve të rregullsisë, vazhdimësisë, mbrojtjes së mjedisit, informimit dhe sigurisë;
- i. të aktivizojë brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Data Efektive Planin e Komunikimit me Bashkinë dhe përdoruesit dhe ta ruajë, në përputhje me udhëzimet e Bashkisë dhe mënyrat e përcaktuara në Specifikimet Teknike. Plani i Komunikimit përmban një sistem të përhershëm të monitorimit i aksesueshëm në mënyrën e duhur edhe nga Bashkia për ushtrimin e detyrave përkatëse të kontrollit;
- j. të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore në fushën e tatimeve, të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që i referohen stafit dhe të zbatojë ndaj stafit që nuk varet nga administrata



6

## KONTRATE SHERBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

- k. publike, Kontratën kolektive të punës në fuqi;
  - l. në ekzekutimin e detyrimeve kontraktore të respektojë, rregullat e sigurisë në punë dhe rregulloret e zbatueshme;
  - m. të njoftojë menjëherë Bashkinë për çfarëdo vështirësie të hasur në kryerjen e Shërbimit;
  - n. të paraqesë në baza tremujore, me qëllim përgatitjen e Raportit të Vlerësimit, një raport mbi shërbimet e ofruara me detajet e treguesve të shërbimit të identifikuar në Specifikimet Teknike dhe që kanë të bëjnë me sasinë e mbetjeve të grumbulluara, të mbetjeve të dorëzuara në impiante, të km të fshira, të orëve të shërbimit të kryer;
  - o. të verifikojë dhe të komunikojnë nivelin e arritjes së objektivave të ofrimit të Shërbimit të parashkuara nga Specifikimet Teknike në afatet dhe mënyrat e specifikuar në të;
  - p. të vërë në dispozicion të Bashkisë dokumentacionin, mjetet dhe mbështetjen me stafin e nevojshëm për kryerjen e kontrolleve në lidhje me administrimin e Shërbimit;
  - q. të përgatisë një raport vjetor mbi gjendjen e administrimit të Shërbimit dhe masave të marra në përgjigje të ndonjë çështje të ngritur nga Bashkia;
  - r. të respektojë udhëzimet operative të Bashkisë në lidhje me drejtimin dhe kontrollin;
  - s. të mos vendosë në dijeni të palëve të treta, të ndryshme nga Bashkia, informacione, të dhëna, dokumente dhe lajme me natyrë konfidenciale, për të cilat ka marrë, gjithsesi, dijeni stafi i angazhuar në kryerjen e aktiviteteve objekt të kësaj Kontrate;
  - t. të respektojë dispozitat në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale.
- 9.2 Eco Tirana do ta ofrojë shërbimin në autonomi të plotë administrative duke aplikuar/eksperimentuar teknologji dhe metodologji të reja, për të përmbushur detyrimet kontraktore dhe për të arritur qëllimin e përcaktuar në këtë Kontratë. Bashkia e Tiranës merr përsipër të respektojë këtë autonomi duke mos ndërhyrë dhe/ose duke mos i imponuar Eco Tiranës metodologjinë dhe/ose teknologjinë dhe/ose shfrytëzimin e burimeve materiale dhe njerëzore me qëllim ofrimit të shërbimit.
- 9.3 Eco Tirana nuk do të konsiderohet në shkelje të detyrimeve që rrjedhin nga ekzekutimi i kësaj Kontrate nëse mospërmbushja e këtyre detyrimeve ndodh për shkak të forcës madhore, të tilla si, duke përfshirë por pa u kufizuar, në zjarre, përmbajtje, stuhi, akte ligjore, ndërhyrje ligjore dhe kufizuese, vendime të organeve publike jo për faj të Eco Tiranës, pezullime të përgjithme të burimeve energjetike, trazira, lufta civile, grushte shteti, akte të agresionit ndërkombëtar apo akte lufte apo për çdo shkak tjetër të paparashikueshëm ose jashtë kontrollit të arsyeshëm të Eco Tiranës, me kusht që pezullimet eventuale të punës, grevat ose mbylljet e vendit të punës nga punëdhënësi nuk do të konsiderohen si ngjarje të forcës madhore sipas këtij neni.


### Neni 10 – Detyrime dhe angazhime të Eco Tirana ndaj përdoruesve

Eco Tirana do të organizojë një shërbim të veçantë të marrëdhënieve publike me përdoruesit, përmes të cilit do të vihen në dispozicion të qytetarëve dhe të përdoruesve të zonës së shërbimit, të gjitha informacionet e dobishme për administrimin e duhur të mbetjeve urbane të prodhuara dhe për mënyrat e grumbullimit të tyre. Shërbimi i marrëdhënieve me përdoruesit do të aktivizojë një numër telefoni të posaçëm nëpërmjet të cilit përdoruesit mund të raportojnë sugjerime për përmirësimin e shërbimit dhe/ose ndërprerje të mundshëm të shërbimit. Eco Tirana do të organizojë edhe një shërbim të veçantë të edukimit mjedisor për shkollat dhe një faqe interneti. Mbulimi i kostove të këtyre shërbimeve është i garantuar nga tarifa vjetore e Shërbimit.

### Neni 11 – Detyrimet e Bashkisë

Bashkia detyrohet:

- a. t'i japë pa shpërblim Eco Tirana-s të drejtën e ndalimit dhe/ose vendosjes në rrugët dhe në zonat publike si dhe të drejtën e përdorimit të terreneve dhe ndërtesave të përshtatshme në pronësi të Bashkisë dhe/ose në pronësi të shtetit shqiptar, për pajisjet dhe impiantet e nevojshme për kryerjen e Shërbimit;
- b. të mbështesë dhe të promovojë aktivitetet e Eco Tirana nëpërmjet kryerjes së përpiktë të praktikave administrative që kanë të bëjnë me administrimin e Shërbimeve;
- c. të nxisë arritjen e objektivit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe të përshtasë, me nevojat në ndryshim, normat në fuqi në lidhje me këtë aspekt të jetës qytetare,



## KONTRATE SHERBIMI


Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

- d. të krijojë një komision të posaçëm, në të cilin do të thirren për të marrë pjesë si ekspertë, tre persona të caktuar nga Eco Tirana, me qëllim që të hartojë brenda gjashtë muajve nga nënshkrimi i kësaj Kontrate, një version të përditësuar të rregullores ekzistuese për grumbullimin e mbetjeve dhe pastrimin e qytetit;
- e. t'i komunikojë paraprakisht Eco Tirana-s, në mënyrë që të marrë një mendim paraprak dhe jo detyrues, ndryshimet në Rregulloret bashkiake dhe në Urdhrat që mund të ndikojnë në çfarëdolloj mënyre mbi Shërbimin;
- f. të transmetojë menjëherë, para miratimit të tyre, planet dhe programet e zhvillimit urban, për zonat e reja të banimit dhe urbanizimit e reja, si dhe për zonat e reja të prodhimit, me qëllim marrjen e komenteve dhe mundësimin e parashikimit tekniko-financiar të investimeve për fuqizimin ose zgjerimin e mundshëm të shërbimit në zonën e kompetencës së Eco Tirana;
- g. të transmetojë të paktën shtatë ditë përpara programin e manifestimeve të autorizuara në nivel bashkiak;
- h. brenda kompetencave të saj, të mundësojë zbatimin e kufizimeve të vendosura nga ligjet, rregulloret dhe urdhrat;
- i. nëpërmjet Policisë Bashkiake, të sigurojë asistencë teknike dhe ligjore për mbikëqyrjen e procesit të depozitimit të mbeturinave në vendet e duhura të depozitimit, në përputhje me Urdhëresat e Kryetarit në fuqi dhe Rregulloret Bashkiake në fushën e Pastrimit Urban dhe gjithashtu të ndalojë heqjen e mbetjeve urbane të riciklueshme nga kushdo brenda zonës ku EcoTirana ushtron aktivitetet e saj;
- j. kundrejt Eco Tirana-s për lëshimin e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për aktivitetin në fjalë.

### Neni 12 – Deklarimet dhe garancitë e Palëve

#### 12.1 Në Datën Efektive të Kontratës, Eco Tirana deklaron dhe i garanton Bashkisë se:

- a. është shoqëri e krijuar rregullisht, në gjendje të veprojë me të drejta të plota për zotërimin e sendeve së saj, ushtrimin e të drejtave të saj dhe për të marrë përsipër detyrime në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj;
- b. është zotëruese e lejeve, autorizimeve,, të drejtave, liçencave, marrëveshjeve të nevojshme dhe të dobishme për ofrimin e Shërbimit;
- c. zotëron në formë të qëndrueshme kapitale, kapacitete teknike, personel dhe mjete të nevojshme, të organizuara në mënyrë të përshtatshme për të administruar dhe ekzekutuar Shërbimin në përputhje me ligjin, në mënyrë profesionale dhe sipas parashikimeve të Kontratës duke marrë përsipër rrezikun.
- d. nuk ka marrë kundërshtime zyrtare nga autoritetet kompetente, njoftime, urdhra në lidhje me mosrespektimin e kërkesave mjedisore dhe të sigurisë në vendin e punës dhe se nuk ka në lidhje me këto kërkesa procedime administrative ose gjyqësore ndaj Eco Tirana apo administratorëve dhe përfaqësuesve të saj, që të ndikojnë në mënyrë serioze dhe aktuale mbi përmbushjen e detyrimeve të kësaj Kontrate nga Eco Tirana duke përjashtuar, në çdo rast, përgjegjësinë e Bashkisë, përveç rastit kur sa më sipër rrjedh nga udhëzimet e Bashkisë;
- e. ka të drejtë të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate;
- f. se nënshkrimi i kësaj Kontrate dhe marrja përsipër e detyrimeve që përmbahen aty nuk përbën shkelje të ndonjë pakti të arritur me palë të treta ose gjithsesi shkelje të ndonjë interesi të njohur dhe ligjërisht të mbrojtur të palëve të treta;
- g. ka një objekt veprimtarie që përfshin ofrimin e Shërbimit në favor të Bashkisë dhe se nuk do të ndryshohet gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate;
- h. aktiveve të trupëzuara nuk do të vendosen vullnetarisht në peng pa miratimin paraprak të Bashkisë, e cila nuk mund ta mohojë atë në mënyrë të paarsyeshme, nëse dokumentohet ekzistenca e mjeteve të përshtatshme dhe të dhënave, të cilat garantojnë mundësinë e përjashtimit të ekzekutimit të pengut. Bashkia duhet të shprehë me shkrim refuzimin në lidhje me sa më sipër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës së shkruar nga Eco Tirana. Në rast të heshtjes së zgjatur përtej afatit të mësipërm, heshtja e Bashkisë do të konsiderohet si pëlqim i heshtur;
- i. merr përsipër të mbajë të pandryshuara apo realizojë kushtet faktike dhe të së drejtës sipas këtij paragrafi për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Kontrate;
- j. merr përsipër, në çdo rast, të njoftojë menjëherë Bashkinë për çdo ndryshim të kushteve të mësipërme.



## KONTRATE SHERBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranes

- 12.2 Palët do të bashkëpunojnë në mirëbesim për të mundësuar vlefshmërinë dhe efektivitetin e kësaj Kontrate, si dhe ekzekutimin më të mirë të saj duke:
- përbushur detyrimet e marra përsipër nga secila Palë në bazë të kësaj Kontrate;
  - kryer në mirëbesim dhe në bazë të dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të gjitha veprimet dhe duke mbajtur të gjitha qëndrimet që janë të nevojshme dhe të përshtatshme edhe ndaj palëve të treta;
  - i njoftuar njëra-tjetrës të gjitha rrethanat që nuk janë marrë parasysh në këtë Kontratë ose që kanë rezultuar rishtazi, të cilat mund të modifikojnë ose të çënojnë vlefshmërinë ose efikasitetin, ose tërësinë e interesave të Palëve të krijuara nga vetë kjo Kontratë, duke negociuar në këtë rast me mirëbesim çdo shtesë ose ndryshim të përshtatshëm për të ruajtur efektivitetin dhe ekuilibrat e rënë dakord.
- 12.3 Bashkia deklaron dhe i garanton Eco Tirana-s se nuk kanë njoftime në lidhje me procedura gjyqësore për anulimin apo deklarimin e pavlefshmërisë e së drejtës për ofrimin e shërbimit, as vendime gjyqësore ose administrative të cilat mund të çënojnë, edhe potencialisht, vlefshmërinë dhe efektivitetin e tij.
- 12.4 Në rast se kjo Kontratë do të jetë objekt i veprimeve për deklarimin e pavlefshmërisë absolute apo relative apo lënies pa fuqi, edhe si pasojë e veprimeve për deklarimin e pavlefshmërisë absolute apo relative apo lënien pa fuqi të aktit administrativ të dhënies të së drejtës së shërbimit, Palët do të punojnë për atë sa është ligjrisht në fuqinë e tyre për të zbatuar ose mundësuar zbatimin e çdo akti të përshtatshëm administrativ, akti të negociueshëm apo akti gjyqësor të dobishëm për të ruajtur vlefshmërinë dhe fuqinë e plotë, ose për hequr ose kufizuar efektet çënuese që mund të rrjedhin nga vendimet e mundshme të pranimit, edhe të pjesshëm, të këtyre veprimeve apo kundërshtimeve.


### Neni 13 – Raportimi i Administrimit të Shërbimit

Eco Tirana, për të mundësuar monitorimin dhe kontrollin e Shërbimit si dhe verifikimin e zbatimit të kësaj Kontrate, brenda 1 shtatorit të çdo viti do të raportojë rezultatet e administrimit të shërbimit, duke dhënë të gjitha informacionet dhe dokumentacionin përkatës, edhe kontabël nëse është i nevojshëm, duke iu referuar në veçanti, të dhënave që lidhen me karakteristikat e shërbimeve të ofruara, me sasinë dhe cilësinë e mbetjeve të grumbulluara, me aktivitetet e zhvilluara, vështirësitë e hasura, duke përfshirë edhe ato që konsiderohen të dobishme nga Eco Tirana ose që kërkohen në mënyrë specifike nga Bashkia në lidhje me:

- sasi të mujore dhe vjetore të mbetjeve të grumbulluara në Bashki në formë të padiferencuar dhe të diferencuar, nëse aplikohet, edhe me qëllim vërtetimin e arritjes së objektivave të grumbullimit të diferencuar të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (nëse përcaktohen);
- grumbullimin me kazanë, duke treguar vendndodhjen, karakteristikat dhe numrin e tyre;
- grumbullimin nga përdoruesit, duke treguar përdoruesit të cilëve u është shërbyer dhe vendndodhjen e tyre;
- shërbimet me kërkesë/thirrje të posacme, duke treguar ndërhyrjet e kërkuara dhe të ofruara dhe prejardhjen e tyre;
- grumbullimin në panairë dhe tregje, duke treguar ndërhyrjet e kryera, eventet përkatëse dhe vendndodhjen e tyre;
- larjen e kazanëve, duke treguar vendndodhjen e tyre, karakteristikat e tyre;
- pengesat që kanë penguar ose vonuar ofrimin e shërbimeve;
- ankesat, duke treguar numrin sipas llojeve dhe afatin e zgjidhjes eventuale të problemeve të denoncuar;
- ndryshimet dhe rishikimet gjatë vitit, si dhe veprimet që kanë sjellë një devijim nga parashikimet;
- flukset e mundshme drejt impianteve ose platformave të pasurimit dhe sistemet e riciklimit, si dhe dhënat në lidhje me të ardhurat eventuale të realizuara nga shitja e këtyre materialeve;
- të dhënat në lidhje me përbushjen nga Eco Tirana të detyrimeve mbi pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të stafit.

### Neni 14 – Mbikëqyrja

- 14.1 Bashkisë i takon ushtrimi i çdo aktiviteti kontrolli dhe mbikëqyrje i konsideruar i nevojshëm për të verifikuar përputhshmërinë me këtë Kontratë si dhe efencën, efikasitetin dhe funksionalitetin e



## KONTRATE SHËRBIMI


Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

veprimeve të Eco Tirana në zbatim të Shërbimit dhe në lidhje me udhëzimet e përgjithshme dhe specifike që do të merren rast pas rasti në përputhje me Specifikimet Teknike.

- 14.2 Bashkia aktivizon, në përputhje me Statutin e shoqërisë, një sistem të brendshëm mbikëqyrjeje mbi Eco Tirana të përshtatshëm për:
- të verifikuar arrijten e objektivave të manaxhimit nga Eco Tirana, me qëllimin për të përcaktuar bashkë me Eco Tirana udhëzimet e përgjithshme të cilave duhet ti përmbahet Shërbimi, në zbatim të plotë të standardeve cilësore dhe sasore të përcaktuara në Specifikimet Teknike;
  - të organizojë një sistem të përshtatshëm informimi në lidhje me: (i) marrëdhëniet financiare me Eco Tirana; (ii) situatën e saj kontabël, manaxhuese dhe organizative dhe (iii) zbatimin e kësaj Kontrate dhe cilësinë e Shërbimit;
  - të mundësojë mbikëqyrjen periodike të mbarëvajtjes së Eco Tirana;
  - të analizojë devijimet në krahasim me objektivat e caktuara dhe të identifikojë veprimet e përshtatshme korrigjuese;
  - të analizojë kënaqësinë e përdoruesit.
- 14.3 Kontrolli kontraktor dhe tregtar i Bashkisë mbi organizimin dhe veprimtarinë e Eco Tirana nuk e përjashton ose kufizon përgjegjësinë e plotë në zbatimin e Kontratës.
- 14.4 Kontrollët do të zhvillohen, mbi bazën e standardeve dhe procedurave të rena dakord ndërmjet Palëve, si në territor ashtu edhe nëpërmjet analizës së treguesve të mëposhtëm teknik dhe ekonomik, sasior dhe cilësor të Shërbimit, në bazë të të dhënave të ofruara nga Eco Tirana, si dhe përmes anketave të pavarura në lidhje me:
- sasinë, kapacitetin dhe frekuencën e ofrimit të Shërbimit (psh. sasia e mbetjes së diktuar sipas merceologjisë së grumbullimit, vëllimi i disponueshëm, frekuenca e grumbullimit dhe fshirjes, cilësia e pastrimit etj.);
  - cilësinë e komunikimit me përdoruesit (psh. koha dhe mënyrat e përgjigjes ndaj kërkesave, numri në dispozicion të përdoruesve, fushata informuese, analiza e kënaqësisë së klientit, etj.);
  - kostot (psh. për banor, për tonelatat e mbetjeve, etj.).
- 14.5 Kontrolli territorial mbi Shërbimin do të synojë vlerësimin, me sondazhe të drejtpërdrejta në terren, të pajtueshmërisë së Shërbimit me parametrat dhe me standardet kontraktore të cilësisë, me qëllimin për të zbuluar mospërputhjet ose problemet e mundshme dhe për të ftuar Eco Tirana-n për të kryer ndërhyrjet e duhura korrigjuese.
- 14.6 Eco Tirana, nëse nuk ka pengesa të shprehura me shkrim, duhet të lejojë pa vonesë, aksesin në të dhënat, duke bashkëpunuar dhe duke lehtësuar kontrollët, duke përfshirë edhe vendosjen në dispozicion të Bashkisë të dokumentacionit të nevojshëm.
- 14.7 Aktet e inspektimit dhe të kontrollit do të kryhen në ballafaqim me Eco Tirana dhe në lidhje me to do të hartohet dhe nënshkruhet nga Palët procesverbali përkatës, i cili do të evidentojë probleme eventuale të vërtetuara për sa i përket Shërbimit dhe kundërpërgjigjet e Eco Tirana.
- 14.8 Bashkia ka gjithsesi të drejtë të kryejë inspektime dhe kontrole në vend në çdo kohë, edhe pa njoftim paraprak, por në ballafaqim me Palët, duke njoftuar në çdo rast rezultatet e inspektimit Eco Tirana-s.

### Neni 15 - Raporti i Vlerësimit

- 15.1 Në Raportin e Vlerësimit, Bashkia shqyrton Raportimin e Administrimit të Shërbimit, të dorëzuar nga Eco Tirana, mbledh rezultatet e kontroleve të kryera dhe të bisedimeve me Eco Tirana, verifikon arrijten e objektivave të pritshme të administrimit, identifikon mangësitë e mundshme të Shërbimit, duke treguar kur është rasti, Penalitetet tashmë të aplikuara, si dhe jep udhëzimet e nevojshme.
- 15.2 Bashkia i paraprin me shkrim me letër rekomande me lajmërim-marrje Eco Tirana-s, brenda datës 15 maj të çdo viti, përmbajtjen e mundshme të Raportit të Vlerësimit, për të cilin Eco Tirana ka të



## KONTRATE SHËRBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

drejtë të bëjë vërejtje brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e tij në dorëzim.

- 15.3 Bashkia përgatit dhe i komunikon me shkrim me letër rekomande me lajmërim-marrje Eco Tirana-s, brenda datës 30 qershor të çdo viti, Raportin e Vlerësimit, duke marrë parasysh vërejtjet e mundshme të bëra nga Eco Tirana.

### Neni 16 – Plani Vjetor i Aktiviteteve

- 16.1 Me perjashtim te parashikimeve te nenit 16.4 ne vijim, Eco Tirana, brenda datës 31 tetor të çdo viti, duke marrë parasysh përmbajtjen e Raportit të Vlerësimit, harton dhe informon me shkrim me letër rekomande me lajmërim-marrje Bashkinë për miratimin e Planit Vjetor të Aktiviteteve, i përgatitur duke marrë për bazë me përpikmëri shërbimet e ofruara deri në atë moment dhe kërkesat e Bashkisë për aktivizimin e Shërbimeve Plotësuese ose Shërbimeve Opsionale apo ndryshimet e atyre të listuara sipas llojit, sasisë dhe çmimeve në Planin Vjetor të Aktiviteteve të vitit të mëparshëm.

- 16.2. Plani Vjetor i Aktiviteteve përmban, në lidhje me vitin e ardhshëm :

- a. Të gjitha shërbimet e parashikuara, në njësi, volum te punimeve, volume të përditshme të punës dhe çmimin e përgjithshëm;
- b. gjithçka të parashikuar në Specifikimet Teknike në lidhje me modelin e organizimit të Shërbimit, mënyrat e monitorimit dhe efikasitetit, nivelet e integritit të stafit, planin e programuar të mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme, veprimet në lidhje me planin e komunikimit;
- c. Planin Ekonomiko Financiar të administrimit.

- 16.3. Bashkia miraton Planin Vjetor të Aktiviteteve brenda 30 nëntorit të ardhshëm dhe njofton njëkohësisht me shkrim me letër rekomande me lajmërim-marrje Eco Tirana-n.

- 16.4 Perjashtimisht për vitin 2016, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor, jo me vonë se 10 dite perpara leshimit te fatures se pare nga Eco Tirana, Eco Tirana do t'i dorezoje Bashkise planin e aktiviteteve per muajt ne fjale duke treguar ne te llojet, sasi të dhe cmimet perkatese te shërbimeve që i referohet. Bashkia miraton Planin e Aktiviteteve për këtë periudhë brenda 10 ditëve nga dorëzimi i tij dhe njofton me shkrim me letër rekomande me lajmërim-marrje Eco Tirana-n.

### Neni 17 - Sigurimi, dëmi ndaj palëve të treta, përgjegjësia dhe disiplina

- 17.1 Eco Tirana përgjigjet për përgjegjësinë që buron nga administrimi i shërbimit dhe si rrjedhojë, përgjigjet drejtpërdrejt për dëmet eventuale direkte dhe indirekte të shkaktuara për faj të saj palëve të treta ose impianteve ekzistuese në pronësi të Bashkisë, duke marrë përsipër lidhjen e një police sigurorese të posaçme.
- 17.2 Eco Tirana mban ekskluzivisht përgjegjësi për sjelljen e punonjësve si për sa i përket kryerjes së shërbimit ashtu edhe për disiplinën përkatëse të brendshme dhe të jashtme me përdoruesit.
- 17.3 Eco Tirana detyrohet kundrejt punonjësve të saj të zbatojë legjisllacionin në fuqi për sigurinë në punë dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.


### Neni 18 –Shërbime shtesë

Eco Tirana, me kërkesë të veçantë të Bashkisë, mund të përgatisë projekte për shërbime të reja që nuk përfshihen në programin e Shërbimit të përmendur në Specifikimet Teknike, duke treguar angazhimin financiar dhe metodat përkatëse të mbulimit të kostove. Projektet e përgatitura i dorëzohen Bashkisë për vlerësim dhe miratim.

### Neni 19 – Përgjegjësia Kontraktore

- 19.1 Eco Tirana është përgjegjëse për mbarëvajtjen e Shërbimit.

CU - 11



## KONTRATE SHËRBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

- 19.2 Në rast se verifikohet një rast i forcës madhore, siç përcaktohet në nenin 9.3 më lart dhe Eco Tirana e ka të pamundur ta kryejë Shërbimin plotësisht apo pjesërisht, ajo do të bëjë çmos që të njoftojë menjëherë Bashkinë, duke treguar llojin, kohëzgjatjen dhe arsyet e mospërbushjes, masat e marra dhe të parashikuara për kapërcimin e pengesave, në mënyrë që Bashkia ose autoritetet të tjera publike të mund të ndërmarrin çdo masë të dobishme dhe të përshtatshme për të eliminuar ose kufizuar dëmin ndaj përdoruesve apo higjienës ose shëndetit publik që rrjedh nga mungesa e shërbimit, duke i besuar, me urgjencë, një pale të tretë kryerjen e Shërbimit ose faza apo pjesë të tij. Për kohëzgjatjen e ndërprerjes, Tarifa e Shërbimit do të reduktohet në përpjestim me reduktimin ose mungesën e Shërbimit, pa aplikuar asnjë sanksion sipas Kontratës.
- 19.3. Në rast se Eco Tirana është në mospërbushje ndaj kësaj Kontrate, Bashkia do të bëjë ankesë me shkrim, duke e ftuar atë që të tregojë arsyet e saj brenda një afati prej 3 (tre) Ditësh, ose menjëherë, në qoftë se është urgjente. Nëse këto arsye nuk janë dhënë ose nuk janë pranuar, Bashkia do t'i dërgojë Eco Tirana-s kërkesë për përbushje të detyrimeve brenda një afati të përshtatshëm, sipas rrethanave për shërbimet ditore dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë për shërbimet e tjera apo menjëherë në qoftë se urgjenca diktohet nga kushte objektive.
- 19.4 Në prani të mospërputhjeve dhe/ose vonesave të pakorrigjuara edhe pas dërgimit të kërkesës për përbushje, Bashkia do të aplikojë Penalitetet e parashikuara në Specifikimet Teknike - pa përjashtuar të drejtën për të kërkuar dëmin shtesë pavarësisht ekzistencës së kushteve për zgjidhjen e kësaj Kontrate – nëse janë përcaktuar faktet e vonesës, pasaktësisë ose mungesës së përbushjes, shumën e penalitetit, afatin dhe mënyrat e kundërshtimit dhe kundërpërgjigjes së mundshme. Në këtë rast, Bashkia do të ketë të drejtën ta zbresë këtë shumë nga Tarifa që duhet paguar, pa përjashtuar, në çdo rast, të drejtën për të zbatuar Garancinë Kontraktore nëse do të jetë e nevojshme.
- 19.5 Pavarësisht sa më sipër, për më shumë qartësi, palët deklarojnë se sa më sipër nuk cënon të drejtën e Eco Tirana për të kërkuar të drejtat dhe/ose për të paraqitur pretendimet e saj pranë organeve përkatëse gjyqësore.
- 19.6 Njoftimi i mospërbushjes dhe aplikimi i Penaliteteve përkatëse nuk e shkarkon Eco Tirana-n nga përbushja e të gjitha detyrimeve kontraktore, duke përfshirë edhe ato që janë objekt i njoftimit.

### Neni 20 – Zgjidhja e kontratës dhe zgjidhja e njeanshme e saj

- 20.1 Do të përbëjnë shkaqe për zgjidhjen e kontratës e, për rrjedhojë, mund të sjellin gjithashtu, revokimin nga ana e Bashkisë të së drejtës për të kryer shërbimet objekt i kësaj kontrate:
- falimentimi i shoqërisë /Eco Tirana;
  - nxjerrja jashtë përdorimi, shitja ose transferimi tek palët e treta i njësisë së ndërmarrjes që ka të bëjë me kryerjen e aktiviteteve sipas kësaj Kontrate, pa autorizimin e shprehur të Bashkisë;
  - shkelje të rënda dhe të përsëritura të kësaj Kontrate dhe/ose të dispozitave ligjore që rregullojnë shërbimet e caktuara, të tilla që çënojnë ushtrimin e shërbimeve në mënyrë të gjerë dhe të rëndë;
  - mashtrimi ose mosqenia ose mbarimi ose mosplotësimi i ndonjë prej rrethanave të deklaruara nga Eco Tirana në Datën Efektive;
  - mbarimi, pavlefshmëria, paefektshmëria e Policës së Sigurimit;
  - mbarimi, pavlefshmëria, paefektshmëria e Garancisë Kontraktore;
  - mospërbushje të përsëritura të detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve;
  - kryerja e ndonjë vepre penale në fushën mjedisore, e vërtetuar nga organi kompetent;
  - nxjerrja, në dëm të subjekteve të lidhur me Eco Tirana, e vendimeve në bazë të ligjit antimafia dhe e masave parandaluese, si dhe nxjerrja e dispozitave të reja në fushën e dokumentacionit antimafia.
- 20.2 Me përjashtim të rastit sipas shkronjave "a" dhe "h" më sipër të cilave u aplikohet neni 702 i K.C., përpara se të deklarohet zgjidhjen eventuale të Kontratës dhe të marrë masën e revokimit të së drejtës për ushtrimin e Shërbimit, Bashkia do t'i komunikojë Eco Tirana-s, në bazë të nenit 702 të Kod. Civ., një kërkesë për përbushje nëpërmjet të cilës duhet ti jepet një afat i arsyeshëm brenda

## KONTRATE SHËRBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

të cilat ajo duhet të heqë pasojat e mospërbushjes dhe të sigurojë rimëkëmbjen e manaxhimit të Shërbimit në përputhje me këtë Kontratë, por jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë.


- 20.3 Eco Tirana mund ta zgjidhë Kontratën në rast të mospagesës nga ana e Bashkisë të më shumë se 6 (gjashtë) pagesave mujore. Në rast të zgjidhjes së kontratës nga Eco Tirana në rast të mospagesës nga ana e Bashkisë në përputhje me sa më sipër, Bashkia detyrohet t'i paguajnë Eco Tirana-s, një penaltet në një shumë të barabartë me vlerën që kjo e fundit do të kishte marrë në 6 (gjashtë) muajt në vijim pas zgjidhjes së Kontratës, pa përjashtuar të drejtën e saj për të kërkuar shpërblimin e dëmit shtesë.
- 20.4 Në të gjitha rastet e zgjidhjes së Kontratës të përmendura në këtë nen dhe duke respektuar afatet për korrigjimin, aty ku parashikohen, Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur, kur pala e cënuar e njofton palën tjetër me letër rekomande me lajmërim-marrje në lidhje me qëllimin e saj për të zgjidhur Kontratën.
- 20.5 Mospërbushja e detyrimeve në lidhje me administrimin e Shërbimeve Plotësuese, Opsionale ose shërbimeve të tjera që nuk përfshihen në Specifikimet Teknike, por që janë shtuar më vonë si një shtesë e kësaj Kontrate, sjell zgjidhjen e pjeshme të kësaj Kontrate vetëm në lidhje me këto shërbime.
- 20.6 Në të gjitha rastet e zgjidhjes së Kontratës, nuk do të preken të drejtat e secilës Palë, të cilat ekzistojnë para datës së zgjidhjes, si dhe të gjitha të drejtat e tjera të parashikuara nga kjo Kontratë ose nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë të drejtën për dëmshpërblim.

### Neni 21 – Sigurimi i kontratës

- 21.1. Eco Tirana vendos në favor të Bashkisë një Sigurim Kontrate në formën e dorëzarisë, të lëshuar nga një bankë ose nga një shoqëri sigurimi, të barabartë me 10% të Tarifës fillestare të Shërbimit, duke e përshtatur nga viti në vit me Tarifën e Shërbimit të aplikuar në vitin paraardhës.
- 21.2. Sigurimi i Kontratës jepet për të garantuar përbushjen e të gjitha detyrimeve të kësaj Kontrate në lidhje me marrjen përsipër dhe kryerjen e Shërbimit në territorin e Bashkisë, pagesën e Penalteteve dhe shpërblimin e dëmeve, edhe mjedisore, të pambuluara nga Polica e Sigurimit të cilat i janë shkaktuar Bashkisë ose palëve të treta nga mospërbushja eventuale e këtyre detyrimeve, pa përjashtuar të drejtën e shpërblimit të dëmit shtesë.
- 21.3. Bashkia, gjithashtu, ka të drejtë të përdori Sigurimin e Kontratës edhe për shpenzimet e mundshme shtesë të kryera për vazhdimin e Shërbimit, përkohësisht ose përfundimisht, nëpërmjet një ofruesi tjetër.
- 21.4. Bashkia ka të drejtë të përdori Sigurimin e Kontratës për të kryer pagesat e detyrueshme sipas ligjit në rastet e moszbatimit nga Eco Tirana të dispozitave dhe parashikimeve të kontratave kolektive, të ligjeve dhe rregulloreve për mbrojtjen, sigurinë, sigurimin, ndihmën dhe sigurinë fizike të punonjësve, në masën për të cilën është e detyruar.
- 21.5. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) Ditëve nga ekzekutimi i Sigurimit të Kontratës, Eco Tirana ka detyrimin të zëvendësojë shumën e Sigurimit të Kontratës, nëse ekzekutohet, në mënyrë që ajo të mbetet e paprekur gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
- 21.6. Sigurimi i Kontratës do të konsiderohet automatikisht i çliruar, pa pasur nevojë për ndonjë pëlqim nga ana e palës së garantuar, në qoftë se brenda 3 (tre) muajve pas përfundimit të Shërbimit të dhënë dhe përfundimit të kësaj Kontrate nuk ka pasur ndonjë kërkesë për ekzekutim.

### Neni 22 – Rishikimi i Kontratës së Shërbimit

- 22.1 Kjo Kontratë rishikohet automatikisht në rastin e:
- marrëveshjes së përbashkët midis palëve;



13



## KONTRATE SHERBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

- b. përfshirjes së Shërbimeve Shtesë ose Shërbimeve Opsionale;
- c. ndryshimeve legjislativë kombëtare;
- d. zgjerimit të territorit të mbuluar nga Shërbimi përtej Zonës së Kuqe.

22.2 Në rastet e mësipërme, palët marrin përsipër të bëjnë gjithçka të nevojshme, brenda kompetencave të tyre, me qëllim që të ruhet i pandryshuar ekulibri ekonomik financiar i kësaj Kkontrate.

### Neni 23 - Ndalimi i cedimit të Kontratës

23.1 Eco Tirana i ndalohet cedimi i kontratës tek palët e treta.

23.2 Eco Tirana mund të përdorë palë të treta për kryerjen e aktiviteteve të saj dhe të shërbimeve të rregulluara nga kjo Kontratë, duke përdorur mjetet ligjore të parashikuara nga statuti i shoqërisë dhe të konsideruara si më të përshtatshme për këtë qëllim, duke mbetur gjithsesi subjekti i vetëm përgjegjës kundrejt Bashkisë për zbatimin e rregullt dhe në kohë të shërbimeve të ofruara. Në bazë të këtij paragrafi nuk përbën cedim të kësaj Kontrate ose nën-kontraktim të Shërbimit, dhënia në *outsourcing* në çdo formë i fazave të veçanta të aktiviteteve marzhinale, ndihmëse apo të jashtëzakonshme si për shembull, mirëmbajtja, furnizimi, transporti i veçantë, asgjësimi i mbetjeve që nuk mund të trajtohen në impiantet e parashikuara në Specifikimet Teknike.

23.3 Nuk konsiderohen si palë të treta për qëllimet e kësaj Kontrate, shoqëritë e kontrolluara/ lidhura/në të cilat zotërohen pjesëmarrje.

### Neni 24 – Pagesa për Shërbimin

Pagesa Shërbimin për Zonën e Kuqe sipas nenit 1.2 të Kontratës, në përputhje me vendimin e Këshillit Bashkiak që autorizon themelimin e Eco Tirana SH.A. është e barabartë me 2,500,000 €/vit (dy milion e pesëqind mijë euro) pa TVSH se ciles i korrispondon vlera në lek 344,000,000 (treqind e dyzetekatër milion) sipas kursit të këmimit të datës së nënshkrimit të Kontrates të publikuar nga Banka e Shqipërisë, të cilës i shtohet 10% (e barabartë me 250,000 €/vit dyqind e pesëdhjetë mijë euro) nga data e fillimit efektiv të grumbullimit të diferencuar të materialit të shumëfishtë të përzgjedhshëm.

### Neni 25 – Likuidimi i Pagesës së shërbimit

Për ekzekutimin e shërbimeve të parashikuara në **Specifikimet Teknike**, Bashkia do t'i paguajë Eco Tirana-s, në këste mujore, , vlerën e faturës së lëshuar prej saj, në përputhje me situacionin e punimeve të kryera, parashikuar në Specifikimet Teknike dhe Planin e miratuar të Aktiviteteve. Vlera përkatëse do të paguhet në monedhë fikse për përfituesin në llogarinë bankare të treguar prej tij, brenda Ditës së 30 (tridhjetë) të muajit që pason kryerjen e shërbimeve në fjalë.


### Neni 26 – Vlerësimi nga shitja e materialeve të grumbullimit të diferencuar

Të ardhurat e fituara nga tregtimi dhe shitja e produkteve që rezultojnë nga grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të ngurta urbane nga Eco Tirana, do të përdoren për të zgjeruar shërbimet dhe për të përmirësuar cilësinë e tyre si dhe për fushata specifike informuese dhe shërbimi për qytetarët e Tiranës.

### Neni 27 – Indeksimi vjetor i Pagesës së Shërbimit

27.1 Në mungesë të ndryshimeve thelbësore në parametrat operativ të përcaktuar në Specifikimet Teknike, Bashkia bën një indeksim vjetor të Pagesës së Shërbimit të barabartë me 75% të indeksit të rritjes së çmimeve të prodhimit të publikuar nga INSTAT (për shërbimet mjedisore të rregulluara), duke garantuar ekulibrin ekonomik - financiar.

27.2 Ndryshimet për shkak të përcaktimeve të njëanshme nga Bashkia dhe nga subjektet me kompetenca legjislativë si rrjedhojë vetëm e nxjerrjes të ligjeve ose rregulloreve të reja, sjellin një indeksim të Pagesës së Shërbimit në lidhje me vitin që pason atë në të cilin ka ndodhur ndryshimi, me kusht që të jetë në rritje, i cili duhet të llogaritet mënyrë që tu garantojë Palëve rikuperimin e shpenzimeve më të mëdha të kryera në vitin kur ka ndodhur ndryshimi në fjalë.

14 

## KONTRATE SHERBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

27.3 Çdo ndryshim strukturor i Shërbimit, siç është miratimi i sistemeve të reja teknologjike për grumbullimin dhe transportimin, do të sjellë rishikimin e Pagesës së Shërbimit që do të përcaktohet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet Palëve.

### Neni 28 – Likuidimi i diferencave

28.1 Likuidimi i shumave që rrjedhin si diferencë dhe/ose e indeksimit të Pagesës së Shërbimit duhet të bëhet brenda afatit të detyrueshëm prej 60 (gjashtëdhjetë) Ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës nga Eco Tirana, përveç rastit kur Bashkia, brenda të njëjtit afat, ka kundërshtuar saktësinë e llogaritjeve nëpërmjet dërgimit të një letre rekomande, e cila tregon në mënyrë specifike pasaktësitë e gjetura.

28.2 Në rast kundërshtimi sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara më sipër, palëve u jepet një afat i mëtejshëm prej 30 (tridhjetë) Ditë për të rënë dakord, përcaktuar dhe miratuar përmbajtjen e diferencës që duhet likuiduar..

28.3 Nëse brenda këtij afati të fundit Palët nuk do të binin dakord për përmbajtjen e diferencës që duhet likuiduar, duhet bërë referim në parashikimet e nenit 22 më sipër.

### Neni 29 – Pagesa e interesave

Mbi të gjitha shumatat që lidhen me likuidimin e kësteve të Pagesës së Shërbimit, indeksimin e Pagesës së Shërbimit dhe likuidimin e diferencës së saj, do të aplikohet norma e interesit ligjor në fuqi rast pas rasti, duke filluar nga afatet e parashikuara për kryerjen e likuidimeve dhe pa përbërë kjo një justifikim për vonesën në kryerjen e këtyre likuidimeve.

### Neni 30 - Mosmarrëveshjet

Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që do të lindin midis Bashkisë dhe Eco Tirana-s në lidhje me këtë Kontratë, do i besohet një arbitri të vetëm i emëruar në bazë të Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Parisit (ICC Rules) deri në momentin e përfundimit të zbatimit të të gjithë paketës ligjore të reformës në drejtësi në Republikën e Shqipërisë (të ashtuquajtura ligjet e implementimit të reformës në drejtësi) që aktualisht janë duke u shqyrtuar nga Parlamenti i Republikës e Shqipërisë. Pas këtij momenti, të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin midis Bashkisë dhe Eco Tirana-s në lidhje me këtë Kontratë, do të zgjidhen ekskluzivisht nga Gjykata Administrative e Tiranës.

### Neni 31 - Dorëheqje dhe pranime

Mungesa e ushtrimit nga njëra prej palëve i një ose më shumë të drejtave të parashikuara në favor të saj në kontratë nuk mund të interpretohet në asnjë rast si dorëheqje nga këto të drejta.

### Neni 32 - Marrëveshjet e mëparshme


Kjo kontratë, duke përfshirë kushtet paraprake dhe shtojcat, përbën shprehjen e plotë të marrëveshjes së arritur midis palëve duke iu referuar fushës që përbën objektin e saj dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis tyre që ka të njëjtin objekt.

### Neni 33 - Ndryshime

Çdo ndryshim i kësaj kontrate dhe/ose i shtojcave të saj mund të bëhet me marrëveshje midis palëve vetëm në formë të shkruar nëpërmjet letrës rekomande.

### Neni 34 – Mbijetesa e kontratës

Kur një ose më shumë prej dispozitave të kësaj Kontrate janë ose bien në kundërshtim me norma detyruese apo me norma të rendit publik, ato do të konsiderohen sikur nuk ekzistojnë dhe nuk do të



15

## KONTRATE SHERBIMI

Per administrimin e mbetjeve urbane per Bashkine e Tiranës

ndikojnë mbi vlefshmërinë e Kontratës, pa përjashtuar të drejtën e secilës palë për të kërkuar ndryshimin e Kontratës, kur vetëm dhe thjesht eliminimi i dispozitës në fjalë nuk çënon rëndë të drejtat përkatëse.

### Neni 35 – Komunikime

Çdo komunikim në lidhje me këtë Kontratë ose që ka të bëjë me atë, duhet të jetë në formë të shkruar dhe do të quhet i kryer në mënyrë të vlefshme nëse arrin tek marrësi me letër rekomande me lajmërim-marrje të dërguar në adresat e mëposhtme:

- (i) për Bashkinë: në adresën që përcaktohet në kokën e Kontratës, në vëmendje të z. Taulant Tusha; e.mail taulant.tusha@tirana.al;
- (ii) për ECO TIRANA sh.a.: në adresën që përcaktohet në kokën e Kontratës, në vëmendje të Diego Testi; e.mail: ecotirana@ecotirana.com.

Kjo Kontratë hartohet në pesë kopje ku secila prej tyre konsiderohet origjinale dhe së bashku përbëjnë një akt të vetëm.

Tiranë, 08/09/2016  
Enën Veliaj  
BASHKIA TIRANË



DIEGO

TESTI

ECO TIRANA Sh.A.



CU 18

Shtojca A e Kontrates se Sherbimit

1	Mbledhje dhe transport i mbejtjeve urbane dhe te tregjeve per mbejtjet e mbledhura ne menyre te pa diferencuar, përfshirë vlerën e blerjes të kutive mbajtëse dhe shërbimet e informacionit (kuti mbajtëse prej 1,7mc) përfshirë shërbimin e zhvendosjes dhe mirëmbajtjes se kutive mbajtëse	E Hene 3 Tetor sherbimi do te jete aktiv ne nje te treseten e territorit, e Hene 10 Tetor ne nje tjeteter nje te trete te territorit , e Hene 17 Tetor ne nje te treseten e territorit . Cdo pjese ka te beje me dy zona limitrofe, qe me pare ishin menaxhuar nga operator te tjere
2	Mbledhje dhe transport i mbejtjeve urbane dhe te tregjeve per mbejtjet e mbledhura ne menyre te diferencuar (materiale te ndryshme ne plastike dhe celuloze) përfshirë vlerën e blerjes të kutive mbajtëse dhe shërbimet e informacionit (kuti mbajtëse prej 1,7mc) përfshirë shërbimin e zhvendosjes dhe mirëmbajtjes se kutive mbajtëse	E Hene 3 Tetor sherbimi do te jete aktiv ne nje te treseten e territorit, e Hene 10 Tetor ne nje tjeteter nje te trete te territorit , e Hene 17 Tetor ne nje te treseten e territorit . Cdo pjese ka te beje me dy zona limitrofe, qe me pare ishin menaxhuar nga operator te tjere
3	Mbledhje, transport dhe trajtim prane nje impianti te pershtatshem dhe te licensuar per trajtimin e mbejtjeve urbane te rrezikshme (bateri dhe medikamente tej afatit te perdorimit) nepermjet pikave mbledhese te percaktuara, përfshirë shërbimin e zhvendosjes dhe mirëmbajtjes se kutive mbajtëse	1 Dhjetor 2016
4	Mbledhje, transport te mbejtjeve nga ambalazhe te seleksionuar nepermjet sistemit dere me dere indoor.	1 Janar 2017
5	Larje dhe dezinfektim te kutive mbajtëse per mbejtje, ne vedet e pershtatshme, pasi te jene ferrequr nga rruge ne afatet e percaktuara.	Sherbimi do te filloje me 25 Tetor 2016 pasi adaptoret duhet te vendosen te reja
6	Sherbim te larjes me uje te vendeve ku jane vendosur kazanet per mbledhjen e mbejtjeve, nepermjet ujit me presion.	1 Nentor 2016
7	Mbledhje te mbejtjeve te nderimit dhe mbejtjeve voluminoze te abandonuara, përfshirë shërbimin e prenotimit dhe mbledhjes pa shërbim te mbejtjeve voluminoze per familjet.	1 Nentor 2016
8	Pastrimi manual i rugeve dhe trotuareve nepermjet operatoreve te pajisur me bicikleta cargo, përfshirë shërbimin e mirëmbajtjes te pikave te mbledhjes se mbejtjeve. Irganizim te kutive mbajtëse ne menyre manuale, me solucion dizinfektues (kuti mbajtëse prej 1.7 mc) dhe zvogelim te vullmit te imballazheve te hedhura gabimisht.	E Hene 3 Tetor sherbimi do te jete aktiv ne nje te treseten e territorit, e Hene 10 Tetor ne nje tjeteter nje te trete te territorit , e Hene 17 Tetor ne nje te treseten e territorit . Cdo pjese ka te beje me dy zona limitrofe, qe me pare ishin menaxhuar nga operator te tjere
9	Pastrim i rugeve nepermjet makinerive pastruese te pajisura per heqjen e pluhurave me pajisjeve te tjera ndihmese me shifryes elektrik.	E Hene 3 Tetor sherbimi do te jete aktiv ne nje te treseten e territorit, e Hene 10 Tetor ne nje tjeteter nje te trete te territorit , e Hene 17 Tetor ne nje te treseten e territorit . Cdo pjese ka te beje me dy zona limitrofe, qe me pare ishin menaxhuar nga operator te tjere
10	Sherbim i integruar per pastrimin e rugeve kryesore ne menyre manuale, me makina pastruese te pajisura per heqjen e pluhurave me pajisjeve te tjera ndihmese me shifryses elektrik.	E Hene 3 Tetor sherbimi do te jete aktiv ne nje te treseten e territorit, e Hene 10 Tetor ne nje tjeteter nje te trete te territorit , e Hene 17 Tetor ne nje te treseten e territorit . Cdo pjese ka te beje me dy zona limitrofe, qe me pare ishin menaxhuar nga operator te tjere
11	Larje te rugeve si gjate dites ashtu edhe gjate nates (per dhjete muaj ne vit) me autobote te pajisura me sperkates ne forme tehu.	E Hene 3 Tetor sherbimi do te jete aktiv ne nje te treseten e territorit, e Hene 10 Tetor ne nje tjeteter nje te trete te territorit , e Hene 17 Tetor ne nje te treseten e territorit e fundit te territorit (me nenkontraktim).
12	Larje te rugeve gjate nates (per tete muaj ne vit ose 240 dite) me autobote te pajisura me sperkates (naspo).	E Hene 3 Tetor sherbimi do te jete aktiv ne nje te treseten e territorit, e Hene 10 Tetor ne nje tjeteter nje te trete te territorit , e Hene 17 Tetor ne nje te treseten e territorit e fundit te territorit (me nenkontraktim).